



مركز المعلومات الإسلامي
Islamic Information Center
للتنوير والإرشاد



This is Islam

Part of the _____




**ISLAMIC
e-LIBRARY**

Your Path To Peace.. سبيلك للسلام



@islamicicdxb





Ky është ISLAMI

Një vështrim i thelluar mbi fenë
me rritje më të shpejtë në botë

Yaqin de


ISLAM



LAUNCHING
CURIOSITY

Një foto satelitore e muslimanëve që drejtohen kah Qabes, për ndërtimin e së cilës Zoti e urdhëroi Profetin e Tij, Ibrahimin (Abrahami), edhe muslimanët i urdhëroi që të drejtohen kah saj në lutjet e tyre, kudo që të jenë.

THIS IS
ISLAM



Ky është ISLAMI

**Një vështrim i thelluar
mbi fenë me rritje më të
shpejtë në botë**

Fahd Salim Bahumam



- **A të dëshiron** të kesh një imazh më të qartë për një prej feve më të diskutuara në mjetet e informacionit?
- **A mund të ndalesh** një çast për të njohur më thellë njërën prej feve që përhapet më shumë dhe përqafohet më shpejt, sipas statistikave botërore?
- **A ndjen kënaqësi** kur zbulon kulturat e të tjerëve dhe pikëpamjet e tyre për jetën, për fenë dhe botën që na rrethon?
- **A do t'i japësh** vetes tënde mundësinë për t'u njohur me informacione të sakta mbi fenë islame të marra nga burimet e saj? Pastaj gjyko me logjikën dhe mendjen tënde.

Nëse e sheh, ose lexon diçka interesante apo të dobishme, libri mund të të ndihmojë të gjesh atë që e dëshiron dhe synon.

Temat e librit



Pyetje që na mendojnë
të gjithëve...

12



Universaliteti i Islamit

20



Një Krijues i Vetëm...
Një i Adhuruar i Vetëm

55



Cilët janë profetët në të
vërtetë?

71



Qëndrimi i Islamit ndaj
Jezuit (paqja qoftë me të!)

79



Kush është Profeti i
Islamit?

89



Click on topic to go to
the page.

**Nga ka ardhur
Kurani?**

149



Click to go to the page.



Muhamedi, i Dërguari i
Zotit, në vështtrimin e një
njeriu objektiv

98



Histori nga jeta e Profetit
Muhamed dhe morali i tij

110



Nga thëniet e Profetit
(a.s.)

126



Kurani i madhërishëm –
mrekullia e përjetshme e
Islamit

136



Nga ka ardhur Kurani?

149



Ritet e adhurimit në
Islam dhe thelbi i tyre

169



Familja në Islam

202



**Familja në
Islam**

202



Click to go to the page.



Pozita e gruas në Islam

213



Legjislacioni islam për
ushqimet dhe pijet

233



Mëkati dhe pendimi

248



Dualizmi fe dhe arsyeja

255



Islami është fe e paqes

266



Midis Islamit dhe
gjendjes së disa
muslimanëve

278



Dualizmi fe dhe arsyeja

255



Click to go to the page.



**Pyetje që na
mundojnë të gjithëve...**



Kush

Kush prej nesh nuk është ndalur në një moment të jetës së tij për të pyetur veten: çfarë ka ndodhur? Kush jam unë? Nga kam ardhur? Për ku po të shkoj? Ku do të përfundoj? Cili është qëllimi i kësaj ekzistence? Përse gjithë ky gulçim në këtë botë, përderisa fundi është vdekje dhe inekzistencë?

M
Muslimanët dhe ithtarët e feve qiellore besojnë se nuk ka kuptim jeta e njeriut pa besim. Pa besuar në ekzistencën e Krijuesit të Drejtë, pa besuar në ekzistencën e jetës tjetër në të cilën vepërmiri shpërblehet dhe i ligu ndëshkohet. Pa këtë besim, jeta do të ishte diçka e kotë dhe e pavlerë, do të ishte ndëshkim dhe dhimbje pa kompesim, do të ishte një aventurë, pa asnjë dobi dhe përfitim.

Është e pamundur të kuptohen kontraditat e jetës, urtësia e vështirësive të saj, gabimi dhe saktësia, lumturia dhe vuajtjet pa besuar në një Zot, te Krijuesi që vepron gjithçka me urtësi dhe drejtësi perfekte. Në këtë mënyrë, çdo njeri i jep kuptim jetes duke besuar se pas largimit nga kjo botë çdokush do ta marrë hisen që i takon, në varësi të asaj që ka vepruar.

Vetëm atëherë shndërrohet në një realitet harmonik me veten besimi ynë i thellë në vlerat dhe parimet që propagandojmë, si: drejtësia, dashuria, solidariteti, sinqeriteti, durimi dhe mëshira. Vetëm atëherë marrin kuptim sfidat, të shijojnë arritjet dhe të jep kënaqësi durimi.

Shohim se Kurani, libri i shenjtë i muslimanëve, e nënvizon këtë ide dhe i përshkruan kështu njerëzit me intelekt: *"Ata meditojnë në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe thonë: "O Zoti ynë, Ti nuk i ke krijuar këto pa qëllim; i lartësuar qofsh!"* (Al Imran: 191)



Kontradiktat e jetës dhe urtësitë që fshihen pas vështirësive e sprovave në të; gabimet, të drejtat dhe vuajtjet që përjetojmë, nuk mund të kuptohen saktë përveç kur besojmë në një Zot, Krijues, që është i Urtë dhe i Drejtë në gjithçka që vepron në gjithësinë që ka krijuar.

Feja islame

Shumica e feve që ekzistojnë në rruzullin tokësor e identifikojnë veten ose me individë, ose me bashkësi, ose me vendin ku është shfaqur kjo fe. Kështu, krishtërimi e mori emrin nga Jezusi (Isai a.s); Jahudizmi e identifikon veten me fisin Jehuda; budizmi identifikohet me themeluesin e saj, Budën; Hinduizmi identifikohet me Indinë, e kështu me radhë...

Ndërsa Islami nuk identifikohet me ndonjë person të veçantë, as me ndonjë fis, as me ndonjë racë apo bashkësi. Sepse ai nuk i përket ndonjë populli të veçantë që të identifikohet me të, nuk është sajësë e ndonjë njeriu që të identifikohet me të. Ai quhet vetëm "Islam".



Kuptimi i fjalës “Islam”

Nëse i kthehemi origjinës së fjalës “Islam” në gjuhën arabe, do të shohim se ajo përfshin disa kuptime të cilat sillen rreth fjalëve: dorëzim, nënshtrim, bindje, sinqeritet, siguri dhe qetësi.

Islami është dorëzim dhe bindje e plotë ndaj Zotit, Sunduesit; është çlirim nga çdolloj robërie përveç Tij.

Në këtë kuptim kanë ardhur mjaft versete kuranore.

Kurani na tregon se kush i drejtohet Zotit me zemrën dhe të gjitha gjymtyrët, i nënshtrohet dhe i dorëzohet Atij, zbaton urdhrat dhe largohet nga ndalesat, duke u kapur fort pas litarit të shpëtimit që nuk këputet kurrë, ky njeri do të fitojë çdo mirësi (Lukman: 22).

Pra, Islami është dorëzim i plotë ndaj Zotit dhe çlirim nga çdolloj nënshtrimi dhe skllavërie nga dikush tjetër përveç Tij. Muslimani është i sinqertë në adhurimin e Zotit. Ai jeton në paqe me veten dhe e përhap atë tek të tjerët.

Por, a është ky mesazhi që kanë sjellë të gjithë Profetët?



Islami është feja e të gjithë Profetëve

Kurani pohon se të gjithë popujve u janë dërguar Profetë në kohëra të ndryshme, për t'u mësuar fenë e Zotit. Kurani i drejtohet kështu Muhamedit (a.s.): "Ne të kemi dërguar ty (Muhamed) me të vërtetën, si përgëzues dhe paralajmërues; nuk ka pasur asnjë popull që të mos i ketë ardhur paralajmërues." (Fatir: 24) Pra, të gjithë Profetët kanë sjellë fenë e vërtetë dhe nuk ka dallim midis tyre në mesazhin e besimit dhe në parimet e përgjithshme ligjore e morale.

Islami që ka predikuar Profeti i fundit, Muhamedi (a.s.), para më shumë se një mijë e katërqind vitesh, është vazhdim i fesë që kanë predikuar të gjithë Profetët. Kurani i urdhëron muslimanët që të besojnë ashtu siç kanë besuar Profetët e mëparshëm, si: Abrahami (Ibrahimi a.s.), Isaku (Is'haku a.s.), Jakobi (Jakupi a.s.) Moisiu (Musai a.s.) Jezui (Isai a.s.) (El-Bekare: 136).



Fjala islame në arabisht përfshin një numër kuptimesh të ndryshme që variojnë nga nënshtrimi e dorësimi i plotë, përunjësia, bindja, sinqeriteti, siguria nga çdo e keqe, qetësia e prehja shpirtërore.

Prej ngjarjeve më interesante që na tregon Kurani është dhe porosia që Ibrahimi, Babai i Profetëve (po ashtu edhe Jakubi) ia jep femijëve të tij prag të vdekjes: pa dyshim Zoti ka zgjedhur për ju fenë e vërtetë, prandaj bëhuni të qëndrueshëm në Islam derisa t'ju vijë vdekja (El-Bekare: 132).



Kjo fe është vazhdim i fesë së të gjithë të Dërguarve të Zotit. Besimi është i njëjtë; nuk ndryshon. Ajo çfarë ndryshon tek Profetët dhe popujt e tyre është sheriatu dhe detajet e dispozitave të tij, të cilat ishin në përshtatje me realitetin e kohëve të ndryshme, derisa u dërgua Vula e Profetëve, Muhamedi (a.s.) që shpalli sheriatin e fundit për gjithë njerëzimin.

Prandaj, Kurani e përcakton qartë se feja është një dhe ajo është Islami, ndërsa dallimet që kanë ndjekësit e feve qiellore në aspekte të ndryshme të besimit kanë ardhur vetëm si pasojë e shtrembërimeve që i kanë larguar ata nga e vërteta që kanë sjellë Profetët e tyre (Al Imran: 19).



Islami nuk i përket një njeriu të veçantë, as një fisi, race apo kombi, sepse ai nuk është specifik e i veçantë vetëm për një popull e shoqëri të caktuar njerëzore që të mund t'i atribuohet asaj. Ai nuk është shpikur nga ndonjë qenie njerëzore që të mund t'i atribuohet asaj. Ai quhet thjesht dhe vetëm Islam.



Universaliteti i Islamit

Është

Është e habitshme që në Kuran nuk është përdorur fjala “arab”, ndonëse gjuha e tij është arabishtja dhe Profeti Muhamed ka dalë prej arabëve. Sot shohim se arabët janë pakicë mes muslimanëve, madje përbëjnë më pak se 20% të tyre. Shteti më i madh musliman është Indonezia, në juglindje të Azisë; madje vetëm pakicat muslimane në Indi janë sa dyfishi i popullsisë së shtetit më të madh arab.

Feja islame ka ardhur si mëshirë dhe udhëzim për të gjithë popujt, pavarësisht kulturave, racave, zakoneve dhe vendeve të tyre, siç i thotë Zoti Muhamedit në Kuran: *"Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët."* (El-Enbija: 107)

Islami ofron vizionin e tij për larminë njerëzore në një mënyrë të panjohur nga sistemet e tjera dhe nga popujt e kësaj bote.

Le ta shikojmë me kujdes këtë orientim kuranor, i cili nuk u drejtohet vetëm arabëve apo muslimanëve, por i drejtohet mbarë njerëzimit, me të gjitha racat dhe rrymat e tij: *"O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Vërtet, më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që tregohet më i devotshëm. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Gjithinformuar."* (El-Huxhurat: 13)



Me këtë shpallje Kurani nënvizon se të gjithë njerëzit, pavarësisht racës dhe ngjyrës, janë bij të Adamit (Ademit a.s.) dhe Evës (Havasë a.s.) dhe se diversiteti e larmia ndërmjet tyre është tregues i epërsisë, por thjesht për njohje të ndërsjellë, bashkëjetesë dhe bashkëpunim. Epërsia dhe nderimi i takojnë atij që tregohet më i devotshëm ndaj Zotit.

Madje Kurani na tërheq vëmendjen që larminë e racave, gjuhëve dhe kulturave njerëzore ta shohim si begati nga Zoti, si shenjë dhe mrekulli të krijimit të Tij, që krahasohen me krijimin e qiejve dhe të Tokës për nga madhështia dhe rëndësia. Kurani pohon se këto argumente i vlerësojnë vetëm njerëzit e dijes dhe të meditimit (Er-Rum:22).




Islami ofron një vizion paqëtimi e harmonizimi mes diversitetit njerëzor në një mënyrë që asnjë regjim tjetër nuk e ka njohur dhe që njerëzit e tokës nuk e kanë provuar.


Pika e parë dhe më e madhe në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, ajo që sanksionon barazinë e njerëzve në liri, në të drejta dhe në dinjitet, është miratuar zyrtarisht në vitin 1948 dhe ka filluar të zbatohet më pas.



Profeti i Islamit, Muhamedi (a.s.), e deklaroi qartë dhe fort këtë barazi rreth 1400 vjet më parë. Ai hapi një epokë të re për njerëzimin, kur shpalli mes njerëzve këto fjalë: *"O njerëz! Në të vërtetë, Zoti juaj është Një dhe babai juaj është një. Prandaj arabi nuk është më i mirë se joarabi dhe joarabi nuk është më i mirë se arabi; i bardhi nuk është më i mirë se i ziu dhe i ziu nuk është më i mirë se i bardhi, përveçse në devotshmëri (ndaj Zotit)."* (Ahmed, 23489)



Viti 630.



Muhamedi është Profeti i Islamit

«O ju njerëz! Zoti juaj është Një. dhe babai juaj është një (Ademi). Nuk është më i mirë arabi se joarabi. Dhe a joarabi nuk është më i mirë se arabi. Nuk është i kuqi më i mirë se i ziu dhe as i ziu nuk është më i mirë se i kuqi. Dallimin mes tyre e bën veçse devotshmëria (takua) .»

Viti 1948.



Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

E cila njeh barazinë e njerëzve në liri, të drejta dhe dinjitet



Kujdesi për mjedisin është pjesë e besimit fetar

Disa filozofi e konsiderojnë njeriun zotëri absolut të natyrës, me të cilën mund të sillet sipas interesit dhe dëshirës së tij, pa i dhënë llogari askujt, edhe sikur veprimet e tij të shkaktojnë dëmtim të mjedisit apo zhdukje të specieve të ndryshme. Totalisht e kundërt me këtë është pikëpamja që nuk i njeh njeriut asnjë epërsi mbi krijesat e tjera, por e konsideron atë si njëra prej miliona krijesave të këtij universi. Si e shikon Islami raportin e njeriut me universin?

Pikpamja islame mbi natyrën e raporteve të njeriut me universin bazohet te përceptimet e besimit. Mbi këtë bazë përcaktohen dispozita të detajuara me qëllim rregullimin e raporteve me njeriun, me kafshët, me tokën dhe burimet natyrore.

Gjëja e parë që të tërheq vëmendjen në studimin e filozofisë së këtyre raporteve është ekuilibri që sanksionon Kurani. Në njërën anë,

Kurani tregon se Zoti e ka nderuar njeriun mbi krijesat e tjera tokësore (El-Isra: 70); i ka vënë në shërbim natyrën dhe krijesat përreth tij, që të përfitojë prej tyre dhe t'i ruajë ato (Ibrahim: 32-33). Pra, njeriu nuk është thjesht njëra prej miliona krijesave të tjera, pa asnjë dallim prej tyre, por është krijesë e nderuar, së cilës i është vënë në shërbim natyra, që të përfitojë prej saj (El-Bekare: 29).

Ndërsa në anën tjetër, Kurani thekson se njeriu nuk është zotëria absolut i natyrës, nuk mund të bëjë çfarë të dojë me të dhe se pozita e tij e lartë mbi krijesat e tjera nuk i jep të drejtën të dëmtojë natyrën dhe të shpërdorojë burimet e saj. Në fakt, zotëruesi i vërtetë i natyrës është Zoti që e krijoi, ndërsa roli i njeriut në këtë mes dhe pozita e tij qëndron vetëm në faktin se Zoti e ka zgjedhur atë si mëkëmbës të Vetin në Tokë. Pra, njeriu qëndron në pozitën e kujdestarit, Zoti i ka dhënë të drejtën të përfitojë dhe e ka urdhëruar të përpiqet për zhvillim dhe progres, por pa shkaktuar dëm, pa dëmtuar njerëzit e tjerë, mjedisin dhe krijesat (Hud: 61; El-Bekare: 30).

Legjislacioni islam ka nxjerrë me dhjetëra norma e udhëzime për të rregulluar këtë lidhje të ngushtë mes njeriut dhe natyrës që e rrethon. Midis tyre po përmendim disa për ilustrim:

1. Kujdesi për kafshët

Janë transmetuar shumë thënie të Muhamedit (a.s.) ku ai bën thirrje për kujdesin ndaj të drejtave të kafshëve dhe njoftojnë për shpërblimin e madh që fiton në botën tjetër kushdo që sillet mirë me to. Nga ana tjetër, e ndaloi dëmtimin e kafshëve dhe i kërcënoi mizorët me ndëshkimet më të rënda hyjnore.

Shoqata e parë e cila është kujdesur për të drejtat e kafshëve është themeluar në Britani në vitin 1824, e njohur me emrin "Shoqata Mbretërore për të Drejtat e Kafshëve"; ligji i parë i njohur në kohën moderne, i cili penalizon sulmin ndaj kafshëve, është miratuar në Britani në vitin 1949.

Ndërkohë, që para 1400 vitesh, Islami e ka ndaluar agresionin ndaj kafshëve. Ka shumë tekste nga Profeti Muhamed a.s., të cilat e ndalojnë lënien e kafshëve pa ngrënë, torturimin dhe stërmundimin e tyre, apo lojërat që i lëndojnë ato, madje edhe goditjen e kafshës në fytyrë. Këto dispozita janë të njohura në librat e jurispruencës islame.

Ndoshta lexuesi mund ta kuptojë më mirë sa kujdeset Islami për mirëtrajtimin e kafshëve, kur lexon fjalët me të cilat Muhamedi a.s. u drejtohet njerëzve: *"Një grua që ushtronte prostitucion (një nga mëkatet më të mëdha në Islam) pa një herë një qen që sa nuk po ngordhte nga etja. I erdhi keq për gjendjen e tij, kështu që hoqi këpucën e saj dhe e mbushi me ujë nga një pus aty pranë, pastaj i dha qenit për të pirë. Për shkak të këtij veprimi Zoti e fali atë."* (El-Buhari, 3280)



Islami e ndaloi urëtimin e kafshës, torturimin e saj, mbingarkesën (raskapitjen) e saj, ose të luajturit me të me mënyra që e dëmtojnë atë, që në vitin 632 pas Krishtit.



Shoqata e parë për mbrojtjen e të drejtave të kafshëve u themelua në vitin 1824



Ligji i parë që e ndalon dhe e dënon abuzimin me kafshët u miratua në Britani në vitin 1949





2. Kujdesi për bimët

Islami ka nxitur kujdesin për bimët dhe mbjelljen e tyre, qoftë për dobi personale apo për interes të njerëzve të tjerë dhe krijesave të ndryshme.

Sipas një udhëzimi profetik, Muhamedi (a.s.) na tregon se kush mbjell vetë apo kontribuon në mbjelljen e një bime prej së cilës përfitojnë krijesat, atëherë ai fiton shpërblim për çdo shpend, njeri a kafshë që ushqehet prej asaj bime (Buhari, 2320).

Madje, i Dërguari fisnik i bën thirrje muslimanit që edhe në momentet më të vështira të mos kursehet në kujdesin ndaj mjedisit, për zhvillimin dhe përparimin e jetës në Tokë nëpërmjet kultivimit të bimëve dhe pemëve, edhe nëse beson se ai nuk mund të përfitojë gjë. Ai thotë: *"Në prag të Apokalipsit – që është katastrofa më e madhe e universit - sikur ndonjëri prej jush të ketë në dorë një fidan duhet të nxitojë që ta mbjellë, nëse ka mundësi, sepse për këtë fiton shpërblim tek Zoti."* (Ahmed, 12981)

Me këtë orientim del qartë se kultivimi dhe zhvillimi i tokës është një prej qëllimeve dhe detyrave madhore të Islamit, saqë edhe kushtet më të vështira nuk e rrëzojnë atë.



3. Kujdesi për burimet natyrore

Islami i kushton rëndësi mirëmbajtjes së mjedisit, e ndalon keqpërdorimin e burimeve të tij, e ndalon ndotjen dhe shkatërrimin e tij. Ai u ofron njerëzve një program të plotë bazuar në parimin: “parandalimi është para kurimit”. Në këtë kontekst, i kushton rëndësi higjenës personale, duke u kujdesur për të gjitha detajet e saj; vlerëson kujdesin për burimet natyrore dhe mirëpërdorimin e tyre, sikurse penalizon shkatërrimin e mjedisit apo ndotjen e tij. Për të ilustruar këtë aspekt përmendim këto shembuj:

- Islami e ka ndaluar shpërdorimin e burimeve të natyrës, veçanërisht të ujit, qoftë edhe kur përdoret për pastrimin ritual (të disa gjymtyrëve para lutjeve).

- Islami i ka ndaluar njerëzit e fuqishëm e me pushtet të monopolizojnë burimet e natyrës, sepse kjo i dëmton të tjerët. Kështu, ka ndaluar monopolizimin e ujërave, të lëndëve djegëse (energjisë) dhe të kullotave (ushqimit) (Ebu Daud, 3477).



Përkujdesja për mjedisin dhe të kontribuarit në pastrimin e tij nga ndotja është pjesë e besimit siç thotë Profeti i Islamit.

- Ai ndaloi çdo gjë që e prish ambientin rreth nesh. Si shembull për këtë mund të përmendim ndalimin e urinimit në ujin e ndenjur, sepse kështu ndotet; kryerjen e nevojave personale në vendet me hije dhe në rrugë, ngase ato janë vende ku kalojnë njerëz apo qëndron në to kalimtarit për të pushuar nga lodhja dhe vështirësitë e udhëtimit.

Shembuj të thjeshtë si këto nuk janë të çuditshme për fenë, Profeti fisnik na tregon se pastrimi i mjedisit nga plehurat, kontributi për përmirësimin e tij, duke larguar pengesat nga rruga, nuk konsiderohet vetëm punë e mirë, por dhe pjesë e vërtetësisë së besimit. (Muslimi, 35)





Feja e diturisë

Nuk ka qenë rastësi që fjala e parë e Kuranit, që i është shpallur Muhamedit (a.s.), është "Lexo". Në Kuran dhe në fjalët e Profetit Muhamed (a.s.) janë të shumta pohimet që tregojnë mbështetjen e Islamit për të gjitha llojet e dijes së dobishme për njerëzimin. Aq sa rruga që ndjek një musliman për të kërkuar dije të dobishme është konsideruar rrugë për në Parajsë. Kështu, Profeti Muhamed (a.s.) ka thënë: *"Atij që ndjek një rrugë në kërkim të diturisë, Zoti do t'ia lehtësojë përmes saj rrugën drejt Parajsës."* (Muslim, 2699)

Në një krahasim të habitshëm, Profeti i nderuar sqaron se vlera e dijetarit ndaj atij që i është përkushtuar vetëm adhurimit është si vlera e Profetit ndaj njeriut më me pak vlerë (Tirmidhi, 2685).

Për këtë arsye Islami nuk ka njohur ndonjë luftë mes fesë dhe shkencës, siç ka ndodhur në fetë e tjera. Shkencëtarët nuk janë gjykuar për mendimet dhe përfundimet e tyre shkencore rreth natyrës, siç ka ndodhur në epokën e errësirës mesjetare. Përkundrazi, feja ka shërbyer si pishtar për diturinë, si mbështetësi dhe propaganduesi i saj që nxiste të mësuarit dhe mësimdhënien. Xhamitë kanë qenë qendra për disiplina të ndryshme të diturisë dhe njohurive e vazhdojnë të jenë sot e kësaj dite burim mirësie për njerëzimin.

Le të mos çuditemi atëherë nga fakti se shumica e shkencëtarëve muslimanë e kanë filluar jetën e tyre me memorizimin e Kuranit dhe mësimin e fesë, e pastaj shkëlqyen në disiplinat dhe specialitetet e tyre.

Zoti e nderoi dijetarin që ua mëson njerëzve vlerat dhe virtytet, duke e ngritur atë në piedestalet më të larta, saqë Profeti (a.s.) tha se të gjitha krijesat luten për atë që u mëson njerëzve mirësinë (Tirmidhiu, 2685).



LAUNCHING

CURiOSiTY

[CLICK HERE](#)



“

Shumica e natyralistëve dhe mjekëve muslimanë e filluan jetën e tyre duke mësuar Kuranin, i cili i ftoi e inkurajoi ata të hulumtonin dhe të thelloheshin në shkencat e tjera.



Disa shkencëtarë muslimanë




1. **El-Khavarizmi, i njohur si Algoritmi ose Algaurizin (790 – 850, Bagdad):** dijetar në matematikë, gjeometri dhe astronomi, themelues i algjebrës. Librat e tij janë përkthyer që herët nga qytetërimet e tjera, duke bërë që një sërë terma të arabishtes të futen në latinisht për shkak të tij, si, p.sh.: termat algjebra (arabisht: *al-xhebr*) dhe zero (arabisht: *sifr*).



2. **Ibën El-Hejthem, i njohur si Alhazen (965 – 1040, Kajro):** dijetar në fizikë dhe gjeometri, i lidhur me Universitetin (Xhaminë) Al-Az'har. Kontributin më të madh e ka dhënë në degën e optikës. Atij i atribuohet zbulimi i parimeve të kamerës. Shumë nga studiuesit provojnë se fjala kamera, e futur kështu në shumicën e gjuhëve, e ka prejardhjen prej fjalës arabe "kumra", e cila ishte emërtim i dhomës së dritës që shpiku Ibën El-Hejthemi.



3. **Al-Biruni (973-1048, Havarizm):**
 dijetar i madh i astronomisë. Ishte i
 pari që tha se Toka rrotullohet rreth
 boshtit të saj dhe aludoi për forcën
 e gravitetit të saj.





4. El-Zahravi (936 – 1013, Andaluzi), i njohur si Albucasis, mjek dhe kirurg musliman që ka zhvilluar kirurgjinë, duke shpikur e përshkruar me qindra vegla kirurgjike. Librat e tij kanë qenë burim kryesor për mjekësinë dhe kirurgjinë për disa shekuj në gjithë të ndryshme.




5. Ibën Sina (980 – 1037, Buhara): i njohur në rrethet shkencore si Avicena, mjek dhe filozof i famshëm, që u parapriu të tjerëve në kohë, duke përshkruar shumë fenomene në fushën e mjekësisë dhe duke ofruar hulumtimet e tij për diagnostikimin e mjaft sëmundjeve. Ai ngrii lart pozitën e eksperimentit shkencor në hulumtimet dhe studimet e tij mjekësore, që e çuan në rezultate korrekte, me të cilat i parapriu bashkëkohësve dhe mbetën deri në ditët tona. Kjo duket qartë në librin e tij “Kanuni”, i cili mbeti referencë në fushën e mjekësisë për shtatë shekuj me radhë. Ky libër vazhdoi të studiohej në universitetet e Evropës deri në mesin e shek. XVII.

Pasi u bë i famshëm në fushën e mjekësisë, ai filloi t’i kuronte të sëmurët falas, si një gjest humanizmi prej tij dhe shenjë falenderimi ndaj Zotit për mirësinë e dijes dhe të njohurive.





6. Ibën El-Nafis (1213 – 1288, Damask): ishte prej dijetarëve të fesë; njëkohësisht u shqua si një ndër dijetarët më të mëdhenj në fushën e mjekësisë dhe disiplinën e fiziologjisë në histori. Ishte i pari që zbuloi saktësisht qarkullimin e vogël të gjakut dhe e përshkroi atë, sikurse ofroi mjaft pikpamje mjekësore, me shumicën e të cilave vazhdohet të punohet deri në ditët tona.



Islami është gjithpërfshirës

Shumë njerëz habiten kur mësojnë se Islami nuk është vetëm rituale, vepra dhe udhëzime të përgjithshme morale, siç ndodh në fetë që i njohin.

Islami, në të vërtetë, nuk është nevojë shpirtërore, të cilën muslimanët e ushtrojnë vetëm në xhami me lutje dhe falje...

Nuk është vetëm mendime, besime dhe filozofi, të cilën vetëm sa e besojnë ithtarët e tij...

Nuk është vetëm sistem ekonomik apo mjedisor i plotë...

Nuk është vetëm norma e teori për ndërtimin e sistemit shoqëror...

Ashtu sikurse nuk është vetëm paketë normash morale dhe të sjelljes me të tjerët...

Por, është një sistem i plotë që përfshin të gjitha aspektet e jetës, me të gjitha dimensionet e saj në hapësirë dhe në kohë. Ai i përfshin aspektet e lartpërmendura dhe gjithçka tjetër përtej tyre. E megjithatë, ai nuk e kufizon lirinë e njerëzve, përkundrazi ua lehtëson jetën, që t'i përqendrojnë përpjekjet drejt kreativitetit, ndërtimit dhe qytetërimit.

Prandaj konsiderohet si njëra nga mirësitë më të mëdha që Zoti i ka falur njeriut, siç pohon Kurani (El-Maide : 3).

Kur një jomusliman i tha me ironi njërit prej shokëve të Profetit fisnik - i quajtur Selman El-Farisi: “A është e vërtetë që ky shoku juaj (ka pasur për qëllim të Dërguarin e Zotit) ju mësoi çdo gjë, madje dhe rregullat e kryerjes së nevojave personale?” Ai iu përgjigj: “Po na i mësoi të gjitha.” Pastaj i mësoi atij dispozitat dhe rregullat e Islamit në lidhje me këtë çështje. (Muslimi, 262)



Islami është një metodologji e kompletuar që na jep një kuptim të detajuar e të saktë për të gjitha aspektet e jetës, në të gjitha dimensionet dhe horizontet e saj.





Kjo jetë dhe jeta tjetër

Egjiptianët e lashtë i balsamosnin të vdekurit dhe u vendosnin përreth të gjitha sendet e tyre me vlerë, duke menduar se atyre do t'u duheshin në jetën pas vdekjes.

Në anën tjetër, popuj nga Tibeti i copëtojnë kufomat e të vdekurve dhe i vendosnin në vende të larta, për t'u ushqyer shpendët me to. Hindusët sot e kësaj dite i djegin kufomat e të vdekurve të tyre, me besimin se kjo është mënyra e vetme për të shpëtuar shpirtin e tyre.

Këto janë vetëm pak shembuj nga format e ndryshme të riteve funerale për të vdekurin, të cilat janë të shumëllojshme në kohë dhe vende të ndryshme, sipas fesë dhe besimit të njerëzve për atë çfarë vjen pas vdekjes. Njëkohësisht, këto rite aludojnë edhe përgjigje për pyetje të thella, si: A ka jetë tjetër pas vdekjes? Cila është natyra e saj? Për çfarë kemi nevojë atje?

Vdekja është e vërteta e madhe për të cilën pajtohen të gjithë. Ajo na pret të gjithëve, pa përjashtim, pavarësisht se besojmë apo jo në botën tjetër, apo llogaritë tona janë të kufizuara në atë që shohim dhe prekim me shqisat tona, pavarësisht se jemi të përgatitur për atë moment decisiv, apo përpiqemi ta harrojmë, apo bëjmë sikur e harrojmë, duke u zhytur në dëfrimet dhe preokupimet e jetës së përditshme.

Sërish mbetet pyetja që tejkalon çdo shkuarje e përpjekje për harresë dhe që ngulmon të imponohet sa herë që njeriu bën një ndalesë me veten... Vallë, vdekja është fundi dhe nuk ka gjë tjetër pas saj?! A është ekzistenca jonë një lloj kotësie?!

Ka një pyetje që përsëritet shpesh në mendjet tona, por edhe Kurani na e përsërit në formë të ndryshme, sidomos kur na njofton për Ditën kur do të ndodhë Apokalipsi, atë Ditë kur shumë njerëz do të pendohen, do të ndjejnë keqardhje dhe to të qortojnë veten përse nuk

kanë qëndruar një moment me të për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje: Përse nuk u përgatiten për Ditën e largimit nga kjo botë?! Disa prej tyre do të thonë: *"Ah, sikur të kisha bërë diçka të mirë për jetën time!"*. Ndërsa disa të tjerë do të thonë: *"Ah, sikur të isha pluhur!"* (El-Fexhr: 24; En-Nebe': 40)

Dihet se gjithë ithtarët e feve qiellore besojnë në jetën e përtejme, në shpërblimin dhe ndëshkimin e saj. Sepse, kjo është pjesë e besimit që kanë sjellë gjithë Profetët. Ndërkohë, njeriu me mendjen e tij arrin ta përceptojë se nuk ka kuptim jeta, feja dhe morali, pa besuar në jetën e botës tjetër, në të cilën do të ketë llogari dhe çdo njeri do të shpërblehet në varësi të punës që ka bërë, të mirë apo të keqe.



Të gjithë pasuesit e feve qiellore besojnë në jetën e përtejme si dhe në shpërblimin dhe ndëshkimin pas vdekjes.



E megjithatë, shumë njerëz mendojnë se fetaria dhe përkushtimi nuk mund të bashkohen me fitimin e pasurisë, me dëfrimin dhe me zhvillimin. Pra, veprat do të jenë ose për këtë jetë, ose për jetën tjetër dhe nuk mund të bëhen njëkohësisht, ashtu siç nuk bashkohen nata me ditën.

Habia e tyre nuk mbaron. Ata e kanë të vështirë të besojnë se në kredon islame nuk ekziston pengesa midis adhurimit dhe dëfrimit apo adhurimit dhe pasurimit. Profeti Muhamed na tregon se kur njeriu bën çfarëdo veprimi të drejtë, me qëllim të mirë, për këtë do të shpërblehet në jetën tjetër, edhe sikur veprimi i tij të duket diçka e vogël në sytë e njerëzve, siç është: largimi i ferrave nga rruga apo vendosja e kafshatës në gojën e bashkëshortes së tij. (El-Buhariu, 56)


Duke dashur të tregojë se fushat e bamirësisë janë të pafundme, Profeti fisnik (a.s.) e ilustron me një shembull që i la gojëhapur shokët e tij. Ai u tha: "Edhe kur dikush e kënaq epshin me gruan e vet, ka shpërblim". Shokët e pyetën se ç'lidhje ka shpërblimi me kënaqjen e epshit dhe Profeti fisnik u tha: "*A nuk bën mëkat njeriu kur e kënaq epshin në formë të ndaluar?! Kështu, pra, atij i llogaritet shpërblimi, kur zgjedh rrugën e drejtë (për të kënaqur epshin).*" (Muslim, 1006)

Kush njihet me Islamin qysh në kontaktet e para me të i bie në sy fakti që kjo fe ka vendosur një ekuilibër ndërmjet jetës së kësaj bote dhe botës dhe jetës së amshueshme, sikurse e përshkruan Kurani. Në Librin e Tij, Zoti i nxit njerëzit për t'iu përkushtuar adhurimit, duke kërkuar shpërblimin e botës tjetër, por pa i neglizhuar përpjekjet në këtë botë për të fituar nga begatitë e Tij. Njeriu, që nëpërmjet punës ka për qëllim fitimin e kënaqësisë së Zotit, meriton shpërblimin e Tij. Muslimani urdhërohet të bëjë përpjekje për adhurimin e Zotit edhe nëpërmjet punës dhe profesionit të tij, nëpërmjet edukimit të fëmijëve dhe përkujdesit shëndetësor ndaj tyre, nëpërmjet kujdesit ndaj mjedisit dhe zhvillimit të shoqërisë, ashtu sikurse e adhuron Atë nëpërmjet lutjes, lëmoshës dhe agjërit.

Ky është njëri nga sekretet e qetësisë shpirtërore dhe të paqes së brendshme që gjen muslimani, kur ndien harmoninë midis kësaj jete dhe jetës së përtejme, midis dëfrimit dhe adhurimit; pra, nuk ka konflikt dhe as dualizëm midis dy koncepteve, por vetëm përplotësim midis tyre.



Për këtë arsye, Kurani nënvizon se slogani e muslimanit, që e njih mirë filozofinë e Islamit për jetën, është se gjithë jeta i dedikohet Zotit dhe këtë duhet ta shpallë publikisht duke thënë: Vërtet gjithë jeta ime është adhurim kushtuar Zotit, në të gjitha momentet dhe gjendjet e saj, jo vetëm nëpërmjet namazit dhe ritualeve, por çdo gjë që bëj në jetë e llogarit që të fitoj shpërblimin tek Zoti, sepse Zoti gjykon mbi veprat e mia dhe do të më shpërblejë pas vdekjes. Prandaj, i zbatoj të gjitha urdhrat e Zotit dhe i përmbahem me përpikmëri fesë së Tij, Islamit (El-Ena'am: 162).





Feja e komunikimit dhe bashkëpjesëmarrjes

Ahmed Ibn Fadlani udhëtar i famshëm. Ai konsiderohet i pari udhëtar që përshkroi saktësisht shumë pjesë të Rusisë, të Danimarkës dhe të vendeve Skandinave.

Përshkrimi i tij ishte një analizë e saktë e realitetit jetësor të njerëzve dhe natyrës së shoqërisë së atyre vendeve.

Në vitin 921, Ahmed Ibn Fadlani ndërmori këtë udhëtim të mahnitshëm, i cili konsiderohet si një nga udhëtimet më të rëndësishme të komunikimit ndërkulturor në Mesjetë. Pikënisja e tij ishte Bagdadi, kryeqyteti i shkencës dhe kulturës për kohën.

Ai përshkoi një numër të madh vendesh dhe popujsh dhe i shënoi ngjarjet e dëshmitë e tij në një libër të madh, i cili u botua për herë të parë në vitin 1923, bazuar në dorëshkrimin e gjetur në Rusi.

Rëndësia e shënimeve të Ibn Fadlanit qëndron në faktin se, siç thotë shkencëtari amerikan Michael Crichton: “Muslimanët e Bagdadit, pavarësisht se ishin shumë fetarë, ishin të hapur me popujt që ndryshonin prej tyre nga pamja, besimi dhe mënyra e jetesës dhe në atë kohë kanë qenë nga popujt më pak lokalistë, çka i bëri dëshmitarë unikë të kulturave të huaja.” (Michael Crichton, *Eaters of the Dead*)



Kështu pra, Islami fton në një bashkëpjesëmarrje të njerëzve në ndërtimin dhe në zhvillimin e mbarë të qytetërimit, nxit bashkëpunimin dhe komunikimin e ndërsjellë mbi bazat e moralit të lartë, pavarësisht ndryshimit të kulturave dhe feve të tyre. Nga ana tjetër, Islami tërheq vëmendjen se izolimi dhe veçimi nga njerëzit nuk është rruga e drejtë, prandaj Profeti Muhamed (a.s.) e ka konsideruar atë që shoqërohet me njerëzit dhe duron lëndimin që vjen prej tyre, është më i mirë se ai që veçohet e largohet prej njerëzve. (Ibën Maxhe, 4032)



Një Krijues i Vetëm... Një i Adhuruar i Vetëm

Islami

Islami pohon se thjesht të besuarit në formë teorike nuk është i mjaftueshëm për të hyrë në besimin e vërtetë. Nëse pranohet teorikisht se Zoti e Krijuesi i gjithçkaje është një, atëherë edhe praktikisht e përmes adhurimeve, po Ai Zot duhet të jetë i Vetmi i Adhuruar të Cilit i bindesh dhe i nënshtrohesh.



Në gjuhën arabe, fjala “Allah” mbart tre kuptime të bashkuara në një:

- Ka kuptimin i Adhuruari, të Cilit njerëzit i kushtojnë ekskluzivisht lutjet, agjërimin, përkushtimin e zemrës dhe të gjitha adhurimet e tjera.
- Madhërishmi, i Cili është i tillë në qenien, atributet dhe lavdinë e Tij, aq sa mendja njerëzore shtanget para kësaj madhështie dhe e ka të pamundur ta perceptojë Atë plotësisht.

■ Është Ai, me të Cilin lidhen zemrat dhe shpirtrat deri në atë masë sa qetësohen duke e përmendur dhe ndiejnë kënaqësi nga afrimi me Të dhe adhurimi i Tij.

Kurani pohon se patjetër duhet të saktësohet përceptimi ndaj Zotit dhe se duhet të pastrohet nga të gjitha shtrembërimet dhe shpifjet që cenojnë madhësinë e Tij.

Zoti sqaron në Kuran se Ai është Krijuesi i universit dhe Ai i vendos rregullat në të. Çdo gjë në univers, sado e vogël qoftë ajo, ndodh me dëshirën dhe vullnetin e Tij. Ai e ka krijuar dhe di gjithçka. Asnjë femër, nga të gjitha krijesat, nuk mund të mbetet shtatzënë, dhe as nuk mund të lindë pa dijeninë dhe dëshirën e Zotit. Asnjë pikë shiu nuk mund të bjerë pa dëshirën e Tij; asnjë fenomen gjatë ditës apo natës, i dukshëm apo i fshehtë nuk mund të ndodhë pa dijen fuqinë dhe mëshirën e Tij, në asnjë anë të këtij universi (Fusilet: 47; El-En'am: 59).

Lavdiplotit i përkasin cilësitë më të mira, më të përkryera dhe më të përsosura.

Ai është i Gjithëfuqishmi që nuk mposhtet; është i Gjithëmëshirshmi që ka përfshirë gjithçka e gjithkënd në mëshirën e Vet, është Madhështori që nuk ka asnjë të metë në asnjë aspekt.

Disa pretendojnë se Allahu i krijoi qiejt dhe Tokën në gjashtë ditë, pastaj pushoi në ditën e shtatë. Kurani e mohon këtë pretendim duke thënë qartë: “Ne i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe çdo gjë që gjendet midis tyre për gjashtë ditë, pa ndier lodhje aspak.” (Kaf: 38). Këto pretendime, dhe të tjera të ngjashme me to, vijnë në mendje vetëm ngaqë e shëmbëllojnë Zotin me krijesat. Mirëpo Allahu është Krijuesi dhe gjithçka e gjithkush tjetër është krijesë. Si mund t’i ngjajë krijesa Krijuesit?! Allahu thotë: *“Asgjë e askush nuk i shëmbëllohen Atij. Ai i dëgjon gjitha dhe i sheh të gjitha.”* (Esh-Shura: 11)



Çështja më e qartë dhe e shtjelluar në Islam është detyrimi për të adhuruar vetëm Allahun dhe është pikësisht kjo ftesa e të gjithë Profetëve drejtuar popujve të tyre, siç thekson Kurani.



Allahu i Lartmadhëruar është i Drejtë dhe nuk i bën padrejtësinë më të vogël askujt (prandaj dhe nuk mund t'i atribuohet Atij padrejtësia). Nëse diçka në jetë na duket e padrejtë, kjo vjen sepse nuk kemi arritur të kuptojmë urtësinë dhe mirësinë hyjnore për atë gjë. Sikurse i vogli nuk i kupton e nuk i shpjegon disa veprime të prindërve të tij, për shkak të ndryshimit të madh midis tyre në kapacitetin mendor, ashtu edhe mendja njerëzore mund të mos e rrokë urtësinë e Allahut në disa prej krijimeve të Tij.

Për të hyrë në besim, Islami nuk mjaftohet vetëm me pohimin teorik se Krijuesi është Një, por kërkon që, si rrjedhojë, ky Krijues të jetë njëherësh i Vetmi që adhurohet. Prandaj nuk është e lejuar që ndonjë rit adhurimi a ndonjë lutje t'i drejtohet dikujt tjetër, veç Allahut. Adhurimi duhet të jetë vetëm për të Lartmadhërishmin, pa ndërmjetës të tjerë në mes, sepse Krijuesi është shumë i madh dhe i lartë për të pasur ndërmjetës.

Mbretërve dhe presidentëve në botë u duhen ndihmësit për të njohur gjendjen e popullit dhe më pas për t'i ndihmuar dhe për t'i drejtuar njerëzit. Ndërsa Zoti Fuqiplotë di, drejton dhe kontrollon të gjithë universin; po dëshiroi diçka, urdhëron që ajo të bëhet dhe ajo bëhet menjëherë... Atëherë përse i duhen drejtuar lutja dhe adhurimet dikujt tjetër, veç Zotit?!

Kurani pohon se zemra gjen qetësi dhe siguri të plotë vetëm kur besimtari “strehohet” te Zoti i tij dhe ia paraqet Atij të gjitha nevojat që ka, sepse Zoti është i Madhërishmi e i Fuqishmi për çdo gjë, është i Dashuri e i Buti me krijesat e Veta, është pranë tyre dhe gëzohet kur njerëzit i luten Atij; madje, Ai i nderon dhe i shpërblen njerëzit në atë masë që ata i luten dhe i përgjërohen (El-Bekare: 28; En-Neml: 62-63).

Prandaj çështja më e qartë që thekson me forcë Islami, i cili kujtojmë se është mesazhi i të gjithë Profetëve, është që adhurimi t’i kushtohet vetëm Allahut dhe askujt e asgjëje tjetër (En-Neml: 36). Pra, asnjë Profeti, asnjë engjëlli dhe asnjë shenjtori, sado të mirë e të devotshëm të kenë qenë, nuk mund t’u drejtohet asnjë lloj adhurimi apo lutjeje, me pretendimin se ata janë ndërmjetës midis Zotit dhe njerëzve.



Tek e fundit, ata janë vetëm krijesa të nënshtruara ndaj Zotit, ndërkohë që Zoti është pranë nesh, i dëgjon dhe i plotëson lutjet tona, nëse adhurimi dhe përkushtimi ynë janë vetëm për Të.

Si të mos e gjejë shijen e lumturisë, të prehjes dhe qetësisë ai që i përkushtohet me singeritet Zotit?! Nuk ka vend për pasiguri dhe as destabilitet, sepse Sunduesi është Një i Vetëm, Krijuesi është Një i Vetëm, i Adhuruari është Një i Vetëm, vetëm tek Ai kërkohet mbrojtje dhe strehim, dhe te askush tjetër përveç Tij.

Ky është kuptimi i një sureje (kapitulli) të shkurtër në Kuran, por që konsiderohet si njëra nga suret më të njohura dhe më të mëdha, surja “El-Ikhlâs” – “Singeriteti”.





LAUNCHING

CURIOSITY

CLICK HERE



Kurani konfirmon se gjithçka ndodh me Dijen dhe Pushtetin e Allahut. Madje, edhe pikat e shiut dhe gjethet e pemëve që bien.



Surja "El ihlas"

Aty Zoti e urdhëron Profetin Muhamed që të shpallë haptazi dhe qartë se kush është Allahu:

- Allahu është Një i Vetëm dhe nuk ka partnerë në adhurim.
- Allahu është Ai, të Cilit i drejtohen dhe i mbështeten të gjitha krijesat për plotësimin e nevojave të tyre.
- Allahu është i Dëlirë dhe tepër i lartë për të pasur fëmijë apo për të qenë i lindur, sepse Ai është i Pari dhe para Tij nuk ka asgjë.
- Allahu është i pakrahasueshëm dhe i pangjashëm me askënd për sa i përket Qenies dhe Atributeve të Tij, sepse çdo qenie tjetër veç Tij është e krijuar.



Midis ligjit të natyrës dhe ligjit të fesë

Zoti ka krijuar universin ku jetojmë, që nga qeliza më e vogël në trupin tonë, madje dhe pjesëzat më të vogla, e deri te galaktikat më të largëta që kanë mundur të na i afrojnë teleskopët. Gjithçka është krijuar me saktësinë më të madhe, me përsosmëri dhe sipas një sistemi mahnitës, pa të cilin jeta dhe natyra nuk do të ekzistonin. Të gjithë shkencëtarët e natyrës pohojnë se çdo anomali në këtë sistem, sado e vogël të jetë, do të sillte në mënyrë të pashmangshme shkatërrim dhe rrënim...

Muslimani beson se Krijuesi i këtij sistemi të mahnitshëm në saktësinë dhe perfeksionin, është Ai i Cili e di çfarë është më e dobishme për krijesat e Tij prej ligjeve, dispozitave dhe sistemit të jetës. Feja që Ai ka legjitimuar është i vetmi sistem nëpërmjet të cilit rregullohet jeta e njerëzimit dhe shpëton nga tirania e njërës palë mbi tjetrën... Zoti që krijoi universin dhe njerëzimin, Ai që e di se çfarë u bën dobi njerëzve ka thënë në Kur'an: *"E si mos e dijë Ai që ka krijuar gjithçka, kur Ai njuh çdo gjë me imtësi dhe është i Gjithëinformuari?!"* (El-Mulk: 14)




LAUNCHING

CURiOsITY

CLICK HERE





Në Islam nuk ka kler

Shohim se shumë fe u kanë dhënë privilegje fetare disa individëve mbi të tjerët, duke e kushtëzuar saktësinë e riteve dhe të besimit të njerëzve me miratimin e këtyre individëve. Sipas këtyre besimeve, individë të tillë janë ndërmjetësit midis njerëzve dhe Zotit, janë ata që japin indulgjencë dhe ndoshta zotërojnë dijen e fshehtë; kundërshtimi i tyre konsiderohet shkak për humbje.

Islami nuk përmban një funksion të quajtur njeri i fesë - kler, sepse e ka nderuar lart njeriun dhe e ka çliruar nga çdo autoritet shpirtëror pretendontë jetë "ndërmjetës" midis njeriut dhe Zotit. Kësisoj Islami e ka hedhur poshtë idenë se lumturia e njeriut, pendesa apo adhurimet e tij janë të lidhura me persona të caktuar, sado të mirë e të devotshëm qofshin këta.





Islami e ka nderuar njeriun dhe e ka lartësuar në gradën më të lartë, duke e çliruar nga çdo lloj autoriteti fetar e shpirtëror që të qëndrojë mes tij dhe Zotit. Në islam, lumturia e njerëzimit, mundësia e çdo kujt për tu penduar, apo për të përkushtuar adhurimet e isinqerta, nuk është e lidhur me ndonjë person të veçantë, sado e lartë që të jetë grada e këti personi dhe mirësia e tij.

Ashtu sikurse e ka çliruar njeriun nga çdo autoritet shkencor që pretendon monopolin e diturisë fetare. Kurani jo vetëm që e njeh diturinë fetare si e drejtë që duhet ta mësojnë të gjithë njerëzit, por e konsideron atë detyrim për ta, sepse i urdhëron të gjithë muslimanët që ta lexojnë e ta kuptojnë Kuranin, t'i përsiatin kuptimet e tij dhe të zbatojnë mësimet e tij (Sad: 29).

Besimi dhe adhurimet janë ndërmjet njeriut dhe Zotit të tij. Askush prej njerëzve nuk është i privilegjuar dhe nuk mund të bëjë rolin e ndërmjetësit. Zoti i Lartësuar është pranë krijesave të Tij; e dëgjon lutjen e njeriut dhe i përgjigjet atij; e shikon adhurimin adhuruesit dhe e shpërblen për të. Askush prej njerëzve nuk ka të drejtë të japë indulgjencë. Kur njeriu pendohet dhe është i singertë në pendimin e tij, ai e meriton faljen e Zotit.



Zoti është pranë të gjithëve sa herë që ata i drejtohen dhe i luten Atij, sikurse thotë Zoti i Lartësuar në Kur'an: "*Kur robërit e Mi, (besimtarë) të pyesin për Mua, (thuaju se) Unë jam pranë, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, le t'i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të Më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë.*" (El-Bekare: 186)





“

Kurani përcakton se Allahu është i afërt me të gjithë ata që kthehen tek Ai dhe i drejtohen me lutje.


A ka rituale të veçanta për të hyrë në Islam?

Kush bindet dhe vendos të pranojë Islamin nuk duhet të bëjë ndonjë ritual të veçantë, as ta bëjë pranimin e tij në ndonjë vend të caktuar dhe në prani të ndonjë personaliteti të caktuar. Gjithçka që duhet të bëjë, nëse dëshiron të bëhet musliman, është të shqiptojë dy dëshmitë e besimit, duke qenë i vetëdijshëm për kuptimin e tyre, i sigurt për vërtetësinë e tyre dhe i bindur ndaj kuptimit të tyre. Dy dëshmitë janë:

- 1- “Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër, përveç Allahut”, në kuptimin: Dëshmoj se askush tjetër nuk meriton të adhurohet, përveç Allahut, prandaj vetëm Atë adhuroj e askënd tjetër.
- 2- “Dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut”, në kuptimin që Muhamedi është i Dërguari i Zotit për mbarë njerëzimin, prandaj u bindem urdhreve të tij, largohem nga ndalesat e tij dhe e adhuroj Zotin sipas normave dhe mënyrës që ai ka ligjëruar.



**Cilët janë profetët
në të vërtetë?**



Zoti

Zoti i krijoi njerëzit që t'ia kushtojmë adhurimin Atij dhe dërgoi tek ata Profetë që t'u mësojnë njerëzve ligjet dhe fenë e Tij. Profetët punojnë për ndreqjen e gabimeve të njerëzve dhe zgjidhjen e problemeve të tyre. Ata janë shembull i mirë për popujt e tyre, i ruajnë nga devijimi dhe u bëjnë thirrje që të ndjekin rrugën e drejtë. Pas dërgimit të Profetëve, njerëzit nuk kanë argument për braktisjen e besimit. Cila është e vërteta e këtyre Profetëve?



Natyrë njerëzore e Profetëve

Kurani pohon në shumë versete të tij se të gjithë Profetët janë njerëz të cilët Zoti i dalloi nga të tjerët me Shpallje dhe Profeci. Edhe pse ekziston ngjashmëria sa i përket natyrës njerëzore ndërmjet nesh dhe Profetëve, pa dyshim ata janë në një shkallë të lartë të pastërtisë dhe integritetit, sepse Zoti i zgjodhi ata për të përcjellë Mesazhin dhe Fenë e tij tek njerëzit, sikurse thuhet të Kuran: "Thuaj: *"Unë jam vetëm një njeri, sikurse ju që më është shpallur..."* (El-Kehf:110)

Kësisoj, të gjithë Profetët janë njerëz, lindin, vdesin dhe sëmuren si njerëzit dhe nuk kanë ndryshim prej tyre në strukturën trupore apo në nevojat fizike.

Asnjë prej tyre nuk ka diçka prej natyrës hyjnore, sepse Zoti është Një i Vetëm, ndërsa ata janë njerëz të cilëve Zoti ua ka besuar Mesazhin e Vet, d.m.th. ata pranojnë urdhërin e Zotit që u vjen nëpërmjet engjëjve apo me mënyra të tjera.

Popujt e mëparshëm kanë shprehur habinë e tyre për shpalljen hyjnore, por Zoti e ka qortuar si të paarsyeshme këtë habi dhe ka sqaruar se shpallja hyjnore është mënyra për të përcjellë tek njerëzit udhëzimin dhe mësimet e fesë së Tij (Junus: 2).

Qëndrimi i mesëm në lidhje me pozitën e Profetëve

Zoti zgjodhi krijesat më të mira për të mbartur amanetin e Profecisë. Ata janë njerëz në shkallën më të lartë të integritetit dhe mirësisë. Kurani i përshkruan Profetët si njerëz të udhëzuar në rrugën e drejtë, bamirës e të zgjedhur; janë krijesat më të mira në botë.

Në qoftë se njëri nga Profetët bie në gabim, Zoti nuk e lejon atë të qëndrojë në gabim, por i tërheq vërejtjen që të bëjë kthesë e të pendohet. Sigurisht që ato janë gabime nxitimi dhe jo shkelje të qëllimta të kërkesave të Zotit.

Në këtë mënyrë, ne shohim që Kurani i përshkruan Profetët saktësisht e në detaje, pa i hiperbolizuar dhe pa i nënçmuar. Ata janë të mbrojtur nga mëkatet e mëdha, e megjithatë janë njerëz dhe jo hyjni, as bijtë e hyjnive. Ata nuk kanë asgjë prej karakteristikave hyjnore.

Kjo pikëpamje shprehet qartë në dialogun që rrëfen Kurani e që do të ndodhë Ditën e Gjykimit midis Zotit dhe Profetit Jezu (Isa a.s.), me anë të të cilit Zoti e shfaqëson Jezuin (Isain) nga hyjnizimi që i kanë bërë njerëzit atij:




Kurani pohon se Profetët janë të gjithë qenie njerëzore që janë të dalluar nga Allahu me anë të zbulesës dhe mesazhit hyjnor.

“Pastaj Zoti do të thotë (në Ditën e Gjykimit): “O Jezu,(Isa) i biri i Maries! Ti ishe ai që u the njerëzve: “Adhuromëni mua dhe nënën time si zota krahas Allahut?!” Jezui do të thotë: “Qofsh i lartësuar dhe i lavdëruar! Mua nuk më takon të them diçka, për të cilën nuk kam aspak të drejtë! Po ta kisha thënë ndonjëherë, Ti me siguri do ta dije. Ti e di çfarë ka në shpirtin tim, po unë nuk e di çfarë ka në Veten Tënde. Vetëm Ti i di të gjitha të fshehtat.



Unë nuk u kam thënë asgjë tjetër, përveç asaj që më ke urdhëruar Ti: *"Adhuroni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj!"* Kam qenë dëshmitar, për sa kohë që kam jetuar midis tyre dhe, qëkurse më more mua, vetëm Ti ishe mbikëqyrës i tyre. Ti je Dëshmitar për çdo gjë." (El-Maide: 116-117)





Kurani e ka përmendur Emrin e Jezusit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) duke e vlerësuar e ngritur shumë lart figurën e tij dhe duke e çliruar e dëshmuar pastërtinë e tij nga çdo shpifje e trillim në jo më pak se 25 herë. Emrin e Musait e ka përmendur 136 herë. Ndërsa emrin e Muhamedit, paqja dhe bekimet qofshin mbi të e ka përmendur vetëm 5 herë.

Qëndrimi i Islamit ndaj Profetëve

Disa njerëz mendojnë se Kurani nuk është gjë tjetër vetëm se histori për të Dërguarin e Zotit, Muhamedin (a.s.). Ata habiten kur mësojnë se në Kuran përmendet emri i Jezusit (Isait a.s.) për të lartësuar pozitën e tij dhe duke e shfajësuar nga akuzat e pavërteta 25 herë. Emri i Moisiut (Musai a.s.) përmendet 136 herë, ndërkohë që emri i Muhamedit (a.s.), të cilit iu shpall Kurani, përmendet vetëm 5 herë.



Ndërsa shumica e ithtarëve të feve tani nuk pranojnë vetëm se Profetët e tyre dhe disa prej tyre i luftojnë Profetët e tjerë, çdokush që e lexon Kuranin, në shumë versete të tij, gjen se njeriu nuk mund të quhet musliman derisa t'i besojë të gjithë Profetët. Nëse ai mohon qoftë edhe njërin prej tyre apo dyshon në vërtetësinë e Profecisë së tij, apo e akuzon atë rrejshëm, ky njeri del prej Islamit. Kurani pohon se i Dërguari dhe gjithë ata që i besojnë atij, besojnë në atë që është shpallur nga Zoti. Ata besojnë te Zoti, te engjëjt, te të Dërguarit dhe nuk bëjnë dallim mes asnjërit prej të Dërguarve, sa i përket besimit tek ata.

Kush e lexon Kuranin, sheh se disa nga kapitujt e tij titullohen sipas emrave të Profetëve, si: Abraham (Ibrahim a.s.), Jozef (Jusuf a.s.) etj. Madje një nga kapitujt është quajtur me emrin e së virtytshmes Mari (Merjeme), nënës së Jezu Krishtit (paqja qoftë me të!).

Qëndrimi i Islamit ndaj Jezuit (paqja qoftë me të!)



Jezusi

Jezusi (Isai a.s.) konsiderohet një prej figurave më të rëndësishme në histori, prej atyre që i ka dhënë shumë njerëzimit. Njerëzit ndajnë qëndrime të ndryshme sa i përket figurës së tij. Ka prej tyre që e konsiderojnë zot apo bir të zotit; ka dhe nga ata që e luftojnë, i përshkruajnë cilësitë më të ulta dhe e akuzojnë me akuza të pavërteta. Po cili është qëndrimi i Islamit ndaj Jezusit?



1 Jezui është një ndër Profetët më të mëdhenj

Kurani pohon se Jezusi (Isai a.s.) është një ndër Profetët më të mëdhenj dhe gëzon pozitë më të larta; nëna e tij Maria (Merjemi) ishte e besueshme, e bindur dhe adhuruese e singertë e Zotit të saj. Ajo ishte e ndershme, e ruajtur nga mëkatet dhe e virgjër. Falë fuqisë së Zotit të Lartësuar që bën gjithçka që dëshiron, ajo mbeti shtatzënë me Jezusin; Jezusi erdhi në jetë ka baba. Krjimi i tij është një mrekulli e jashtëzakonshme, sikurse u krijua Adami (Ademi a.s.) pa baba dhe pa nënë. Zoti në Kuran sqaron se Jezusi është një mrekulli e përjetshme. Zoti sikurse e krijoi Adamin pa baba dhe pa nënë, po ashtu krijoi Jezusin pa baba me fuqinë e Tij, sepse kur ai dëshiron të bëhet diçka, thotë: "Bëhu!" dhe ajo bëhet menjëherë: *"Rasti i Isait për Allahun është si rasti i Ademit që e krijoi prej baltës e pastaj i tha: "Bëhu!" - dhe ai u bë."* (Al Imran 59)



2 Muslimani i beson mrekullitë e Jezuit

Muslimani i beson mrekullitë që Zoti i ka dhënë Jezuit, siç janë shërimi i të lebrosurve dhe i të verbërve, ngjallja e të vdekurve, njoftimi i njerëzve për ushqimin që hanin a ruanin në shtëpitë e tyre etj. Të gjitha këto mrekulli kanë ndodhur me fuqinë dhe vullnetin e Zotit të Lartmadhërishëm dhe kanë qenë argument i qartë për vërtetësinë e Profecisë dhe të Mesazhit të Jezuit.

3 Zoti i ka dhënë Jezuit librin e shenjtë, Ungjillin

Kurani pohon se Zoti i shpalli atij një prej librave të Tij më madhështorë, Ungjillin, që është udhëzim për njerëzit, dritë dhe mëshirë. Gjithashtu na tregon se përgjatë historisë Ungjilli pësoi ndryshime dhe devijime.




4 Jezui është njeri dhe jo hyjni

Islami pohon se Jezusi (Isai a.s.) është njeri prej Bijëvë e Izraelit. Zoti e përzgjedhi dhe e dërgoi si Profet tek Bijtë e Izraelit. Vërtet i dha mrekulli, por Jezusi nuk ka asgjë prej cilësive hyjnore, sikurse thotë Zoti në Kuran që Jezusi nuk ishte gjë tjetër vetëm se një rob i mirë të cilin e begatuam dhe i dhamë mrekulli për të qenë shenjë dhe argument i mirësisë për popullin e tij. *"Isai ishte vetëm një rob, të cilit Ne i dhuruam Profeci dhe e bëmë shembull për Bijtë e Izraelit."* (Ez-Zuhruf: 59)

5 Jezui nuk është kryqëzuar, por është ngritur në qiell

Sipas pikëpamjes islame, Jezui nuk është vrarë e nuk është kryqëzuar, por Zoti e ka ngritur në qiell. Kur armiqtë kërkuan ta vrisnin Jezuin, Zoti bëri dikë tjetër të ngjashëm me të, kështu që ata vranë të ngjashmin, ndërsa Jezuin Zoti e ngriti të gjallë në qiell, siç pohon Kurani (En-Nisa: 157-158).



Pema e Profetëve

Të Dërguarit e Zotit janë shumë, disa nga më të shquarit e tyre (paqja e Zotit qoftë mbi ta!) janë:


Adami (Ademi a.s.):

Babai i njerëzimit.

Zoti e krijoi nga dheu, i bëri engjëjt t'i përulen atij dhe e zbriti atë nga Parajsa në Tokë.

Noe (Nuhu a.s.):

Profeti që predikoi mes popullit të tij për një kohë shumë të gjatë, por ata e mohuan, prandaj u dënuan me Përmbytjen e Madhe, prej së cilës shpëtuan vetëm ata që i besuan atij dhe hipën në anijen e tij.



Abrahami (Ibrahimi a.s.):


Babai i Profetëve, një nga të Dërguarit më të mëdhenj që predikuan besimin në një Zot, i pari që ndërtoi Qabenë, drejtimin nga falen muslimanët.

Ishmaeli (Ismaili a.s.):

Biri i Abrahamit (Ibrahimit), ndihmësi i tij në ndërtimin e Qabesë.

Isaku (Is'haku a.s.):

Biri tjetër i Ibrahimit (a.s.) erdhi në jetë pasi engjëjt e përgëzuan babain e tij, Ibrahimin se Zoti do t'i dhuronte një djalë.



Jakubi:

Biri i Is'hakut (a.s.) është quajtur gjithashtu "Izrael"; me të e identifikojnë veten Bijtë e Izraelit.

Jozefi (Jusufi a.s.):

Biri i Jakubit (a.s.) pësoi disa sprova, pastaj më në fund u bë sundimtar i Egjiptit.

Moisiu (Musai):

Një nga Profetët më të mëdhenj që Zoti ka dërguar te izraelitët. Zoti i shpalli atij librin e shenjtë, Torah (Teurat), dhe e mbështeti me mrekulli në misionin e tij për t'i nxjerrë izraelitët nga skllavëria në Egjipt. Faraoni i atëhershëm e mohoi, prandaj Zoti e mbyti Faraonin dhe i shpëtoi Moisiun dhe ndjekësit e tij, në mrekullinë e hapjes së Detit të Kuq.



Davidi (Daudi a.s.):


Profet, të cilin Zoti e bëri edhe mbret të popullit të tij, izraelit.

Salomoni (Sulejmani a.s.):

biri i Daudit (a.s.); ishte Profeti të cilit Zoti i dha sundim dhe pushtet të madh; i nënshtroi atij shumë krijesa.

Zakaria (Zekerija a.s.):

Një nga Profetët e Zotit nga populli izraelit. Ishte kujdestari i Maries (Merjemes), nënës së Jezuit (Isait), përgjegjës për edukimin dhe mësimin e saj. Pavarësisht se ishte i moshuar dhe gruan e kishte beronjë, Zoti i dhuroi një djalë, Profetin Gjon (Jahja a.s.).



Jezui (Isai a.s.):

Një nga Profetët më të mëdhenj, të cilin Zoti e krijoi mrekullisht pa baba, por vetëm me nënë. Zoti e dërgoi tek izraelitët dhe i shpalli librin e shenjtë, Ungjillin (Inxhili) si dhe e mbështeti me mrekulli të shumëllojshme.

Muhamedi (a.s.):

Vula e Profetëve, u dërgua nga Zoti i tij për mbarë njerëzimin, dhe njekohësisht si vërtetues i gjithë Profetëve të tjerë para tij. Atij iu shpall Kurani, të cilit nuk i afrohet e kota nga asnjë anë.



Kush është Profeti i Islamit?

Muhammad

Muhamedi është emri i Profetit të Islamit.

Është një nga emrat më të përhapur në mbarë botën sot . Emri “Muhammed” do të thotë: “Ai që njerëzit e lavdërojnë dhe admirojnë për etikën, moralin dhe veprimet e tij.

Atëherë kush është Muhamedi?

Emri i Profetit të Islamit:

Muhamed Ibn Abdullah Ibn Abdulmuttalib
Ibn Hashim El-Kureshi.

570 – 632 e.s.

Të gjithë muslimanët besojnë se:

Ai është i Dërguari i Zotit për mbarë njerëzimin:

Zoti e dërgoi Muhamedin (a.s.) për të gjithë njerëzit, pavarësisht racës, ngjyrës a etnisë; pranimi dhe pasimi i tij janë detyrë për të gjithë. Kurani thotë në lidhje me këtë çështje: "*Thuaj (o Muhamed): O njerëz, unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju...*" (El-A'raf: 158)

Atij iu shpall Kurani:

Zoti i shpalli Muhamedit Librin e Vet të fundit dhe më të madhin, Kuranin, të cilit nuk mund t'i afrohet e pavërteta nga asnjë aspekt.

I fundmi i Profetëve dhe të Dërguarve:

Zoti e dërgoi Muhamedin (a.s.) të fundit në radhën e Profetëve. Ai është Vula e Profetëve; nuk ka Profet tjetër pas tij. Sikurse thotë Zoti në Kuran: *"Ai është i Dërguari i Allahut dhe Vula e Profetëve."* (El-Ahzab: 40)



Një përshkrim i shpejtë për t'u njohur me Muhamedin

1. Lindja

Profeti (a.s.) lindi në perëndim të Gadishullit Arabik në vitin 570. Pak para se të lindte, i vdiq i ati, ndërsa nënën e humbi në moshë të vogël. Për këtë arsye, në fillim kaloi nën kujdestarinë e gjyshit të vet e më pas u rrit nën kujdesin e xhaxhait të tij, Ebu Talib.

2. Jeta e hershme

Muhamedi (a.s.) jetoi mes fisit të tij Kurejsh për 40 vjet para Profecisë (570 – 609 e.s.). Ishte shembull për moralin e mirë, maturinë dhe mençurinë. Njihej mes tyre me epitelin “besniku i ndershëm”. Në fillim punoi si bari e më pas punoi në tregti.

Para shpalljes së Islamit, Profeti (a.s.) ishte monoteist, adhuronte një Zot sipas fesë së Profetit Abraham (Ibrahim a.s.), ndërsa refuzonte adhurimin e idhujve dhe praktikat pagane. E megjithatë ishte i pamësuar, nuk dinte shkrim e këndim.

3. Marrja e misionit profetik

Pasi mbushi moshën 40 vjeç, i Dërguari i Zotit (a.s.) meditonte dhe e adhuronte Zotin në shpellën Hira në malin Nur (një prej maleve afër Mekës). Pikërisht në këtë kohë i vjen shpallja nga Zoti, filloi zbritja e Kuranit. Fjala "Lexo" ishte e para fjalë që iu shpall prej Kuranit: "*Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (çdo gjë).*" (El-Alak: 1)

Me këtë urdhër publikohet se kjo Profeci ishte fillimi një epoke të re në fushën e diturisë e të studimit. Tashmë filloi epoka e dritës dhe udhëzimit për njerëzimin. Pastaj zbritja e Kuranit vazhdoi për 23 vite.



4. Fillimi i thirrjes së tij

Profeti Muhamed (a.s.) e filloi predikimin e fesë së Zotit në fshehtësi për tre vitet e para dhe më pas e predikoi haptas në Mekë për dhjetë vite të tjera. Pasuesit e tij ishin më së shumti nga shtresat e dobëta dhe të varfërit, siç ka ndodhur me të gjithë Profetët e tjerë para tij. Gjatë kësaj kohe Profeti (a.s.) dhe besimtarët u përndoqën, u dhunuan dhe vuajtën nga padrejtësitë më të rëndat prej fisit Kurejsh. Pastaj ua predikoi Islamin fiseve që vinin në Mekë për pelegrinazh. Banorët e qytetit të Medinës e pranuan Islamin dhe muslimanët e Mekës filluan të emigronin atje pak e nga pak.

5. Emigrimi i tij (*hixhreti*)

Pas një komploti vrasës që thuri kundër tij paria e fisit Kurejsh, Profeti Muhamed (a.s.) emigroi në vitin 622, në moshën 53-vjeçare, drejt qytetit të Medinës, i cili atëkohë quhej Jethrib. Atje Profeti jetoi për dhjetë vjet; predikoi Islamin dhe sanksionoi faljen (namazin), dhënien e lëmoshës (zekatin), normat morale dhe të gjitha normat e tjera të fesë.



6. Përpyjekjet e tij për përhapjen e Islamit


Profeti Muhamed themeloi bërthamën e qytetërimit islam në Medinë pas emigrimit të tij atje (622 – 632). Atje ravijëzoi tiparet e shoqërisë islame: zhduku tribalizmin, përhapit diturinë, vendosi themelet e drejtësisë, të sjelljes së drejtë, të vëllazërisë dhe të sistemit shtetëror. Disa fise u përpoqën ta mbysnin që në embrion Islamin dhe për këtë arsye ndodhën një seri luftërash e betejash, në të cilat Zoti nxori triumfues fenë dhe Profetin e Tij. Më pas hynë në Islam njëri pas tjetrit shumica e qyteteve dhe fiseve të Arabisë, të bindur për madhësitinë e kësaj feje.



7. Vdekja e tij

Në muajin hënor Sefer (sipas kalendarit islam), në vitin e njëmbëdhjetë pas emigrimit, Profeti (a.s.) u sëmur me ethe, pasi e përcolli mesazhin hyjnor dhe pasi Zoti e përsosi dhuratën e Tij për njerëzit, fenë islame. Sëmundja iu përkeqësua dhe ndërroi jetë ditën e hënë të muajit Rebijul Euel (sipas kalendarit islam), që përkon me datën 8/6/632, në moshën 63-vjeçare. U varros në dhomën e bashkëshortes së tij, Aishes, pranë Xhamisë Profetike.





**Muhamedi, i Dërguari i
Zotit, në vështtrimin e
një njeriu objektiv**

Një

Një njeri objektiv, i çfarëdo kulture qoftë, kur studion jetëshkrimin e Profetit Muhamed (a.s.), nuk mund të mos mahnitet me të gjitha momentet e saj. Dijetarët, filozofët dhe shkrimtarët e Lindjes e të Perëndimit e kanë dëshmuar këtë në librat dhe artikujt e tyre. Për shembull:



Mahatma Gandhi ka thënë në gazetën "Young India" të viti 1924: "Desha të njoh cilësitë e burrit që zotëron pa diskutim zemrat e miliona njerëzve... U binda

plotësisht se shpata nuk ka qenë mjeti me të cilin Islami ka arritur pozitën e tij. Përkundrazi, mjeti ka qenë Profeti me kujdesin dhe sinqeritetin e tij në përmbushjen e premtimeve, me përkushtimin dhe pastërtinë të tij ndaj shokëve dhe pasuesve të vet, me trimërinë dhe besimin absolut në Zotin dhe në misionin e tij. Këto cilësi janë ato që ia shtruan rrugën dhe ia sheshuan vështirësitë e jo shpata. Pasi mbarova së lexuari vëllimin e dytë të biografisë së Profetit, ndjeva keqardhje që nuk mund të gjeja materiale shtesë për ta njohur më shumë jetën e tij madhështore."

Në librin 'Vepra të zgjedhura' Vëll. 25, fq.127.



Doja të dija cilësitë e njeriut që zotëron, pa asnjë dyshim, zemrat e miliona njerëzve!
... Jam bindur se nuk ishte shpata mjeti përmes të cilit Islami fitoi vendin e vet»

Gandi




Majkëll Hart (Michael H. Hart):

Në librin e tij të famshëm "The 100: A Ranking of the Most Influential Persons in History", sqaron pse e ka vënë Muhamedin (a.s.) në krye të listës:

"E zgjodha Muhamedin për të qenë i pari në radhën e burrave më të rëndësishëm dhe më të mëdhenj të njerëzimit dhe kjo mund t'i habisë lexuesit. Por ai është burri i vetëm në të gjithë historinë që ka ngadhënjyer në të dy nivelet: atë tokësor dhe atë fetar."

Në librin e tij: '*The 100: A Ranking of the Most Influential Persons in History*' -

"Renditja e personave më me influencë në histori"(fq.3).





Poeti i famshëm Alfons De Lemar- tin,

në librin e tij: "His-
toria e Turqisë" thotë:
"Nëse qëllimi i lartë,
mjetet modeste dhe
produktiviteti gjigand
janë tre kriteret e gjeniut
njerëzor, kush mund të

guxonte të krahasonte çdo njeri të madh në
historinë moderne me Muhamedin?!"

(Në librin e tij: "Historia e Turqisë" Vëll. 1, fq.
111)






Filozofi indian Kon- eru Ramakrishna

Roa thotë: (Rrethanat ndryshuan, mirëpo Muhamedi nuk ndryshoi, qoftë në fitore apo në humbje, kur ishte në pushtet apo në vështirësi, në bollëk

apo në mjerim. Ai mbeti i njëjti person dhe me të njëjtat cilësi, siç është vullneti i Zotit për të gjithë Profetët të cilët kurrësesi nuk mund të ndryshojnë.

(Në librin e tij: "Mhuhammad The Prophet of Islam" "Muhamedi Profeti i Islamit", fq 24)





German poet, playwright, novelist and statesman, Johann Wolfgang von Goethe wrote a

famous poetic drama in praise of Prophet Muhammad (PBUH), which

he called *Mahomets Gesang* "The Song of Muhammad". He admired Islam so much that he once remarked, "Even though I am seventy-seven years old, my admiration for Islam has never slackened in the least and that it was increasing and getting all the more established." Goethe und die arabische Welt p. 177.

Profesor Stobarti thotë: "Në gjithë historinë njerëzore nuk gjendet ndonjë shembull që i afrohet personalitetit të Muhamedit. Sa pak mjete materiale posedonte ai dhe sa shembuj heroizmi të rrallë na ka dhënë! Nëse ne do ta studionim historinë në këtë aspekt, nuk do të gjenim ndonjë një emër më të shkëlqyer dhe më të qartë sesa emri i Profetit Arab."

(Marrë nga libri: "Islam and Its Founder" - "Islami dhe themeluesi i tij" fq. 227-228).





Simon Ockley në librin e tij për historinë e perandorisë muslimane shkruan: “Nuk është përhapja e fesë islame ajo që meriton mahnitjen tonë, por vazhdimësia dhe stabiliteti i saj ndër shekuj.

Mbresat e mrekullueshme që la Muhamedi në Mekë dhe në Medinë, vazhduan të mbeten me të njëjtën bukuri dhe fuqi në shpirtrat e indianëve, afrikanëve dhe turqëve si tek ata (shokët e tij) që jetuan në kohën e shpalljes së Kuranit.

(Marrë nga libri i tij: “History of the Saracen Empire” fq. 45)



Përshtypja e mrekullueshme dhe gjurmët e pashlyeshme që Muhamedi ka lënë në Mekë dhe Medinë, akoma ka të njëjtën madhësi dhe fuqi në zemrat e indianëve, afrikanëve dhe turqve, të cilët janë të rinj në besimin në këtë Kuran. Simon Oakley



Ëill Durant shkruan kështu në enciklopedinë e tij të famshme "Historia e qytetërimit" (13 / 45-47):



"Nëse e gjykojmë madhështinë nga ndikimi, Muhamedi ishte një nga gjigantët e historisë. Ai mori përsipër të rriste nivelin shpirtëror dhe moral të një populli të lodhur nga barbaria, nga nxehtësia dhe thatësia e shkretëtirës. Dhe ai arriti sukses më të plotë se çdo reformatör tjetër; të rrallë janë ata që kanë përmbushur kaq plotësisht ëndrrën e tyre. Ai e realizoi qëllimin e tij nëpërmjet fesë, jo vetëm për shkak se vetë ishte fetar, por sepse asnjë mjet tjetër nuk mund t'i lëvizte arabët e kohës së tij. Ai u bëri thirrje imagjinatës, frikës dhe shpresave të tyre dhe u foli me terma që ata mund t'i kuptonin. Kur ai filloi, Arabia ishte një shkretëtim e thatë e banuar nga fise idhujtarësh dhe kur ai vdiq, ajo ishte një komb i bashkuar. Ai e frenoi fanatizmin dhe besëtytnitë... Përmbi Judaizmin, Zoroastrianizmin dhe besimin e vendlindjes së tij, ai ngriti një fe të thjeshtë, të qartë e të fortë dhe një strukturë morale të mbështetur mbi trimërinë e ashpër dhe krenarinë kombëtare, çka bëri që brenda një gjenerate kjo fe të arrinte njëqind fitore dhe brenda një shekulli të bëhej perandori, duke mbetur edhe sot një fuqi e konsiderueshme në pothuaj gjysmën e botës."

Në librin e tij: The Story of Civilization: The age of faith

"Historia e qytetërimit: Mosha e besimit" (Pjesa e katërt, fq.174)



Një nga bashkëkohësit e Muhamedit, Ebu Sufjani, armik i egër i tij para se të bëhej musliman, tregon një histori të çuditshme që i ndodhi kur nuk ishte akoma musliman. Herakliut, mëkëmbësit bizantin të Sirisë, i kishte ardhur një letër nga Muhamedi, ku e ftonte atë të pranonte Islamin. Herakliu u habit nga letra dhe kërkoi t'i çonin një arab që e njohte Muhamedin dhe që ishte i afërm i tij. Ebu Sufjani, atëkohë kreu i fisit Kurejsh të Mekës dhe armiku më i betuar i Muhamedit, ndodhej në Siri për tregti. E thirrën atë së bashku me njerëzit e tij në pallatin mbretëror dhe Herakliu nëpërmjet përkthyesit i bëri disa pyetje shumë të zgjuara e të mençura, për të njohur sa i sigurtë ishte Muhamedi (a.s.) në përgjithësi. Kur dëgjoi përgjigjet, Herakliu i tha Ebu Sufjanit:

“Të pyeta për prejardhjen e tij (Muhamedit) dhe më the se ishte i fisëm midis jush; të tillë janë Profetët në popujt ku dërgohen. Të pyeta nëse ndonjëri prej jush ka predikuar më parë atë që predikon ai dhe më the “jo”. Në qoftë se dikush para tij do të kishte predikuar diçka të tillë mes jush, do të thosha se po imitonte atë.

Të pyeta nëse e akuzonit si gënjeshtar para se të pretendonte Profecinë dhe më the “jo”; prandaj mendoj se nuk ka mundësi që ai i cili nuk gënjente as njerëzit, tashmë të shpifë për Zotin!

Të pyeta nëse ata që e pasojnë janë nga paria apo nga shtresat e dobëta të njerëzve dhe më the se të pafuqishmit janë ata që i shkojnë pas; pikërisht këta janë pasuesit e Profetëve. Të pyeta nëse pasuesit e tij shtohen apo pakësohen dhe më the se ata shtohen; kështu është çështja e besimit, derisa të plotësohet.

Të pyeta nëse e ka lëshuar ndokush fenë e tij i pakënaqur prej saj dhe më the “jo”; i tillë është besimi kur gëzimi i tij depërton thellë në zemër.


Të pyeta nëse ai tradhton dhe më the “jo”; të tillë janë Profetët, nuk tradhtojnë.

Të pyeta se çfarë ju urdhëron dhe më the se ju urdhëron të adhuronit një Zot të vetëm, pa i shoqëruar Atij partnerë, se ju ndalon të adhuronit idhujt dhe se ju urdhëron të faleni, të jeni të singertë dhe të virtytshëm...

Nëse kjo që thua është e vërtetë, atëherë ai ka për të sunduar tokën që është nën këmbët e mia. E dija se ai do të vinte, por nuk mendoja se ishte nga ju. Sikur ta dija se do të kem mundësi për ta takuar, do të bëja ç'është e mundur për ta takuar." (El-Buhari: 7)

A close-up photograph of a young bird, possibly a sparrow, perched on a nest made of dry grass and twigs. The bird has brown and grey speckled feathers and its beak is wide open, showing a bright orange interior. The background is a soft-focus green, suggesting foliage.

Histori nga jeta e Profetit Muhammed dhe moralitij



I Dërguari i Allahut (a.s.) ishte shembulli më i mirë i moralit njerëzor. Ky fakt është dëshmuar nga të gjithë njerëzit e drejtë dhe objektivë prej Lindjes dhe Perëndimit, madje edhe nga armiqtë e tij. Ai e meritoi të përshkruhet në Kuran si njeri me virtyte madhështore.



Kur e pyetën gruan e tij Aishen (r.a.) për moralin e Muhamedit, e të Dërguarit të Zotit, ajo nuk gjeti përshkrim më të saktë për të shprehur moralin e tij sesa shprehja: "Moralin e tij ishte Kurani." D.m.th.: ai ishte një model praktik për zbatimin e mësimave të Kuranit dhe moralit të tij.

Kjo është një përmbledhje e shkurtër e historisë dhe moralit të tij:

Thjeshtësia

Profetit Muhamed (a.s.) nuk i pëlqente që të tjerët të ngriheshin në këmbë në shenjë madhërimi për të. Madje ua ndalonte shokëve një veprim të tillë, saqë ata, me gjithë dashurinë e madhe që kishin për të, nuk ngriheshin nga vendi kur e shihnin të afrohej, vetëm ngaqë e dinin se ai e urrente diçka të tillë (Ahmed 12345).

Adij Ibn Hatim, një nga fisnikët arabë, para se të pranonte Islamin shkoi te Profeti Muhamed për të mësuar të vërtetën e thirrjes së tij. Ai e tregon kështu ngjarjen: "Shkova te Profeti (a.s.) dhe gjeta aty një grua me dy fëmijë, që i kishte të afërm. Atëherë e kuptova se nuk ishte mbret si Kisra (i Persisë) dhe Cezari (i Bizantit)" (Ahmed 19381). Thjeshtësia është virtyt i të gjithë Profetëve.

Muhamedi (a.s.) ulej me shokët e vet si të ishte njëri prej tyre dhe nuk merrte ndonjë qëndrim që të dallohej nga të tjerët. Aq sa të huajt që nuk e njihnin, kur futeshin në kuvendin e tij, nuk mund ta dallonin se kush ishte, prandaj pyesnin: "*Kush nga ju është Muhamedi?*" (El-Buhari, 63).

Shokët e tij tregojnë se punët e shumta që kishte nuk e pengonin atë të lëvizte për të plotësuar nevojat e njerëzve, sado të vogla të ishin ato. Kështu, ndodhte që të vinte dhe ta merrte për dore ndonjëra nga shërbëtoret e Medinës dhe ta çonte atje ku ajo kishte nevojë (El-Buhari 5724).

Një nga shokët më të mëdhenj të Muhamedit (a.s.), Omer Ibn Hattab tregon: "Një herë hyra te shtëpia e Profetit dhe pashë në trupin e tij gjurmët e një hasre (prej gjethesh palme) e fillova të qaj. Ai më pyeti: *"Përse qan?"* I thashë: *"O i Dërguari i Zotit, Kisra dhe Cezari jetojnë në gjithë atë komoditet. Po ti që je i Dërguari i Allahut?!"* Ai më tha: *"A nuk kënaqesh që ata kanë këtë jetë, ndërsa ne kemi jetën tjetër?"* (El-Buhari 3503)

Ai i rregullonte vetë sendet e tij personale, u shërbente familjarëve dhe i ndihmonte në punët e shtëpisë. Kur e kanë pyetur Aishen, bashkëshorten e tij, se çfarë bënte ai në shtëpi, ajo ka thënë: *"Ishte përherë në shërbim të familjes... Bënte si çdokush prej jush: ndreqte sandalet dhe arronte rrobat e tij."* (El-Buhari 644, Ahmed 24749)

Muhamedi ka thënë: *"Nuk hyn në Parajsë askush që ka në zemër qoftë edhe një grimë mendjemadhësie."* (Muslim 91)

Mëshira

Muhamedi ka thënë: "Të mëshirshmit i mëshiron i Gjithëmëshirshmi. Mëshironi ata që janë në Tokë, t'ju mëshirojë Ai që është në qiell." (Ebu Daud 4941)

Mëshira e Profetit (a.s.) manifestohet në shumë forma, si:

Mëshira e tij për fëmijët:

- Ndonëse falja e namazit përbën shtyllën e fesë e për pasojë gjatë saj nuk lejohen fjalët dhe lëvizjet e shumta, Profeti (a.s.) është falur një herë duke mbajtur në krahë mbesën e vogël, Umamën, vajzën e Zejnebit. Kur ulej me ballin në tokë, Profeti (a.s.) e vendoste në tokë Umamën dhe kur ngrihej, e merrte në krahë. (El-Buhari 494)
- Kur ishte duke u falur me të tjerët dhe dëgjonte ndonjë foshnjë që qante, Profeti (a.s.) e shpejtonte faljen. Për këtë ka thënë: "Unë ngrihem që të falem, duke dashur të falem gjatë; por pastaj dëgjoj ndonjë foshnjë që qan dhe e shpejtoj faljen, ngaqë nuk dua të rëndoj nënën e saj." (El-Buhari 675)

Mëshira e tij me gratë

- Profeti(a.s.) ka nxitur kujdesin dhe bamirësinë ndaj vajzave dhe ka thënë: *"Atij që ka një vajzë a më shumë dhe kujdeset ta edukojë e ta mbajë mirë, vajza do t'i bëhet mburojë ndaj flakëve (të Ferrit)."* (El-Buhari 5649)

- Madje ai ka lënë porosi të forta për të mbrojtur të drejtat e grave, për t'u kujdesur për punët dhe për kushtet e tyre, si dhe i ka urdhëruar muslimanët që t'ia përcjellin njëri-tjetrit këtë amanet: "*E keni amanet t'i mbani mirë gratë.*" (El-Buhari 4890)
- Muhamedi (a.s.) ka dhënë një nga shembujt më të mëdhenj të butësisë në këtë drejtim, duke vënë gjurin si stol që bashkëshortja e tij Safija (r.a) të vinte këmbën e të ngjitej mbi deve (El-Buhari 2120).
- Dhe kur i vinte për vizitë në shtëpi vajza e tij, Fatima, ai e merrte për dore, e puthte në ballë dhe e vendoste të ulej aty ku ishte ulur ai (Ebu Daud 5217).

Mëshira e tij për të pafuqishmit

- Profeti (a.s.) i nxiste njerëzit të kujdeseshin për jetimët dhe thoshte: "Unë dhe kujdestari i jetimit do të jemi në parajsë kështu." Dhe afronte gishtin tregues me gishtin e mesit, duke lënë pak hapësirë midis tyre. (El-Buhari 4998)
- Personin që kujdeset për vejushat dhe të vobektit Profeti (a.s.) e ka konsideruar si luftëtar në rrugë të Zotit ose si dikush që gjithë ditën agjëron e gjithë natën falet. (El-Buhari 5661)

- Dhembshurinë për të pafuqishmin dhe mbrojtjen e të drejtave të tij Profeti (a.s.) e ka konsideruar si shkak për shtimin e të mirave dhe të fitores ndaj armiqve. Kështu, ai ka thënë: *"Kërkoni të dobët sepse nëpërmjet (kujdesit e mbrojtjes ndaj) tyre ju vijjnë fitorja dhe të mirat."* (Ebu Daud 2594)



Profeti Muhamed e bëri përkujdesin ndaj të dobëtve dhe shprehjen e dashamirësisë ndaj tyre një arsye të fortë për arritjen e çdo fitoreje dhe shtimin e begative në jetë.



Drejtësia

- I Dërguari i Zotit (a.s.) ishte njeri i drejtë. Ai e zbatonte ligjin e Zotit edhe ndaj njerëzve më të afërt të tij, në përputhje me urdhrin kuranor: *"O besimtarë! Bëhuni zbatues të palëkundur të drejtësisë, duke dëshmuar në emër të Allahut, qoftë edhe kundër jush ose kundër prindërve dhe të afërmve tuaj."* (En-Nisa: 135)
- Një herë disa shokë vajtën tek Profeti si ndërmjetës për të mos u zbatuar dënimi për vjedhje ndaj një gruaje prej një familjeje fisnike. Profeti (a.s.) iu përgjigj: "Betohem për Atë që ka në dorë shpirtin e Muhamedit! Edhe sikur Fatima, bija e Muhamedit të vidhte, do ta zbatoja dënimin kundër saj." (El-Buhari 4053)
- Kur shpalli urdhrin për ndalimin e kamatës, Profeti (a.s.) e filloi nga njerëzit e tij më të afërm, me xhaxhanë e tij Abbasin. Dhe me këtë rast tha: *"Kamata e parë që anulohet është ajo e Abbas Ibn Abdulmutalibit. Ajo është e tëra e anuluar."* (Muslim, 1218)
- Profeti (a.s.) vuri si parametërtë qytetërimin të një kombi që i pafuqishmi mes tyre ta marrë hakun e vet nga i forti, pa frikë e pa u dridhur. Kështu, ai ka thënë: "Mos u bekoftë ai komb, ku i dobëti nuk e merr të drejtën pa u dridhur!" (Ibn Maxhe 2426)



Bamirësia dhe bujaria

- Një herë, një burrë shkoi te Profeti (a.s.) dhe i kërkoi para. Profeti (a.s.) i tha: "Shko e bli ç'të duash dhe borxhin do të ta shlyej unë." Atëherë Omeri, shoku i tij i tha: "O i Dërguari i Allahut, Zoti nuk të ka ngarkuar më shumë se ç'ke mundësi." Profetit (a.s.) nuk i erdhi mirë, por burri i tha: "Shpenzo dhe mos ki frikë se Zoti i Fronit Hyjnor nuk do të ta pakësojë." Atëherë Profeti (a.s.) buzëqeshi dhe iu shfaq gëzimi në fytyrë (Ahadith Mukhtarah, 88).
- Një herë atij i dërguan rreth 80 mijë dërhëmë argjendi dhe ai i vuri mbi një hasër e i shpërndau të gjitha, duke mos kthyer duarbosh askënd që i kërkoi (El-Hakim, 5423).

Durimi dhe shpirtgjerësia e tij

- Në historinë e thirrjes së tij, transmetohet se Profeti (a.s.) shkoi në qytetin e Taifit (90 km larg Mekës), për t'i ftuar banorët e tij në Islam. Por ata e lënduan fizikisht dhe iu përgjigjën shumë keq dhe ai doli nga Taifi shumë i dëshpëruar. Gjatë kthimit në Mekë, ku e priste populli i vet, i cili gjithashtu e kishte përzënë dhe e kishte lënduar, Zoti i dërgoi Muhamedit (a.s.) një engjëll që e pyeti nëse dëshironte t'i shkatërronte banorët e Taifit. Por Profeti (a.s.) tha: "Jo. Përkundrazi, e lus Allahun që të nxjerrë prej tyre pasardhës të cilët do të adhurojnë vetëm Allahun, pa i shoqëruar Atij partnerë të tjerë." (El-Buhari 3059)
- Më madhështor është qëndrimi i tij ndaj popullit të Mekës, i cili e përzuri Muhamedin nga vendi i vet, e lëndoi me fjalë dhe me armë dhe planifikoi shumë herë ta asgjësonte atë dhe shokët e tij. Kur Zoti Fuqiplotë e bëri Muhamedin të ngadhënjente ndaj Mekës dhe banorëve të saj, ai u ngrit mes tyre dhe u tha: "Çfarë thoni se do të bëj me ju?" Ata iu përgjigjën: "Vetëm të mira. Ti je vëllai ynë fisnik, biri i vëllait tonë fisnik." Atëherë ai tha: "Do të them siç ka thënë vëllai im, Jusufi (Profeti Jusuf, i biri i Jakubit, i cili i fali vëllezërit e vet që e lënduan dhe e hodhën në pus): *"Sot s'ka qortim për ju; Allahu do t'ju falë. Ai është më i Mëshirshmi i mëshiruesve!"* (Jusuf: 92) Prandaj shkoni, se jeni të lirë." (El-Bejheki, 18275)



Përkorja (asketizmi) në këtë jetë:

- Profeti (a.s.) e zbatonte përherë fjalën e Fuqiptotit: *"Mos e hidh shikimin në të mirat kalimtare, që Ne ua kemi dhënë disave prej tyre, si stoli të jetës së kësaj bote, për t'i vënë ata në provë! Shpërblimi i Zotit tënd është më i mirë dhe më e qëndrueshëm."* (Ta' Ha': 131)
- Një herë hyri te shtëpia e Profetit (a.s.) shoku i tij Omer Ibn Hattabi (kalifi i dytë musliman) dhe pa në trupin e tij gjurmët e një hasre. Pastaj hodhi shikimin në shtëpinë e tij dhe nuk pa asgjë që ia vlente të shihej a të pëlqehej. Kështu që i tha Profetit (a.s.): "Lute Zotin që t'ua shtojë të mirat pasuesve të tu, sepse persëve e romakëve u janë dhënë mjaft të mira materiale, duke mos qenë adhurues të Allahut." Profeti (a.s.) tha: *"Akoma ke dyshime, o Ibn Hattab?! Ata janë njerëz që u janë shpejtuar të mirat e tyre veç në këtë jetë."* (El-Buhari 2336)



- Vazhdimisht thoshte: "*Lidhja ime me këtë jetë është si ajo e kalorësit me pemën, nën hijen e së cilës ai qëndron për pak kohë e pastaj largohet prej saj.*" (El-Tirmidhi 2377)
- Në shtëpinë e Profetit (a.s.) ndodhte që të kalonin një, dy ose tre muaj e të mos ndizej zjarr për gatim, por ushqeheshin me hurma arabie dhe ujë (El-Buhari 2428). Ndoshta mund ta kalonte ditën i uritur, duke mos pasur për të ngrënë diçka tjetër veç hurmave të këqija (2977). Asnjëherë nuk u ngop për tri ditë radhazi me bukë gruri derisa vdiq, për më së shumti ushqehet me bukë elbi (Muslim 2976).



I Dërguari i Islamit e përshkruan raportin e tij me këtë jetë si një udhëtar i cili ulet nën hijen e një peme dhe më pas largohet dhe e lë atë.



Besnikëria

- Besnikëria në përmbushjen e marrëveshjeve dhe zotimeve është një nga virtytet më fisnike. Aq më tepër rritet kjo pozitë kur dikush bën një të mirë pa pasur marrëveshje më parë midis palëve. Kjo ishte praktika e Profetit (a.s.), ai e kthente të mirën me një të mirë më të madhe edhe sikur të mos kishte marrëveshje a zotime paraprake, e jo më kur kishte një zotim në mes.
- Kur Herakliu, mbreti bizantin i krishterë, e pyeti kreun e fisit Kurejsh – asokohe jomusliman – rreth cilësive të Profetit, mes të tjerash i tha: *"A tradhton?" Ai iu përgjigj "jo" dhe Herakliu i tha: "Të tillë janë Profetët, nuk tradhtojnë."* (El-Buhari 7)
- Bashkëshortes së tij të parë, Hadixhes, ai i qëndroi në gradën më të lartë të besnikërisë edhe pas vdekjes së saj: ia ruajti pozitën, ia njihte rolin e saj të madh në jetën e tij, tregohej përherë i kujdesshëm t'i nderonte të afërmit dhe shoqet e saj.
- Aishja, gruaja tjetër e Profetit (a.s.), na rrëfen për besnikërinë e tij ndaj gruas së parë, Hadixhes, e cila kishte vdekur gjatë viteve të para të Profecisë dhe Aishja nuk e kishte njohur. Ajo thotë: "Profeti (a.s.) e përmendte shpesh atë. Kur therte ndonjë dele, e ndante në pjesë dhe një pjesë ua çonte shoqeve të saj.

- Ndonjëherë i thosha: 'Sikur nuk ka në botë grua tjetër, përveç Hadixhes?!' Ai më thoshte: 'Ajo ka qenë kështu e ashtu...' dhe m'i numëronte me radhë virtytet e saj." (El-Buhari 3607)
- Një herë, te Profeti (a.s.) shkoi një delegacion nga Negusi (mbreti i Abisinisë, i cili kishte ofruar strehim për muslimanët, kur ata përndiqeshin në fillimet e Islamit). Profeti (a.s.) u çua dhe u shërbeu vetë. Shokët i thanë të ulej se shërbenin ata, por Profeti (a.s.) ua ktheu: "*Këta njerëz kanë mirëpritur shokët e mi, prandaj dhe unë dua t'ua kthej njëlloj.*" (Shuabul-iman, 8704)

Profeti Muhamed (a.s.) ka dhënë shembujt më të mrekullueshëm të virtyteve të larta morale në të gjitha fushat e jetës, duke zbatuar kështu urdhrin e Zotit, si të gjithë Profetët e tjerë të nderuar para tij.

Xhamia e Profetit Muhammed, është ajo të cilën ai e ndërtoi në Medine apo Medinen e Ndritur, ashtu siç e quajnë myslimanët qytetin e dytë të shenjtë e me rëndësi pas Mekës. Medina është qyteti ku Profeti Muhamed emigroi dhe ndërtoi në të xhaminë e tij. Atje i ndërroi jetë dhe u varros. Këtë xhami e vizitojnë miliona muslimanë çdo vit.



Nga thëniet e Profetit (a.s.)



Muslimanët

Muslimanët janë kujdesur përherë të përcjellin gojarisht dhe me shkrim fjalët e Profetit (a.s.). Dijetarët dhe memorizuesit e këtyre thënieve kanë bërë përpjekje të jashtëzakonshme në garë me njëri-tjetrin për të verifikuar dhe saktësuar çdo fjalë të Profetit. Dhe kështu i kanë ofruar botës një sistem mahnitës për verifikimin e lajmeve dhe për përcaktimin e shkallës së besueshmërisë së tyre. Madje kanë verifikuar në detajet më të vogla edhe fjalët brenda një fjalie, duke përcaktuar se çfarë është autentike dhe çfarë është shtuar.

Ja disa nga thëniet e Profetit Muhamed (a.s.):

- *"Në të vërtetë, veprat shpërblehen vetëm sipas qëllimit dhe secilit i takon vetëm ajo që ka vendosur."* (El-Buhari, 1)
- *"Virtyti është morali i mirë, ndërsa mëkati është ai që ta turbullon shpirtin dhe nuk do që ta dinë të tjerët."* (Muslim, 2553)
- *"Ruaju Allahut kudo që të jesh. Veprën e keqe pasoje me vepër të mirë që ta fshijë atë dhe sillu mirë me njerëzit."* (El-Tirmidhi, 1987)
- *"Mos lakmo në këtë botë, që të të dojë Allahu dhe mos lakmo atë që është në duart e njerëzve, që të të duan ata."* (Ibn Maxhe, 4102)
- *"Rasti im në krahasim me Profetët e mëparshëm është si shembulli i një njeriu që ka ndërtuar një shtëpi, të cilën e ka plotësuar dhe e ka përsosur, përveç një vendi ku mungon një tullë. Atëherë njerëzit që hyjnë në të, kënaqen nga bukuria e saj, por thonë: Sikur ta kishte edhe një tullë ky vend (shtëpia do të ishte e mrekullueshme)! Unë jam ajo tullë; unë jam i fundmi i Profetëve."* (El-Buhari, 3342)



“

*«Nuk do të hyni në Parajsë, derisa të besoni dhe, nuk do të besoni derisa ta doni njëri-tjetrin. A t'ju tregoj diçka që nëse e veproni do ta doni njëri-tjetrin? Përhapni selamin (përshëndetjen islame) mes jush.»
(Muslimi, 54)*

- "Kush i largon besimtarit një prej brengave të kësaj bote, Allahu do t'i largojë atij brenga nga ato të Ditës së Gjykimit. Kush e lehtëson dikë që është në vështirësi, Allahu do t'ia lehtësojë atij (vështirësitë) në këtë botë dhe në tjetrën. Kush ia mbulon të metat muslimanit, Allahu do t'ia mbulojë të metat në këtë botë dhe në tjetrën. Allahu e ndihmon robin e Vet, për sa kohë ky e ndihmon vëllanë e tij. Kush ndjek rrugën për të kërkuar dituri, Allahu do t'i lehtësojë atij rrugën për në Parajsë... Atë që e lënë pas veprat e veta, nuk mund ta gradojë prejardhja e tij." (Muslim, 2699)
- "Askush nga ju nuk beson, derisa të dëshirojë për vëllanë e vet atë që dëshiron për veten e tij." (El-Buhari, 13)
- "Musliman është ai që nuk u sjell dëm muslimanëve as me gjuhën e as me dorën e tij dhe i shpërngulur (për hir të Allahut) është ai që braktis gjithçka që ka ndaluar Allahu." (El-Buhari, 10)
- "Në Ditën e Gjykimit unë do të kërkoj që të vihet para përgjegjësisë kushdo që i ka bën padrejtësi jomuslimanit, apo e ngarkon atë përtej mundësive apo i merr diçka pa dëshirën e tij." (Ebu Davudi, 3052).
- "Mëshiruesit i mëshiron i Gjithëmëshirshmi. Mëshironi ata që janë në Tokë, t'ju mëshirojë Ai që është në qiell." (Ebu Daud, 4941)



«Nuk është prej nesh ai që nuk mëshiron të vegjëlit tanë dhe nuk respekton të drejtat e të mëdhenjve mes nesh.» (El-Tirmidhi, 1920)

- *"Kush mashtron, nuk është prej nesh." (El-Tirmidhi, 1315)*
- *"Besimtarët në dashurinë, mëshirën dhe solidaritetin që kanë mes tyre janë si trupi: kur lëndohet një organ i tij, i tërë trupi rënkon nga pagjumësia dhe temperatura." (Muslim, 2586)*



- "Secili prej jush është bari dhe secili është përgjegjës. Udhëheqësi është bari dhe mban përgjegjësi (për popullin e vet);. Burri është bari për familjen e tij dhe mban përgjegjësi për të. Edhe gruaja është bareshë në shtëpinë e burrit të saj dhe është përgjegjëse. Secili prej jush është bari dhe secili është përgjegjës." (El-Buhari 4892)
- "Besimtarët me besim më të plotë janë ata me moralin më të mire; më të mirët mes jush janë ata që sillen më mirë me gratë e tyre." (El-Tirmidhi, 1162)
- "Më të mirët mes jush janë ata që tregohen më të mirë me familjet e tyre; dhe unë jam më i miri ndër ju për familjen time." (El-Tirmidhi, 3895)
- "Vërtet, Allahu e pëlqen butësinë në çdo gjë." (El-Buhari, 5678)
- "Ai që privohet nga butësia, është privuar nga një mirësi e madhe." (Muslim, 2592)
- "Tri janë shenjat e hipokritit: kur flet, gënjen; kur premtun, nuk e mban fjalën; kur i besohet diçka, tradhton." (El-Buhari, 33)

- "Një cilësi e besimtarit të mirë është të mos merret me çka nuk i përket dhe nuk i intereson." (El-Tirmidhi, 2317)
- Profeti Muhamed (a.s.) rrëfen: "Ndërsa po udhëtonte, një njeri ndjeu etje, kështu që zbriti në një pus dhe piu ujë prej tij. Kur doli, ai pa një qen që po gulçonte e po hante baltë nga etja dhe tha me vete: "Ky qen po vuan nga ajo që vuajta edhe unë." Kështu që zbriti në pus, mbushi këpucën me ujë e pastaj u ngjiti lart e i dha ujë qenit. Për këtë vepër Allahu u tregua mirënjohës ndaj tij, duke e falur." Njerëzit e pyetën: "O i Dërguari i Allahut! A kemi vërtet shpërblim për shërbimin ndaj kafshëve?" Ai u përgjigj: "Po, për çdo shërbim ndaj çdo gjallese ka shpërblim." (El-Buhari, 2466)



Si e ka përshkruar Kurani Profetin Muhamed (a.s.)?

Kurani pasqyron një aspekt të mrekullueshëm të personalitetit të Profetit (a.s.) me ata që e rrethojnë, ku shfaqen morali, virtytet dhe humanizmi i tij njëherësh:

- Ai është mëshirë për mbarë njerëzimin (El-Enbija: 107) dhe jo vetëm për muslimanët.
- Zotëron virtyte morale madhore (El-Kalem:5).

- Është shumë i përkushtuar për orientimin e drejtë të njerëzve; trishtohet thellë për humbjen e tyre, aq sa shpesh Zoti e këshillon që detyra e tij është vetëm thirrja dhe përcjellja e mesazhit hyjnor, ndërsa Zoti ia dhuron kujt të dojë udhëzimin (Hud: 107; El-En'am: 12; El-Kehf: 127).
- Vazhdimisht mundohet t'u gjejë shfajësim të tjerëve dhe nuk ua vë re gabimet atyre (Et-Teube: 43).
- I lutet Allahut t'i falë armiqtë e tij, gjë që iu ndalua më vonë (Et-Teube: 80).
- I vjen rëndë kur rëndohen besimtarët dhe është i dhimbsur e i mëshirshëm me ta (Et-Teube: 128).
- Ndonjëherë lëndohet nga qëndrimi i gjatë i njerëzve në shtëpinë e tij, por turpi e ndalon t'ua bëjë të ditur (El-Ahzab: 53).
- Është i thjeshtë, tolerant, zemërbutë; sillet butësisht me shokët e vet, u kërkon këshilla dhe merr mendimin e tyre edhe në situatat më të vështira e më të rrezikshme (Al Imran: 159).

Kurani i madhërishëm – mrekullia e përjetshme e Islamit

Çfarë

Çfarë është Kurani, i cili shpesh kryeson listën e librave më të shitur e më të shpërndarë në botë? Tek i cili besojnë më shumë se miliardë e gjysmë muslimanë?

Kurani është libri i shenjtë i muslimanëve, të cilët besojnë se:

- Ai është Fjala e Allahut që i është shpallur Muhamedit (a.s.), për të drejtuar dhe për të ndriçuar njerëzimin.
- Ai është libri i fundit qiellor që ka zbritur.
- Ai është i mbrojtur nga çdo ndryshim dhe shtrembërim.
- Këndimi dhe mësimi i tij përmendësh janë rituale adhurimi, sikurse konsiderohet adhurim zbatimi i rregullave dhe ligjeve të tij.

Shpallja e Kuranit ka filluar nëpërmjet engjëllit Gabriel (Xhebrail a.s.), pasi Profeti (a.s.) kishte mbushur 40 vjeç. Vargu i parë që u shpall nga Kurani ishte: "Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka)". Kurani është shpallur gradualisht për 23 vite më radhë, sipas situatave dhe ngjarjeve të ndryshme.



Vargu i parë i shpallur prej Kuranit është: (lexo me emrin e Zotit tënd i cili krijoi). Kurani zbriti pjesë pjesë për gjatë 23 vjetëve, sipas situatave dhe ngjarjeve të ndryshme.



Kurani ndahet në 114 kapituj, që quhen sure. Tematikat dhe stilet e këtyre sureve janë të larmishme, por të gjithë pajtohen në mendimin se ato janë në shkallën më të lartë të elokuencës dhe retorikës së arabishtes. Boshti i tyre është drejtimi i njerëzve dhe thirrja e tyre për të adhuruar vetëm një Zot, Allahun Fuqiptotë.


Tematikat më të rëndësishme që trajton Kurani:

1. Pohimi i njëshmërisë së Zotit dhe rrëzimi i çdo dyshimi të paganëve.
2. Tregimi i historive të Profetëve dhe të popujve të mëparshëm.
3. Thirrja për të soditur gjithësinë e paanë dhe krijesat përreth nesh dhe për të numëruar mirësitë që na ka falur i Plotfuqishmi.
4. Sqarimi i rregullave dhe i ligjeve të fesë.
5. Sqarimi i cilësive dhe i virtyeteve të besimtarëve dhe qortimi i cilësive negative.
6. Përshkrimi i Ditës së Fundit dhe i shpërblimit që do të kenë mirëbërësit dhe i keqbërësit.



7. Edukimi i besimtarëve nëpërmjet komentimit të situatave dhe të ngjarjeve reale që i kanë ndodhur Profetit (a.s.) dhe shokëve të tij.

Disa nga veçoritë dhe karakteristikat e Kuranit





Mrekullia në ruajtjen e tij

Allahu e ka quajtur librin e Tij të fundit Kuran (lexim, këndim), për të treguar se ai është një libër i lexuar dhe i ruajtur përmendësh në zemra. Në shumë vargje Kurani është quajtur El-Kitab – Libri, për të treguar se ai është i shkruar dhe i ruajtur në rreshta. Pra, Kurani është ruajtur përmes kohëve nëpërmjet këtyre dy rrugëve. Sa herë që Profetit (a.s.) i shpalleshin pasazhe nga Kurani, njerëzit përreth tij i shkruanin menjëherë vargjet dhe i mësonin përmendësh nga goja e tij. Prandaj nuk pranohet asnjë version i memorizuar (qoftë edhe prej shumë njerëzve) që nuk përputhet me versionin e shkruar, ashtu sikurse nuk pranohet asnjë version i shkruar që nuk përputhej me versionin e memorizuar nga goja e Profetit (a.s.).




Nga anatjetër, teologët e krishterë i pranojnë si të natyrshme e të pritshme mospërputhjet midis versioneve të ndryshme të Ungjillit, për disa shkaqe siç janë: shumësia e burimeve që kanë përdorur shkruarit e ungjijve, ndryshimi i kohës së shkrimit të tyre, natyra jo e drejtpërdrejtë e frymëzimit hyjnor që përmbajnë ungjijtë etj. Megjithatë, ata mjaftohen me idenë se, sipas tyre, të gjithë këta ungjij përmbajnë orientimin e drejtë për njerëzimin.

Mirëpo e vërteta të cilën nuk mund ta mohojë asnjë njeri objektiv është se Kurani është tërësisht i pastër nga çdo lloj kontradikte a mospërputhjeje. Arsyeja është se të gjitha fjalët dhe kuptimet e tij janë nga Zoti dhe janë memorizuar e janë shkruar duke u marrë drejtpërdrejt nga goja e Profetit Muhamed (a.s.), të cilit iu shpallën. Vetë Profeti (a.s.) as nuk i ka shtuar, as nuk i ka hequr gjë Kuranit dhe muslimanët, pavarësisht ndryshueshmërisë së rrymave e shkollave të tyre, pajtohen plotësisht për çdo fjalë të tij (Kuranit).

Ruajtja e Kuranit dhe transmetimi i tij brez pas brezi përgjatë historisë ka arritur nivelin më të lartë të korrektësisë, perfeksionit dhe saktësisë, për sa përket shkrimit, mënyrave të artikullimit dhe përcjelljes, memorizimit dhe hedhjes së tij në letër. Atij nuk i mungon asnjë shkronjë dhe nuk i është shtuar asnjë zanore.

Çdo njeri ka mundësi që të blejë sot ndonjë kopje të Kuranit në vendet më të largëta: në Kinë apo në mes të Afrikës, për ta krahasuar me dorëshkrimet kuranore që u shkruan 1000 vjet më parë dhe që janë ruajtur në muzetë anembanë botës, në mënyrë që të zbulojë të vërtetën mahnitëse se mënyra e artikulimit të shkronjave dhe fjalëve të tij dhe rregullat e leximit të tij janë po ato, nuk kanë ndryshuar as pak, pavarësisht ndryshimit të kohës dhe diversitetit të gjuhëve, sidoqoftë e dëgjon atë nga një fëmijë që e lexon sot atë që ka mësuar përmendësh në Indonezi apo e ka lexuar një dijetar musliman që ua mësonte njerëzve Kuranin në Mekë para 1000 vitesh. Zoti në Kuran thotë: *"Sikur ai të mos ishte prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie."* (En-Nisa: 82)

Nuk është çudi, sepse Zoti e ka marrë përsipër ruajtjen e tij. Ai ka thënë: *"Sigurisht, Ne e kemi shpallur Kuranin dhe, sigurisht, Ne do ta ruajmë atë."* (El-Hixhr: 9)



Mrekullia në elokuencë dhe në analizën psikologjike

Kushdo që e lexon Kuranin me vëmendje, vëren se ky libër ballafaqohet me lexuesin e tij në mënyrë të drejtpërdrejtë e personale dhe nuk resht së diskutuari e së përballuri me të.

Më e habitshëm se ky është fakti që Kurani u paraprin ideve të lexuesit dhe i orienton ato, sikur ato të jenë lexuar në mendjen e tij para se t'i shprehë.

Një piktor mund ta pikturojë syrin që të duket sikur po ndjek shikimin e suditësit të tablosë, ngado që ai të shkojë. Por si mundet një shkrimtar që t'i ndjekë mendimet e lexuesve të tij, t'i parashikojë ato e madje t'u përgjigjet edhe pyetjeve që nuk janë shtruar ende, pavarësisht larmisë së lexuesve, të kulturave dhe të kushteve të tyre jetësore?!

Kurani zotëron një stil mahnitës në diagnostikimin e prirjeve të njeriut, në zbulimin e sekreteve të tij dhe në evidentimin e dobësive të tij. Kjo mund t'i duket pak e ashpër lexuesit në çastin e parë, sepse e zgjon atë për t'i bërë mendjes dhe zemrës ato pyetje, përgjigjen e të cilave e ka vonuar apo mundohet ta shmangë.



Kur lexon Kuranin, njihesh me historitë dhe përshkrimin që u bën kategorive të ndryshme njerëzish, jeton me sekretet e mendimit të tyre, psikologjinë dhe pikëpamjet e tyre, me humbjen e disave prej tyre dhe shpëtimin e të tjerëve. Pastaj ndalon pak me veten për t'i rikthyer llogaritë. Gjatë leximit, pasazhet kuranore, figurat dhe modelet njerëzore përsëriten me një ritëm që dalëngadalë hyn në zemër, derisa e shndërron Kuranin në pasqyrë, ku vetvetja shfaqet ashtu siç është, me të metat dhe mangësitë e saj, me potencialin dhe mundësitë e saj. Në këtë mënyrë Kurani depërton thellë në shpirtin e lexuesit, derisa ta bëjë atë që të bindet e të pranojë se nuk ka zot tjetër që meriton të adhurohet, përveç Allahut.

Prandaj, kur njeriun e shqetëson humbja e shpresës dhe dëshpërimi, lexon në Kuran: *"Thuaju robërve të Mi, që i kanë bërë keq vetes me gjynahe, të mos e humbin shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti."* (Kuran, 39: 53)



Njeriu i hutuar dhe i përvuajtur nga një konflikt i dhunshëm shpirtëror, duke kërkuar qetësi dhe strehim te Zoti, patjetër do ta gjejë butësinë dhe mirësinë në fjalën e Tij: *"Kurrobërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thua ju se) Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, le t'i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë."* (El-Bekare: 186)

Kur ai mendon se ka humbur toruan në jetë dhe se nuk është në gjendje ta përballojë atë apo e ka të vështirë të kontrollojë rrjedhën e saj, sigurisht që do ta gjejë melhemin për zemrën dhe fuqinë e mjaftueshme për të përballuar vështirësitë e jetës në Fjalën e Zotit në Kuran: *"Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka: në dobi të tij është e mira që bën, kurse në dëm të tij është e keqja që punon. Zoti ynë, mos na ndëshko për atë që harrojmë ose veprojmë pa qëllim! Zoti ynë, mos na ngarko barrë të rëndë, ashtu si i ngarkove ata para nesh! Zoti ynë, mos na ngarko me diçka që nuk mund ta bartim! Na i shlyej gjynahet tona, na i fal ato dhe na mëshiro! Ti je Zoti Ynë! Prandaj na jep fitore kundër atyre që nuk besojnë!"* (El-Bekare: 283)

Njëri prej historianëve më të rëndësishëm të civilizimit e pranon ndikimin e Kuranit dhe pozitën e tij të lartë tek të gjithë njerëzit e drejtë dhe objektivë



“Story of Civilization” “Historia e Civilizimit” (13/68-69)

“Për trembëdhjetë shekuj Kurani ka mbushur kujtesën, ka ngjallur imagjinatën, ka formuar karakterin dhe ndoshta u ka ftohur logjikën qindra milionë njerëzve. Shpirtrave të thjeshtë ai u dha besimin më të thjeshtë, me më pak mistikë dhe me më pak rituale nga të gjitha besimet e tjera, një besim të lirë nga idhujtaria dhe klerikalizmi. Mesazhi i tij u ngriti moralin dhe nivelin kulturor pasuesve të tij, promovoi rendin dhe unitetin shoqëror, nguliti higjenën dhe pakësoi besëtytnitë e mizorinë, përmirësoi gjendjen e skllëvërve, u dha të përlururve dinjitet e krenari dhe prodhoi në mesin e muslimanëve një shkallë vetëpërmbytjeje (ndaj gjynaheve) të paarritshme diku tjetër në botën e njeriut të bardhë. Ai i bëri njerëzit të pranojnë me durim vështirësitë dhe kufizimet e jetës dhe, në të njëjtën kohë, i nxiti ata që të realizonin ekspansionin më të habitshëm në histori.



Ai i dha fesë një përcaktim të atillë, që çdo i krishterë apo hebre ortodoks mund ta pranojë: *"Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është (kjo): kushdo që beson Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt, Librin dhe profetët; kushdo që jep nga pasuria e vet, ndonëse e do shumë atë, për të afërmit, jetimët, të varfrit, udhëtarët e mbetur rrugës, lypësit dhe për lirim të robëruarve; kushdo që fal namazin dhe e jep zekatin; ata që i plotësojnë premtimet, kur marrin përsipër diçka; ata që durojnë në kohë skamjeje, sëmundjeje dhe lufte. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe këta janë të devotshmit."* (El-Bekare: 177)



Thotë Will Durant:

«Në këtë Kuran kanë besuar shumë burra të shkencës dhe mendimit të lirë me gjithë ndryshimet mes tyre në drejtim të nivelit të diturive dhe të aftësive intelektuale. Ata besuan për shkakun e vetëm se përmes këtij Kurani u erdhi një doktrinë e vërtetë dhe shumë e qartë që pranohet nga të gjithë. ... Ai solli një nga besimet më të thjeshta, dhe me më pak paqartësi.



Nga ka ardhur **Kurani?**

Pyetje

Pyetje që vijnë vetvetiu në mendje kur flitet për librin e shenjtë të muslimanëve, Kuranin dhe Muhamedin (paqja qoftë me të!): Përse duhet ta pranojmë pikëpamjen e muslimanëve për këtë çështje? A nuk kemi të drejtë të bëjmë pyetje rreth tij (Kuranit)?



Historianët pohojnë njëzëri se Kurani ka ardhur nga goja e një burri arab, që quhej Muhamed bin Abdullah, i cili kishte lindur në Mekë në shekullin VI dhe nuk dinte shkrim e këndim. Kjo është një dëshmi historike e pashembullt dhe e përcjellë kështu brez pas brezi. Po kështu, në Kuran lexojmë qartë se ai nuk është krijim i përcjellësit të tij, por është Fjala Sublime e shpallur nga Zoti; ndërsa detyra e Muhamedit ka qenë vetëm transmetimi i Kuranit dhe shpjegimi i saj për njerëzit, pa shtuar dhe pa hequr gjë në të.

Pra, a mund të thuhet se Muhamedi, Profeti i Islamit, e ka shpikur vetë Kuranin apo e ka mësuar përmbajtjen e tij nga një burim tjetër dhe më pas e ka shprehur me fjalët e veta, duke ua prezantuar njerëzve si fjalë të Zotit?



Nëse i Dërguari i Islamit do të donte të mashtronte e të zgjeronte ndikimin e tij tek njerëzit me faktin se ai flet me fjalët e vetë Zotit, përse nuk pretendoi se të gjitha fjalët e tij ishin nga Zoti?!

Këto janë pyetje të ligjshme që të vijnë menjëherë në mendje, nëse nuk e ke lexuar dhe nuk e ke studiuar Kuranin apo nëse nuk e ke njohur jetëshkrimin e Muhamedit dhe historitë e tij.

Ajo që dimë dhe që e kanë vërtetuar studimet historike është se shumë shkrimtarë e mendimtarë i kanë uzurpuar veprat e të tjerëve, i kanë vjedhur dhe ia kanë atribuuar vetes. Atëherë përse ndonjëri prej tyre duhet t'ua atribuonte të tjerëve produktin e mendjes së vet?!



Kjo ngre pyetjen tjetër: Sikur ai të dëshironte të mashtronte për të zgjeruar ndikimin e tij mbi njerëzit duke përdorur emrin e Zotit, pse nuk pretendoi se të gjitha fjalët e tij janë prej Zotit?!

A është logjike që Muhamedi ta ketë sajuar këtë libër dhe t'ia ketë atribuar Zotit për të forcuar pushtetin, pozitën dhe reputacionin e vet dhe në të njëjtën kohë libri të përmbajë shumë pasazhe që e qortojnë Muhamedin drejtpërdrejt, e këshillojnë dhe i ndreqin gabimet e tij?!

Kurani, siç e dinë të gjithë ata që e kanë lexuar nuk ka përjashtuar nga kritika as jetën publike, as jetën private të Muhamedit; e ka qortuar atë në çështjet familjare, ashtu siç e ka kritikuar në disa nga vendimet e tij drejtuese, madje edhe mënyrën e predikimit.

Kështu, p.sh.: një burrë i verbër prej shokëve të Muhamedit (a.s.) shkoi një herë tek ai, kur ky i fundit ishte i zënë duke i predikuar njërit prej udhëheqësve të Mekës, me shpresën për ta bindur që të pranonte Islamin. I verbri nuk e dinte se Muhamedi ishte i zënë dhe e thirri disa herë: "O Muhamed, më mëso diçka nga ajo që të ka mësuar Allahu!" Atëherë Muhamedi u vrenjt dhe deshi që i verbri të pushonte, derisa të mbaronte punën që kishte nisur. Mirëpo më pas Muhamedi (a.s.) u largua prej të verbrit dhe nuk i ktheu përgjigje. Kurani e fiksoi këtë moment në histori dhe e përshkroi me detaje mënyrën si ai u vrenjt para të verbërit dhe e la pa përgjigje.

Dhe Kurani nuk u ndal me kaq, por përshkrimin e pasoi me një kritikë për Profetin (a.s.) dhe me një udhëzim të qartë e të prerë për të mos e përsëritur më një veprim të tillë. Kësaj ngjarjeje i kushtoi një sure, pra një kapitull të plotë, të cilin e quajti me një emër që e vërteton atë: "*Abese - Ai u vrenjt*" (Abese: 1-11) Pas këtij qortimi sa herë që Profeti (a.s.) vizitohej nga i verbri, i thoshte: "Mirë se erdhe o ti, për të cilin më ka kritikuar Zoti", dhe i shtronte përpara pelerinën e vet.

Në Kuran na rrëfihen mjaft histori në të cilat i Dërguari i Zotit orientohet dhe qortohet ndonjëherë në mënyrë të atillë që ndokush prej nesh do t'i vinte zor që t'i thuheshin fjalë të tilla si ato në publik. A mundet ndonjëri të publikojë gabimet e tij dhe t'i regjistrojë ato në faqet e historisë në këtë mënyrë, nëse do të dëshironte nderim dhe prestigj për veten e tij?!

Për më tepër, historia shënon shumë situata të vështira, kur Profeti (a.s.) ka pasur nevojë t'i zbriste Shpallja Hyjnore, për të vërtetuar sinqeritetin dhe pozitën e tij ose pafajësinë e vet dhe të familjes së tij, e megjithatë Shpallja nuk i vinte...

I tillë është rasti kur armiqtë nga populli i tij, kërkuar ndihmën e disa dijetarëve joarabë nga fetë e mëparshme, në luftën ideologjike kundër Muhamedit.



Kurani na ka sjellë shumë nga historitë ku Ai qorton dhe i terheq vërejtjen të Dërguarit të Tij, me qortime e vërejtje të tilla që askujt prej nesh nuk do t'i pëlqente ti thuheshin në publik dhe ta dinin të tjerët.

Dijetarët i këshilluan që t'i bënin Muhamedit tre pyetje; nëse ai do t'u përgjigjej saktë pyetjeve, atëherë ishte Profet, në të kundërt nuk do të ishte Profet. Ata e pyetën dhe Muhamedin (a.s.) u tha në formë sfiduese se do t'u përgjigjej të nesërmen.

Mirëpo Shpallja Hyjnore u ndërpre dhe Muhamedit nuk po i vinte përgjigje prej disa ditësh. Atëherë armiqtë shkonin dhe talleshin me të, ngaqë nuk u përgjigjej dot. Muhamedin e pushtoi një trishtim i thellë për shkak të situatës së krijuar. Shpallja Hyjnore i zbriti vetëm pas 15 ditësh, me përgjigjet përkatëse dhe me këshillën për të mos u shprehur kurrë me siguri se ç'do të bëjë të nesërmen, pa e kushtëzuar me thënien "Inshallah - Dashtë Allahu!", duke shpjeguar kështu se kjo vonesë ishte një mësim nga Allahu (El-Kehf: 24).



Akuza të përsëritura

Është e habitshme, por historia e jetës së Muhamedit (a.s.) mund të konsiderohet një nga argumentet më të fuqishme të sinqeritetit të tij.

Ai ishte një njeri i cili nuk dinte shkrim e këndim; jetonte mes një populli analfabet, ndante me ta jetën shoqërore dhe merrte pjesë në tubimet e tyre, ku nuk kishte imoralitet; ishte i zënë për të siguruar jetesën e vet dhe të familjes së vet, duke punuar si bari dhensh e më pas si agjent tregtar; ndërkaq nuk kishte kontakte me dijetarë. Pra, si mundet një njeri që e ka kaluar në mënyrë të tillë pjesën më të madhe të jetës së tij 40-vjeçare, befas t'u



kthehet njerëzve të tij dhe t'u flasë me një gjuhë që nuk e kishin dëgjuar asnjëherë, t'u tregojë gjëra që nuk i njihnin etërit e tyre, si, p.sh.: historitë e popujve të lashtë, historinë e fillimit të krijimit, histori të detajuara nga Profetët e mëparshëm, norma dhe ligje të përpikta që përfshijnë të gjitha aspektet e jetës etj.?!)

Këto fakte shkaktuan tronditje të njëpasnjëshme te armiqtë e Muhamedit. Prandaj ishin konfuzë në akuzat e tyre ndaj Kuranit dhe nuk dinin se çfarë të propagandonin më shumë për t'i larguar njerëzit nga ai.

Ishte i vështirë të besohej pretendimi se Kurani ishte trillim i Muhamedit; kushdo që e lexonte Kuranin me vëmendje e kuptonte këtë. Edhe pretendimi që ta kishte mësuar nga një tjetër, ishte i vështirë, sepse ata kishin jetuar me të dhe i dinin hollësitë e jetës së tij. E megjithatë, një herë e akuzonin për diçka e herën tjetër i bënin një akuzë të kundërt. Kështu, një herë i thoshin se Kuranin ia kishte mësuar dikush tjetër dhe herën tjetër i thoshin se e kishte trilluar vetë; një herë i thoshin se ai tregonte ëndrrat e veta, ndërsa herën tjetër e akuzonin për magjistar, poet ose ndoshta e quanin të çmendur!



Është e njëjta histori, por me emra të ndryshëm. A nuk u akuzua Profeti Moisi - Musa (a.s.) si magjistar? A nuk u akuzua Profeti Jezu - Isa (a.s.) si i çmendur?

Kështu është vepruar me të gjithë Profetët e mëparshëm (paqja e Zotit qoftë me ta!). Kur armiqtë e tyre nuk dinin me çfarë t'i akuzonin më, i quanin magjistarë ose të çmendur. E tillë është gjendja e dëshmitarit të rremë, kur e ndien vështirësinë e pozitës së vet: i mbarohen argumentet dhe fillon të drejtojë akuza në çdo anë. Akuzon për çdo mangësi se mos ndoshta gjen terren se ku të qëndrojë, por nuk ia del dot.

Përse nuk e konsiderojmë gjeni?

Të gjithë e pranojnë se Zoti mund t'i falë mendjes njerëzore talent dhe aftësi krijuese të paimagjinueshme, megjithëse është e natyrshme që edhe mendja të ketë kufijtë e saj. Kështu, logjika dëshmon se Zoti Krijues e Fuqiplotë ekziston dhe se drejtësia e Tij e bën të domosdoshme jetën e pëртеjme, me qëllim që gjithkush të marrë shpërblimin a dënimin e vet; por mendja njerëzore nuk është në gjendje të vërtetojë detaje dhe hollësi të tjera, për të cilat nuk ka argumente a dëshmi.



Kështu ka ndodhur me të gjithë profetët e mëparshëm, - paqja qoftë mbi ta! -. Kur armiqtë e tyre nuk i gjenin në Profetët cilësitë për të cilat i akuzonin, atëherë si versionin më të pranueshëm e të llogjikshëm, gjenin që të thoshin se janë magjistarë ose të çmendur.

Lexuesi i Kuranit vëren se ai i shpjegon me detaje kufijtë e besimit; e përshkruan me hollësi mënyrën si ka filluar krijimi e si është plotësuar; e përshkruan Parajsën dhe kënaqësitë e saj, ashtu sikurse përshkruan Ferrin, vuajtjet e tij, numrin e portave të tij, numrin e engjëjve që kujdesen për të; sikurse trajton me kompetencë çështje të imëta rreth natyrës së universit, njeriut etj. Mbi ç'teori logjike janë ndërtuar të gjitha këto detaje?

Këto nuk vijnë nga zgjuarsia dhe gjenialiteti; përkundrazi, ose janë fantazi të rreme, ose janë të vërteta që nuk mund përftohen ndryshe, përveçse me anë të të mësuarit.

Shkenca moderne tashmë ka vërtetuar disa prej fakteve të përmendura në Kuran, ndërkohë që nuk ka hedhur poshtë asgjë prej të dhënave të tij. Dhe për sa u përket përshkrimeve metafizike, në këtë pikë Kurani përputhet me librat e tjerë të mëparshëm qiellorë.




Ndoshta Kurani është përmbledhje e riformuluar nga libra të tjerë

Le të ndalemi pak e të pyesim: A ka ndonjë mundësi, qoftë edhe fare të vogël, që informacioni i Kuranit të jetë marrë nga librat e Profetëve të mëparshëm?

Në këtë kontekst janë një seri faktesh që nuk mund të anashkalohen:

- Muhamedi (a.s.) nuk dinte shkrim e këndim;
- shumica e popullit të tij ishin analfabetë dhe nuk kishin asnjë lloj njohurie fetare;
- Muhamedi (a.s.) nuk ka pasur shoqëri me asnjë dijetar të feve të mëparshme, përveç një takimi të shkurtër me një murg, gjatë një udhëtimi në fëmijërinë e tij, kur ishte në praninë e të afërmeve;




- faktet historike tregojnë se në atë kohë dijetarët e shkrimeve të shenjta e kishin monopolizuar diturinë dhe nuk e përhapnin atë, për të ruajtur pozitën e tyre, kështu që kjo dije nuk gjendej lehtësisht.

Por edhe nëse i anashkalojmë këto fakte, e vërteta që shfaqet para syve të çdo studiuesi të Kuranit është se informacioni i Kuranit nuk përputhet plotësisht me informacionet e librave të tjerë qiellorë. Madje, Kurani saktëson disa nga të dhënat e gabuara që gjenden në ato libra, plotëson mangësitë e disa tregimeve, zbulon informacione që dijetarët e atyre librave i mbanin të fshehura, sqaron devijimet doktrinare dhe morale që disa “dijetarë” ia kishin veshur fesë së Profetëve (paqja qoftë me ta!), por që nuk kishin lidhje me të. Dhe Kurani është i mbushur me shembuj të tillë. E si mund të ketë qenë Muhamedi (a.s.) nxënës i këtyre “dijetarëve” dhe të ketë marrë informacion nga ata?!

Fakt historik dallues

Një studiues objektiv nuk mund të mos ndalet gjatë për të medituuar rreth një fakti: Lajmëtari i Islamit, Muhamedi (a.s.) ishte arab.

A nuk na tregon historia se populli arab në atë kohë nuk kishte ndonjë art me të cilin mburrej, përveç elokuencës dhe retorikës? Produkti i tij nuk kishte gjë tjetër vetëm se poezi, që i publikonin në forume, në tubime dhe ceremoni të ndryshme festive, në të cilat fisi lartësohej ose rrëzohej, edhe me një poezi të vetme!



Librat e historisë dhe të letërsisë tregojnë se çdo arab që nxirrte një poezi a një prozë, pasohej nga kritika që synonin t'ia plotësonin veprën apo t'ia ndreqnin gabimet, ose pasohej nga një vepër e ngjashme si kundërpërgjigje. Ky ishte thelbi i garës së tyre letrare, që nxirrte në pah aftësitë dhe talentin e tyre.

Atëherë si mundet që armiku i tyre më i rreptë, kundër të cilit nuk kursejnë asgjë, as ashpërsinë e as të sharat, të vijë e t'i sfidojë në mjeshtërinë e tyre, duke u kërkuar që të bëjnë diçka të ngjashme me Kuranin apo edhe me një pasazh të tij?! Dhe më pas ata të mos i përgjigjen kësaj sfide, përveçse me heshtje apo zbrapsje nga skena?!

A nuk frikësohej Muhamedi (a.s.) se mos kjo sfidë do të zgjonte sedrën e tyre për të vënë në punë një nga aftësitë e tyre më të veçanta dhe, njëherazi pikën e tyre më të fortë?! A nuk kishte frikë se mos ata të gjithë së bashku apo veç e veç do të angazhoheshin në konkurrencë kundër tij, për t'i vërtetuar botës se fjalët e tij ishin të kota?!

Le të supozojmë se Muhamedi (a.s.) guxoi ta bënte këtë sfidë, sepse e dinte se njerëzit e vet nuk i kishin aftësitë e duhura. Por, si është e mundur që ai fliste me siguri se as brezat e ardhshëm nuk do të jenë në gjendje të bëjnë diçka të ngjashme me Kuranin apo me ndonjë pasazh të tij, edhe sikur të mblidhen të gjithë bashkë?!

Kjo do të ishte një aventurë që nuk do ta bënte askush, përveç një njeriu zemra e të cilit është e mbushur me siguri dhe bindje për gjithçka që lajmëron. Kështu ndodhi. As kurejshët, as gojëtarët më të mëdhenj të tyre nuk guxuan të shkruanin fjalë që t'i ngjanin Kuranit, as ndonjë pasazhi të tij. Kjo e vërtetë ka mbetur e tillë nga ajo kohë dhe deri më sot. Kush është përpjekur apo ka dëshiruar të shkruajë diçka të ngjashme me Kuranin gjatë historisë, ka dështuar në mënyrë skandaloze, duke u bërë objekt talljeje dhe përçmimi nga populli i tij.



Surja El-Fatiha

Ajo është surja më madhështore e Kur'anit dhe muslimani e përsërit gjithmonë në namazin e tij. Disa nga kuptimet e saj shkurtimisht janë si vijon:



Kuptimet e shpjegimi i sures El - Fatiha



Me emrin e Allahut, të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit.

E filloj (leximin e Kur'ân-it) me përmendjen dhe kujtimin e Allahut, për të treguar edukatën me Allahun e Madhëruar dhe madhërimin për të. Ai është i përshkruar me mëshirën e pakufishme që ka përfshirë çdo gjë.

Të gjitha lavdërimet i takojnë vetëm Allahut, Zotit të botëve,

E përlëvdoj dhe e lavdëroj Allahun e Lartësuar, për shkak të cilësive absolute dhe veprave të Tij të mrekullueshme, dhe për të gjitha mirësitë e Tij të shfaqura dhe ato të fshehta që na ka dhuruar, duke iu dedikuar Atij me dashuri dhe madhërim. Ai është Krijuesi, Sunduesi i gjithësisë. Ai kujdeset për të gjitha krijesat dhe në dorën e Tij janë të gjitha mirësitë.



Të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit,

Ai është i përshkruar e cilësuar me të gjitha kuptimet e mëshirës dhe llojet e saj. Ai është i përshkruar me mëshirën e përgjithshme e cila ka përfshirë gjithçka në këtë gjithësi. Ai është i përshkruar edhe me mëshirën e posaçme e të veçantë për adhuruesit e Tij besimdrejtë.

Sunduesit të Ditës së Gjykimit.

Ai është sunduesi në dorën e të Cilit është pushteti e Gjykimi në ditën e llogarisë dhe shpërblimit me drejtësi.

Vetëm ty të adhurojmë dhe vetëm tek Ti ndihmë kërkojmë.

Vetëm Ty ti dedikojmë, o Zoti ynë, të gjitha adhurimet tona. Ne nuk të shoqërojmë asgjë në adhurimet për Ty. Vetëm ty të drejtohem për ndihmë dhe të mbështetemi për të gjitha çështjet tona. Çdo gjë është në dorën Tënde dhe askush nuk posedon gjë, as sa një thërmijë.

Na udhëzo në rrugën e drejtë"

Na i trego, na drejto dhe na i bëj mbarë që të ndjekim rrugën e drejtë dhe na bëj të palëkundur në të!

"Në rrugën e atyre të cilët i begatove me mirësi"

Pra, në rrugën e atyre që i begatove duke i udhëzuar dhe bërë të paluahtshëm në rrugën e drejtë. Në rrugën e profetëve dhe punëmirëve të cilët e njohën të vërtetën dhe e pasuan atë.

"Jo në rrugën e atyre që merituan zemërimin"

Na shpëto dhe na mbaj larg nga rruga e atyre që merituan zemërimin Tënd. Ata e merituan të jenë të urrejtur dhe ti mbulojë zemërimi sepse ata e njohën të vërtetën dhe nuk e pasuan atë. Na ruaj o Zot edhe nga rruga e atyre që nuk e ndoqën të vërtetën për shkak se nuk e njohën atë dhe as nuk kërkuan që ta njohin.

Amin

O Allah! Përgjigju lutjes sonë!





Secili ka fjalën e vet të fundit

Pas gjithë këtij arsyetimi, fjala e fundit i mbetet lexuesit për të gjykuar rreth Kuranit. Qëndrimi i tij varet nga përvoja personale në leximin, studimin dhe përsiatjen e Kuranit, duke pasur kujdes që të zgjedhim përkthimin e përshtatshëm, nëse nuk është arab.

Kurani ka treguar se një nga argumentet më të mëdha për vërtetësinë e Profecisë së Muhamedit (a.s.) janë rezultatet që arrijmë me zemrën dhe mendjen tonë pas leximit të vëmendshëm dhe përsiatjes së kuptimeve kuranore: *"Vallë, a nuk u mjafton atyre që Ne të kemi shpallur ty Librin që u lexohet atyre? Me të vërtetë që në të ka mëshirë dhe këshillë për njerëzit që besojnë."* (El-Ankebut: 51)

Dhe ua ka drejtuar të gjithëve ftesën për të leximin dhe përsiatjen e Kuranit, duke theksuar se këtë gjë nuk e bëjnë ata që i kanë vënë dry zemrës dhe mendjes së tyre. (Muhamed: 24)





**Ritet e adhurimit
në Islam dhe
thelbi i tyre**

A ka

A ka nevojë Zoti për adhurimin tonë?

Zoti i Lartësuar nuk ka nevojë për adhurimin dhe veprat tona. Shpëtimi në Islam nuk arrihet thjesht nëpërmjet ritualeve formale dhe honorareve financiare. Përkundrazi, shpëtimi varet nga shkalla e sinqeritetit kushtuar Zotit dhe i besimit tek Ai. Besimi duhet përkthyer në realitet nëpërmjet lartësimit shpirtëror, sjelljes së mirë, punës së palodhur në shërbim të shoqërisë njerëzore dhe përpjekjeve për zhvillimin e saj.



A ka nevojë Zoti për adhurimin tonë?

Zoti i Lartësuar nuk ka nevojë për adhurimin dhe veprat tona. Shpëtimi në Islam nuk arrihet thjesht nëpërmjet ritualeve formale dhe honorareve financiare. Përkundrazi, shpëtimi varet nga shkalla e sinqeritetit kushtuar Zotit dhe i besimit tek Ai.

Besimi duhet përkthyer në realitet nëpërmjet lartësimit shpirtëror, sjelljes së mirë, punës së palodhur në shërbim të shoqërisë njerëzore dhe përpjekjeve për zhvillimin e saj.

Zoti në Kuran thotë: *"Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë. Unë nuk kërkoj prej tyre furnizim, as nuk dëshiroj që të Më ushqejnë. Vërtet, Allahu është Furnizuesi i vetëm, i Fuqishmi, i Plotpushtetshmi."* (Edh-Dharijat: 56-58)

Kur disa njerëz iu duk si problem dhe në lidhje me të pyetën se cili është drejtimi i saktë që duhet të drejtohen gjatë namazit - sepse Islami i mëson njerëzit që të drejtohen kah Mekës gjatë namazit -, atyre iu konfirmua se realiteti i fesë është në sinqeritetin e besimit, në orientimin e drejtë dhe te veprat e mira në dobi të njerëzimit, nuk është thjesht në drejtimin nga lindja apo perëndimi. Zoti i Lartësuar tha: *"Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt, Librin dhe Profetët; e atij që me vullnet jep nga pasuria e vet për të afërmit, jetimët, të varfrit, udhëtarët e mbetur rrugës, lypësit dhe për lirin*

e të robëruarve; e atij që fal namazin dhe e jep zeqatin; dhe e atyre që i plotësojnë premtimet, kur marrin përsipër diçka; e atyre që durojnë në kohë skamjeje, sëmundjeje dhe lufte. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe këta janë ata që e kanë frikë Allahun.” (El-Bekare: 177)

Në një verset tjetër Kurani na konfrmon se kush përpiqet në adhurim dhe përkushtim ndaj fesë, i bën dobi vetes dhe e shpëton atë; ndërsa kush mohon, le ta dijë se ai është i vetmi humbës, sigurisht që Zoti nuk ka nevojë për ne, sikurse Zoti thotë në Kuran: *“Kush përpiqet, përpiqet vetëm për të mirën e vetvetes, se Allahu, në të vërtetë nuk ka nevojë për asgjë.”* (El-Ankebut: 6)



“

Kur disa njerëz pyesnin se cili ishte drejtimi i duhur për faljen e namazit, atyre iu bë e qartë se feja e vërtetë synon të sendërtojë tek njeriu besimin e çiltër dhe të sinqertë, orientimin drejt veprave të mira dhe të qenurit të dobishëm për njerëzimin, e jo thjesht drejtimin drejt lindjes apo perëndimit.

Shtyllat e Islamit

Ato janë adhurimet më të rëndësishme që ka urdhëruar Islami, si më poshtë:

1



Besimi dhe pohimi i sinqertë me fjalë e me vepra se adhurimi i takon vetëm Allahut dhe ndjekja e rrugës së lajmëtarit të Tij, Profetit Muhamed (a.s.). Këto përmbliidhen në dëshminë se askush nuk meriton të adhurohet përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut. (Shih faqen 55)

2



Kryerja e pesë faljeve të detyrueshme.
(Shih faqen 182)

3



Ndarja e detyrimit financiar të zekatit,
për ata që e meritojnë. (Shih faqen 190)

4

Agjërimi i muajit të Ramazanit. (Shih faqen 196)

5



Pelegrinazhi në Shtëpinë e Shenjtë, Qabenë, për atë që ka mundësi fizike dhe financiare. (Shih faqen 200)



Cilat janë arsyet e ngarkimit me përgjegjësi dhe të sprovave?

Një pyetje sillet vazhdimisht në mendje, pavarësisht se në forma të ndryshme, por thelbi është ky: Si ka mundësi që Zoti të na ketë krijuar me gojë, dhëmbë e stomak dhe pastaj na kërkon që të agjërojmë?! Na ka krijuar me bukuri dhe epshe, e pastaj na kërkon që të ulim shikimin dhe të vetëpërmbahemi?! Një tjetër mund të pyesë se si ka mundësi që Allahu na ka dhuruar fuqi dhe na ndalon t'i sulmojmë të tjerët?!

Realisht në perceptimin islam kjo çështje është krejt e qartë. Zoti na dhuroi këto aftësi që të ushtrojmë kontroll mbi shqisat dhe organet tona dhe jo ato të na kontrollojnë neve. Zoti ta dhuron “kalin” që t’i hipësh dhe ta drejtosh atë, jo të të hipë dhe të të drejtojë ai ty. Trupi dhe fuqia janë “kali” ynë, janë krijuar për ne, që ne t’u hipim, t’i drejtojmë dhe t’i frenojmë; t’i përdorim në kohën dhe vendin e duhur dhe në mënyrën e saktë, dhe jo të ndodhë e kundërta.

Prandaj, vlera e njeriut dhe superioriteti i tij shfaqet në aftësinë e tij për të kontrolluar epshin, për të udhëhequr pasionet e dëshirat dhe për t’i orientuar këto fuqi në atë që është e dobishme... Në këtë mënyrë Zoti e dalloi njeriun dhe i përgatiti atij arenën e testimi... Ky është qëllimi për të cilin na krijoi Zoti.

Sikurse i Lartësuari thotë në Kuran: “Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun nga një pikë farë e përzier, për ta sprovuar dhe e bëmë që të dëgjojë dhe të shohë. Natyrisht që Ne i treguam atij rrugën e drejtë, që ai të jetë ose mirënjohës, ose mosmirënjohës.” (El-Insan: 2-3)

Çdo gjë që pëson njeriu prej fatkeqësive dhe vuajtjeve është një lloj testimi shtesë për të zhvilluar gjendjen tonë shpirtërore dhe morale, për forcimin e besimit dhe për të sjellë në vëmendje qëllimin tonë në këtë jetë, sikurse thotë Zoti në Kuran: "Sigurisht që Ne do t'ju provojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lashtave! Prandaj, përgëzoji të duruarit, të cilët, kur i godet ndonjë fatkeqësi thonë: *"Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!"*" (El-Bekare: 155,156)

Kështu pra, jeta e kësaj bote është një mundësi që të avancojmë dhe të orientojemi drejt përsosmërisë së besimit dhe të moralit. Zoti i Lartësuar, edhe pse na jep raste të përsëritura për t'u udhëzuar dhe për t'u korrigjuar, gjithsesi Ai nuk na imponon të ecim në rrugën e drejtë. Përkundrazi, e ka lënë të hapur për ne portën që ne vetë, me vullnetin tonë të lirë, të zgjedhim; ndërkohë na orientojmë që ta përmirojmë jetën në Tokë, që t'i bëjmë dobi njerëzimit dhe të përfitojmë nga gabimet dhe përpjekjet tona, për t'u kthyer të penduar tek Ai sa herë që shfaqet gabimi dhe lajthitja jonë. I Dërguari fisnik, Muhamedi (a.s.) ka thënë: *"Nëse ju do të mëkatonit, Zoti do t'ju largonte dhe në vendin tuaj do të sillte njerëz që mëkatojnë dhe i kërkojnë falje Atij, pastaj Zoti i fal ata."* (Muslim, 2749)

“

Statusi i njeriut dhe epërsia e tij qëndron në aftësinë e tij për të kontrolluar epshin, për të udhëhequr pasionin dhe veten, dhe për t'i udhëhequr forcat që posedon në veten e tij në përmbushjen e asaj që i sjell dobi e mirësi.





Namazi (rituali i faljes)

Ndoshta ke menduar ndonjëherë të mësosh të vërtetën kur ke parë skena të habitshme drejtpërdrejt apo nëpërmjet mjeteve të informacionit, si p.sh.: kur një musliman apo shumë të tillë drejtohen në një drejtim të caktuar, qëndrojnë në këmbë, përulen dhe e vendosin ballin mbi tokë, sikur t'i kenë ndërprerë lidhjet me botën përreth tyre...

Çfarë është namazi i muslimanëve?

Namazi ka vlerë të madhe në Islam, sepse është mënyra më e rëndësishme për t'u afruar tek Zoti, për t'iu lutur dhe për t'iu nënshtruar Atij, sikurse i thotë Zoti të Dërguarit të Tij: *"Bëj sexhde dhe afroju Zotit tend!"* (El-Alak: 19) Prandaj namazi konsiderohet shtylla e dytë e Islamit pas artikulimit të Shehadetit (dëshmia që thotë njeriu kur hyn në Islam).

Profeti (a.s.) ka thënë: *"Islami është ngritur mbi pesë (shtylla): Dëshmia se askush nuk e meriton adhurimin, përveç Allahut; dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, falja e namazit ..."* (El-Buhari, 8)

Muslimani shpërblehet për namazin e tij - siç na mëson Islami - në varësi të përpjekjeve që bën për pastrimin e zemrës, duke u përqëndruar në namaz, duke iu përgjëruar Zotit me singëritet dhe duke e ndjerë prezencën e Tij. Kjo i jep shpirtit prehje dhe qetësi. Për këtë arsye namazi ishte kënaqësia më e madhe për të Dërguarin e Zotit, Muhamedin (a.s.).

Prandaj, Kurani na mëson që ta kryejmë namazin me përpikmëri, jo thjeshtë bëjmë disa veprime mekanike. Ta kryesh realisht namazin me përpikmëri do të thotë që në namaz të marrin pjesë të gjitha gjymtyrët, bashkë me mendjen, zemrën dhe shpirtin. Nëse veprojmë kështu, namazi do të jetë më i miri shtytës për të kryer vepra të mira dhe për t'u larguar nga krimet dhe mëkatet shkatërruese.

Përmendja e Zotit dhe përkushtimi ndaj Tij është gjëja më e mirë që mund të bëjë njeriu në jetën e tij. Për këtë arsye është urdhëruar kryerja e namazit.

Zoti i Lartësuar thotë: *"Lexo (o Muhamed) atë që të është zbritur ty prej Librit (Kuranit) dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar dhe vërtet që përmendja e Allahut është më e madhe! Allahu di gjithçka që ju bëni."* (El-Ankebut: 45)

Gabohet ai që mendon se namazi është thjesht gjimnastikë, e cili paraprihet nga larja dhe pastrimi. Duke parë vetëm anën e jashtme: lëvizjet në namaz, ai nuk arrin të kuptojë realitetin e këtij adhurimi. Në fakt, të gjitha fjalët dhe aktet e namazit i kushtohen madhërimit të Zotit.



Falja e namazit ishte kënaqësia më e madhe e Profetit Muhamed ﷺ.

"Allahu Ekber" - Zoti është më i Madhi, është e para fjalë që artikulon njeriu kur fillon të falet; pastaj përulet para Zotit me frikërespekt duke ndjerë madhështinë e Tij dhe duke pranuar paaftësinë e vet dhe në këtë pozicion thotë: "I Dëlirë është Zoti im Madhështor!"; pastaj vendos ballin në tokë duke kërkuar afërsinë



me Zotin dhe përgjigje për lutjet drejtuar Atij dhe në këtë pozicion thotë: "I Dëlirë është Zoti im i Lartë!" Në këtë mënyrë i kërkon dhe i lutet Zotit të tij me përgjërim...

Kështu të gjitha aktet dhe fjalët e namazit nuk janë thjesht lëvizje dhe murmuritje, por janë momente shumë të pasura, që e lidhin besimtarin me Krijuesin e tij, i Cili i ka dhuruar jetën dhe i siguron lumturinë.

Zoti uakabër të detyrueshme muslimanëve të falen pesë herë në një ditë-natë. Namazi mund të falet në çdo vend, e megjithatë Islami nxit faljen në xhami, që të thellohen e të forcohen lidhjet mes besimtarëve dhe që ta ndihmojnë njëri-tjetrin për çështjet e fesë dhe të kësaj jete.

Gjithashtu Islami nxit kryerjen e veprave vullnetare, sa herë që muslimani e sheh veten aktiv.

Kur luten në namaz muslimanët drejtohen kah Qabes. Qabeja është një ndërtesë në formë kubike. I pari që ndërtoi atë ishte Abrahami (Ibrahimi a.s.), i cilësuar si "Babai i Profetëve". Qabeja ndodhet në Mekë, në perëndim të Gadishullit Arabik. Gjithë Profetët (paqja e Zotit qoftë më ta!) e kanë kryer pelegrinazhin në këtë vend të shenjtë. Muslimanët e dinë se ajo është ndërtuar nga gurë që nuk shkaktojnë dem dhe nuk sjellin dobi, mirëpo Zoti urdhëron që të drejtohen kah saj gjatë namazit, me qëllim që muslimanët të bashkohen duke e kryer ritin e faljes në të njëjtin drejtim.



Ezani

Thirrja që i lajmëron njerëzit për hyrjen e kohës së namazit dhe që i fton të vijnë në xhami, quhet ezan.



Vetë ezani është një formë e përmendjes dhe e madhërimit të Zotit, një përgatitje e muslimanëve për të marrë pjesë në namaz. Fjalët e ezanit janë:

- 1- *All-llahu ekber-ull-llahu ekber, All-llahu ekber-ull-llahu ekber* (Allahu është më i Madhi).
- 2- *Eshhedu el-la ilahe il-lAll-llah, Eshhedu el-la ilahe il-lAll-llah* (Dëshmoj se askush nuk meriton të adhurohet, përveç Allahut).
- 3- *Eshhedu enne Muhammeden resulull-llah, Eshhedu enne Muhammeden resulull-llah* (Dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut).
- 4- *Hajje 'ales-sala, Hajje 'ales-sala* (Ejani në namaz).
- 5- *Hajje 'alel felah, Hajje 'alel felah* (Ejani në shpëtim).
- 6- *All-llahu ekber-ull-llahu ekber* (Allahu është më i Madhi).
- 7- *La ilahe il-lAll-llah* (Dëshmoj se askush nuk meriton të adhurohet, përveç Allahut).





Xhamia e shenjtë është faltorja më e rëndësishme e muslimanëve. Në të ndodhet Qabja, të cilën e ndërtoi Profeti Ibrahim. Ajo është një ndërtesë në formë kubike dhe të gjithë muslimanët janë urdhëruar që të kthehen në drejtim të saj kur falin namazin, edhe pse e dine mire se ajo është një ndërtesë që nuk ka asnjë force për të sjellë të mira apo për të të sjellë ndonjë dëm.



Zekati (Detyrimi financiar)

Të gjithë janë të bindur se problemi i polarizimit të shoqërisë duhet zgjidhur dhe se nga thellësia e hendekut ndërmjet të pasurve dhe të varfërve përcaktohet edhe shkalla e dëmtimit të shoqërisë nga veset, krimi dhe shpërbërja. Sistemet ekonomike, politike dhe ideologjike e kanë trajtuar gjërësisht zgjidhjen e këtij problem; secila me mënyrën e vet. Po çfarë zgjidhje ofron Islami për këtë problem?

Zoti ua ka bërë detyrim muslimanëve të pasur që çdo vit të nxjerrin 2.5 % të pasurisë që i tejkalon nevojat e tyre, për t'ua ndarë nevojtarëve të varfër etj. Kjo vepër konsiderohet si shtylla e tretë e Islamit.

Zekati nuk konsiderohet si një favor i të pasurit ndaj të varfrit, por një e drejtë e të varfrit që merret nga pasuria e të pasanikut dhe shkon te nevojtarit, pa pasur nevojë të lypë e të ulë dinjitetin e tij.

Kjo shumë e vogël është sasia e detyrueshme për muslimanët e pasur. Ndërsa kufiri i epërm për të shpenzuar në bamirësi është një fushë e hapur për njerëzit që të garojnë aty me njëri-tjetrin, për t'i gjetur efektet e këtij shpenzimi në jetën e këtushme me shëndet, pasuri, mbarësi e lumturi, si dhe në jetën e përtejme me shpërblime e kënaqësi të shumëfishta.

Kurani e ilustron me një shembull pasurinë e atyre që shpenzojnë për të fituar kënaqësinë e Zotit: është si shembulli i një kokrrë gruri nga e cila dalin shtatë kallinj, ku çdo kalli ka 100 kokrra. Shpërblimi arrin në 700 fish, mirëpo Allahu e shton atë në varësi të sinqeritetit dhe qëllimit të besimtarit që shpenzon në rrugën e Tij. Allahu është Mirëbërës i Madh dhe i Gjithëdijshtëm për realitetin e gjërave.

Allahu i Lartësuar ka thënë në Kuran: *"Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të Allahut, i shëmbëlajnë atij që mbjell një kokërr nga e cila dalin shtatë kallinj, ku secili kalli ka nga njëqind kokrra. Allahu ia shton (shpërblimin) edhe më tepër kujt të dëshirojë; Allahu është Mirëbërës i Madh dhe i Gjithëdijshtëm."* (El-Bekare: 261)

Kurani na tregon se shpenzimi i pasurisë për nevojtarët është pastrim për shpirtin dhe pastrim për pasurinë. Kështu, Zoti i drejtohet të Dërguarit të Tij: *"Merr nga pasuria e tyre lëmoshë me të cilën t'i pastrosh ata dhe t'ua rrisësh veprat e mira."* (Et-Teube: 103)

Ashtu siç na tregon edhe se koprracia në shpenzimin për bamirësi ndaj të varfërve dhe nevojtarëve, e bën koprracin humbësin e parë, sepse e ka privuar veten nga lumturia tokësore dhe nga ajo e amshuar.

Zoti i Lartësuar thotë në Kuran: *"Ja, juve ju bëhet thirrje të shpenzoni në rrugën e Allahut, por disa prej jush janë koprracë. Kush tregohet koprrac, ta dijë se i bën dëm vetes, sepse Allahu është i Pasur (s'ka nevojë për asgjë), ndërsa ju jeni të varfër. E, nëse ju ia ktheni shpinën dhe i largoheni Atij, Ai do t'ju zëvendësojë me një popull tjetër, i cili nuk do ta ndjekë shembullin tuaj."* (Muhamed: 38)

Duke aplikuar këtë shtyllë madhështore të Islamit bëhet realitet koncepti i sigurimit social dhe vendoset në lloj ekuilibri relativ ndërmjet kategorive të shoqërisë.

Kur zekati u jepet njerëzve në nevojë që e meritojnë, pasuria shpërndahet me drejtësi dhe nuk mbetet monopol në duart e një kategorie të caktuar njerëzish të shoqërisë.

Në historinë e hershme të muslimanëve kanë ndodhur mjaft herë që të pasurit kërkonin njerëz në nevojë për t'ua dhënë zekatin dhe ndihmën financiare, por nuk gjenin.


Kur të pasurit e japin zekatin e pasurisë së tyre, në mënyrë të natyrshme e forcojnë lidhjen dhe miqësinë me të varfërit, sepse njeriu, nga vetë natyra e tij, e do atë që i bën mirë. Në këtë mënyrë, anëtarët e shoqërisë islame bashkohen dhe e duan njëri-tjetrin; ata janë si një ndërtesë solide, pjesët e së cilës mbajnë fort njëra-tjetrën, ndërkah pakësohen incidentet e vjedhjes, plaçkitjes dhe grabitjes.



“

Dhënia e zekatit nuk është një favor që i pasuri i bën të varfrit, por është një e drejtë legjitime e të vërfrit në pasurinë e të pasurit. Prej zekatit e ka hak të përfitojë çdo nevojtar pa qenë e nevojshme që të kërkojë e të lypë, apo të përulet e të shkelë mbi dinitetin e vet.





Ata që e shpenzojnë pasurinë e tyre në rrugë të Allahut, Kur'ani i shëmbëllen me një farë, prej së cilës mbijnë shtatë kallinj, ku në secilin kalli ka njëqind kokrra. Pra ajo shumfishohet shtatëqind fish





Agjërimi

Të gjithë ne habitemi me ata që arrijnë ta kontrollojnë veten, duke mundur të privohen nga ushqimi apo nga lloje të caktuara të tij, për të ruajtur shëndetin, për të ulur peshën apo për të zbatuar këshillat e mjekut... Dhe këtë e konsiderojmë sukses dhe realizim të aftësisë për të kontrolluar epshet, që të arrijmë një qëllim më të madh e më të rëndësishëm.

Duke agjëruar muslimani vepron më shumë se kaq, në trajnimin e vetes së tij duke ushtruar kontroll mbi dëshirat e tij, në përputhje me urdhrat e më të Urtit të gjykuesve.

Agjërimi është shtylla e katërt e Islamit. Islami kërkon që një person të agjërojë dhe të heqë dorë nga ato që e prishin agjërimin, domethënë: ushqim, pije dhe mardhëniet intime me gruan nga agimi deri në përfundim të diellit, çdo ditë të Ramazanit, i cili është muaji i nëntë në kalendarin hënor islam.

Kurani na tregon se agjërimi ka qenë obligim edhe për popujt e mëparshëm. Ata kanë agjëruar në mënyra të ndryshme, por qëllimi gjithmonë është i njëjtë: nënshtrimi dhe bindja ndaj Zotit, arritja e devotshmërisë dhe e përkushtimit ndaj Tij.



Profeti i Islamit paralajmëron se kushdo që nuk e ndryshon gjendjen e tij dhe as e përmirëson moralin e tij pas agjërit, nuk ka përfituar gjë nga agjërimi.

Zoti i Lartësuar në Kuran thotë: "*O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat.*" (El-Bekare: 183)

Kur muslimani ngadhënjën ndaj epsheve të lejuara gjatë disa orëve për 30 ditë radhazi, arrin që kështu të bëhet i aftë për ta kontrolluar veten përgjatë gjithë jetës, që të mos bjerë në përdorim të ndaluar të epsheve.



Për këtë arsye Profeti (a.s.) tërheq vërejtjen se, në qoftë se sjelljet e besimtarit nuk përmirësohen pas agjërimit, atëherë ai nuk ka përfituar nga agjërimi i tij: *"Kush nuk e braktis gënjeshtrenë në fjalët dhe në veprat e tij, (ta dijë se) Allahu nuk ka nevojë që ai njeri të braktisë ushqimin dhe pijen."* (El-Buhari, 1804)

Uria dhe etja e agjëruesit janë shtysa më e madhe që ai t'i ndihmojë të varfërit e uritur që mezi gjejnë me ç'të ushqehen, sepse e ka provuar edhe vetë vuajtjen e urisë.



Kurani na tregon se agjërimi ka qenë obligim edhe për popujt e mëparshëm. Ata kanë agjëruar në mënyra të ndryshme, por qëllimi gjithmonë është i njëjtë: nënshtrimi dhe bindja ndaj Zotit, arritja e devotshmërisë dhe e përkushtimit ndaj Tij.



”

Kur Islami obligon një musliman që të agjërojë, në fakt i kujton atij urinë e të varfërve dhe nevojën e tyre për ushqim.



Haxhillëku (pelegrinazhi)

Shumica e feve e kanë pjesë të ritualit të tyre shtegtimin për qëllime fetare, ku njerëzit shfaqin adhurimin dhe lutjet e tyre për Krijuesin. Megjithatë shtegtimi vjetor më i famshëm e më i madh për nga numri i pjesëmarrësve është udhëtimi i haxhillëkut, pelegrinazhit islam. Për çdo vit mbi tre milionë njerëz mbledhen në një vend të vogël, për të kryer ritet këtij udhëtimi të shenjtë.

Çfarë është pelegrinazhi në Islam?

Pelegrinazhi islam, i quajtur ndryshe haxhillëk, është shtylla e pestë e Islamit dhe konsiderohet detyrim një herë të vetme në jetë, për ata që kanë mundësi financiare dhe fizike.

Haxhillëku është një udhëtim madhështor, ku zhduken dallimet në shtresa, raca, etni, veshje e pasuri. Të gjithë pjesëmarrësit veshin të njëjtën veshje, me të njëjtën ngjyrë dhe recitojnë të njëjtën thirrje, e cila mishëron thelbin e lidhjes mes njeriut dhe Zotit të tij: "Të përgjigjemi Ty, o Zot, të përgjigjemi. Të përgjigjemi Ty, që je i Pashoq, të përgjigjemi. Të gjitha lavdet dhe begatitë dhe pushteti janë vetëm për Ty, se Ti je i Pashoq." Pra, e kemi ndërmarrë këtë udhëtim si përgjigje ndaj urdhrit Tënd, o Zot; kemi ardhur dhe themi me plot gojë e me bindje në zemër se Ti je i Vetmi që meriton të adhurohesh dhe askush tjetër;

Ti je i Vetmi që i meriton të gjitha lavdet, sepse Ti je Krijuesi, Dhuruesi i begative dhe i Gjithëpushtetshmi; Ti nuk ke partnerë.

Haxhi është një udhëtim besimi, gjatë të cilit muslimani përjeton gjendje të ndryshme emocionale; përmes fjalëve dhe veprave të tij i synon përmendjen e Zotit duke treguar devotshmëri ndaj Tij, sikurse shfaq varfërinë dhe nevojën për Zotin e Lartësuar dhe kërkon faljen dhe shpërblimin e Tij. Muhamedi a.s. ka thënë: *"Tauafi (rrotullimi) përreth Shtepisë së Shenjtë dhe saji (ecejaket ndërmjet dy kodrave Safa dhe Merve) në haxh i kushtohen përkujtimit të Zotit."* (Ibën Ebi Shejbe, 15334)

Kur haxhiu heq robat e zakonshme dhe vesh (ihramin) ato dy copa të bardha për të kryer adhurimin e haxhit, në fakt ka shprehur me këtë përunjësinë e tij para Allahut dhe modestinë e barazinë me të gjithë ata që ashtu si ai janë drejtuar për kryerjen e haxhit.

Familja në Islam





Realisht

Realisht shumë familje të epokës sonë mund të përkufizohen në këtë mënyrë: grup individësh që kanë çelsa të shumtë të një shtëpie të vetme!

P

Për fat të keq shumë njerëz i shmangen përgjegjësisë së vërtetë karshi gruas dhe fëmijëve. Përse atëhere i shijojnë kënaqësitë, ndërkohë që nuk marrin përsipër përgjegjësitë? Vallë, çfarë i pengon ata nga përgjegjësia?

Vërtet ky trend u shfaq në mënyrë të qartë në këtë epokë, por i ka joshur disa njerëz që nga agimi i historisë. Faktikisht kemi të bëjmë me një tendencë naive për interesa të neveritshme individuale dhe egoiste, pavarësisht pasojave të dëmshme që i shkaktohen individit dhe shoqërisë.

Për këtë arsye, Islami pjesën më të madhe të vëmendjes së tij ia kushton familjes, sistemit të saj dhe të drejtave e detyrave që kanë anëtarët e saj ndaj njëri-tjetrit, sepse familja në Islam është qendra e ndërgjegjësimit, e edukimit dhe e progresit. Nëse rregullohet familja dhe e kryen ashtu siç duhet misionin e saj, atëhere rregullohet e gjithë shoqëria.

Ky kujdes shfaqet në serinë e pafundme të parimeve dhe normave islame për familjen, ndër të cilat përmendim:



Islami thekson dhe nxit martesën dhe krijimin e familjes:

- Islami e konsideron krijimin e familjes një nga veprat më madhështore dhe një traditë profetike. Kur disa shokë të Profetit (a.s.) deshën t'i përkushtoheshin vetëm adhurimit, vetëm të faleshin, të agjëronin e të mos martoreshin, Profeti (a.s.) u tha duke i këshilluar: “Ndryshe nga ju, unë agjëroj e ha, falem e fle dhe martohem. Prandaj kush nuk e pëlqen rrugën time, nuk është prej meje.” (El-Buhari, 4776)

- Kur Kurani flet për mirësitë dhe begatitë që Zoti i ka dhuruar njerëzve, ndër të parat, përmend dashurinë dhe mëshirën, prehjen dhe qetësinë që vendosi ndërmjet bashkërsshortëve, sikurse thotë në Kuran: *"Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkërsshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë."* (Er-Rum: 21)
- Urdhëroi për lehtësimin e martesës dhe premtoi ndihmë për cilindo që dëshiron të martohet, sikurse thotë i Dërguari (a.s.): *"Është e drejtë e Zotit të ndihmojë tre kategori njerëzish."* Ndër ta permendi: *"Atë që martohet për të ruajtur nderin."* (Tirmidhi 1655)
- Islami i urdhëron të rinjtë që, në kulmin e fuqisë dhe të rinisë së tyre, të martohen për të gjetur qetësi e prehje, si dhe një zgjidhje të ligjshme për të kënaqur dëshirat e tyre.



“

Kur Kurani flet për mirësitë dhe shenjat madhështore që u ka dhënë bijve të Ademit në krye të të gjitha mirësive përmend faktin se Ai krijoi e vendosi qetësi, dashuri, mëshirë dhe ngrohtësi mes burrit dhe gruas së tij.

2



Islami i ka dhënë çdo individ nga anëtarët e familjes respekt të plotë, qoftë ai mashkull apo femër:

Islami u ka dhënë prindërve një përgjegjësi të madhe në edukimin e fëmijëve të tyre. Profeti (a.s.) ka thënë: *"Secili prej jush është kujdestar dhe secili prej jush është përgjegjës për ata që ka nën kujdestari. Prijësi është kujdestar dhe përgjegjës (për nënshtetasit e tij); burri është kujdestar dhe përgjegjës për familjen e tij; gruaja është kujdestare në shtëpinë e burrit të saj dhe është përgjegjëse për ata që ka nën kujdestari; shërbëtori është kujdestar për për pasurinë e pronarit të tij."* (El-Buhari, 853)



3




Islaminxit përnderimin dhe respektin ndaj prindërve, përkujdesur e vazhdueshme ndaj tyre duke iu bindur atyre deri në vdekje.

Sado që të rritet djali apo vajza, respektin ndaj prindërve dhe sjelljen e mirë me ta e kanë detyrë. Zoti i Lartësuar e përmend respektimin e prindërve si detyra më e rëndësishme pas adhurimit të Tij.

I Lartmadhëruari e ndalon çdo lloj fjale apo veprë që tregon shenjë mosrespekti ndaj tyre, madje edhe duke e shfaqur këtë me ndonjë fjalë apo me zë që shpreh mërzitje ndaj tyre: *"Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuron askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre as "uh!", mos i kundërshto, por drejtoju atyre me fjalë respekti."* (El-Isra: 23)



4



Islami urdhëron mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe trajtimin e tyre me drejtësi në shpenzim:

Profeti (a.s.) ka thënë: "*Njeriut i mjafton si mëkat që t'i lërë pas dore ata që i ushqen.*" (Ebu Daud, 1692) Për sa u përket kujdesit dhe shpenzimit për vajzat në veçanti, Profeti (a.s.) ka thënë: "*Kush ka nën kujdestari vajza dhe i mban mirë, (ta dijë se) ato do të jenë mburoja e tij nga flakët (e Ferrit).*" (El-Buhari, 5649)



5



Islami i urdhëron muslimanët të mbajnë lidhjet e gjakut:

Kuptimi i saj është që njeriu të jetë në vazhdimësi bamirës me të afërmit e tij nga nëna dhe babai. Islami e konsideron këtë një nga veprat më të mira për t'u afruar me Zotin. Nga ana tjetër, Islami ndalon rreptësisht shkëputjen e lidhjeve me farefisnin dhe keqtrajtimin e tyre, duke i konsideruar këto mëkate të mëdha. Profeti (a.s.) ka thënë: "*Nuk hyn në Parajsë ai që prish lidhjet farefisnore.*" (Muslim, 2556)





“

Islami e ndaloi mundimin e prindërve përmes fjalëve dhe veprave të pamatura. Madje ndalon edhe nga fjalët ose shprehjet që tregojnë pakënaqësi ndaj tyre.

Pozita e gruas në Islam





Një

Një vështrim i shpejtë në reklamat televizive apo ato të afishuara rrugës ose në kopertina revistash, na bëjnë ta kuptojmë krimin e madh që i ka bërë kultura materialiste gruas, e cila në shumicën e rasteve shihet vetëm si një kukull apo mall që ndez dëshirat, epshet dhe fantazinë.



N

Ndoshta kjo është vetëm njëra anë (më pak e shpërfytyruar në dukje nga gjendja e gruas në shoqëritë primitive) e poshtërimit të gruas dhe kthimit të saj në mall kënaqësie që shitet e blihet.

Gruaja, e cila ka vuajtur nga padrejtësia dhe shtypja, ka arritur që me luftën e saj të gjatë të dalë nga kjo pozitë e vështirë, por për të rënë në njëjtin vend, ndonëse në një formë më pak të shëmtuar.

Që prej ardhjes së Islamit 1400 vjet më parë, ndodhi një revolucion i vërtetë kundër sjelljeve mizore ndaj gruas. U vendosën ligje dhe norma për hollësitë më të imëta, me qëllimin për të mbrojtur të drejtat dhe pozitat e gruas, që ajo të jetojë me dinjitet dhe ta kryejë misionin e saj në jetë në formën më të plotë.

Prandaj dhe një nga kapitujt më të gjatë të Kuranit u titullua "Gratë", sepse përmban norma të detajuara për gruan. Zoti ka treguar në Kuran historinë e shumë grave të devotshme dhe njërin prej kapitujve kuranorë e ka titulluar me emrin e një gruaje, Merjemit (Maries), nënës së Isait - Jezuit (s.a.)

Islami erdhi dhe ndërroi këndvështrimin për gruan, që ajo të jetë vetvetja, siç e ka krijuar i Madhi Zot; të jetë njeri dhe jo mall, të jetë shoqe jete dhe jo shoqe e një nate, të jetë dashuri, prehje dhe mëshirë e jo epsh dhe kënaqësi kalimtare.



Disa norma në lidhje me respektimin e gruas:

- Gruas i është dhënë liria e zgjedhjes së bashkëshortit dhe i është dhënë një pjesë e madhe e përgjegjësisë për edukimin e fëmijëve. Profeti (a.s.) ka thënë: "...gruaja është kujdestare në shtëpinë e burrit të saj dhe është përgjegjëse për ata që ka nën kujdestari..." (El-Buhari, 853)
- Gruas i është lënë e drejta që të ruajë mbiemrin e saj dhe nderin e përkatësisë atësore. Prandaj ajo nuk e ndryshon pas martesës përkatësinë atësore dhe familjare.
- Islami ka vënë barazi midis burrit dhe gruas në shumë çështje të ndryshme, siç janë të gjitha llojet e marrëdhënieve financiare. Aq sa Profeti (a.s.) ka thënë: "*Gratë janë partneret e burrave.*" (Ebu Daud, 236)
- Islami e ka bërë detyrim për burrin që të kujdeset e të shpenzojë për mbajtjen e gruas, pa e quajtur si favor ndaj saj, qoftë ajo bashkëshorte, nënë ose vajzë.
- Islami i ka dhënë gruas të drejtën për të pasur pjesë në trashëgimi, sipas një ndarjeje të drejtë dhe dinjitoze, ku gruaja barazohet me burrin në disa raste, e në



raste të tjera merr më shumë ose më pak se ai, në varësi të afërsisë së gjakut dhe të kostove të detyrueshme që duhet të paguajë secili. Është dritëshkurtësi ajo që bëjnë disa, të cilët përqëndrohen vetëm në rastet kur pjesa e burrit nga trashëgimia është më e madhe se pjesa e gruas, duke mos marrë parasysh detyrimin që ka burri për të mbuluar shpenzimet financiare të të gjithë familjes, duke përfshirë edhe ato të gruas. Islami është një sistem i përsosur dhe i ekuilibruar, ku asnjëri krah nuk e dominon tjetrin.

- Islami thekson pozitën e lartë dhe fisnike që ka shërbimi ndaj grave pa mbështetje, qofshin ato edhe jashtë rrethit të të afërmve. Ai nxit përpjekjet për të kryer një shërbim të tillë, duke e konsideruar këtë si një nga veprat më të mira para Zotit. Profeti (a.s.) ka thënë: *"Ai që kujdeset për gratë e veja dhe të varfërit, është njëlloj si dikush që lufton në rrugë të Zotit, ose si dikush që falet pa ndërprerje ose si ai që agjëron pa ndërprerje."* (El-Buhari, 5661)



Në një kohë kur disa shkrues e akuzojnë Islamin se e shtyp gruan, i nëpërkëmb të drejtat e saj dhe se, sipas tyre, nuk përputhet me kërkesat e kohës e të qytetërimit modern, shohim se 75% e atyre që e pranojnë Islamin rishtas në shtetet e zhvilluara si Britania janë gra. Kjo ndodh veçanërisht pasi kanë studiuar legjislacionin islam për familjen. (The Independent, 6-11-2011)



Gra për të cilat Islami thekson kujdesin ndaj tyre:



Nëna: Dikush erdhi tek i Profeti (a.s.) dhe i tha: 'O i Dërguari i Allahut, cili është njeriu që e meriton më shumë kujdesin tim?' Profeti (a.s.) i tha: 'Nëna jote.' "Kush vjen më pas?" –pyeti ai. "Nëna jote" – i tha Profeti (a.s.). "Po më pas, kush?" –pyeti ai. "Nëna jote" – i tha Profeti (a.s.). "Po pastaj, kush?" – tha sërish ai. "Pastaj (vjen) babai yt" - iu përgjigj Profeti (a.s.) (El-Buhari 5626)



Vajza: Profeti (a.s.) ka thënë: "Kush ka tri vajza dhe është i durueshëm me to, u siguron ushqimin, pijen dhe veshmbathjet nga mundi i tij, (ta dijë se) ato do t'i bëhen atij mburojë nga Zjarri në Ditën e Gjykimit." (Ibn Maxhe, 3669)



Bashkëshortja: Profeti (a.s.) ka thënë: "Më i miri ndër ju është ai që tregohet më i mirë me familjen e vet; dhe unë jam më i miri mes jush për familjen time." (El-Tirmidhi: 3895)





“

Marrëdhënia midis burrave dhe grave në Islam është një marrëdhënie plotësimi e harmonie, jo marrëdhënie konflikti dhe secila prej tyre përmbush e plotëson mungesën e tjetrit në ndërtimin e bashkësisë muslimane.

Në Islam nuk ka vend për konflikt midis dy gjinive

Në Islam nuk ka vend për konflikt midis dy gjinive, nuk ka kuptim konkurrenca për çështje kalimtare të kësaj jete, nuk ka shije as fushata kundër gruas e as fushata kundër burrit, nuk kanë logjikë sulmet e ndërsjella dhe gjurmimi i mangësive të njëri-tjetrit.

Po si mund ta luftojë njeriu gjysmën tjetër të tij?! Si mund ta luftojë partnerin e tij?! Gruaja, siç ka thënë Profeti Fisnik, është partnerja e burrit dhe gjysma tjetër e tij; lidhja e tyre është përplotësuese, secili plotëson mangësinë e tjetrit në ndërtimin e shoqërisë islame.

Kurani na e përshkruan këtë lidhje përplotësuese në një formë artistike, kur thotë: *"Ato janë petk për ju dhe ju jeni petk për to."* (El-Bekare: 187)

Ajo që burrit në shikimin e parë i duket dobësi te gruaja, në të vërtetë është ana tjetër e një fuqie që burri nuk e zotëron, por që familja ka nevojë për të... Ajo që gruaja e sheh si mangësi te burri, ndoshta është shfaqje e disa mundësive që nuk i përshtaten asaj, por që pa të cilat jeta dhe shoqëria nuk qëndrojnë dot.

Prandaj do të ishte e kotë sikur Allahu të krijonte dy lloje të një race (burra dhe gra) dhe pastaj të thuhej që këto dy lloje janë identikë në çdo aspekt.



Kur disa burra dëshiruan të kishin të drejtat që iu ishin dhënë grave dhe kur disa gra dëshiruan t'u jepeshin të drejtat që iu ishin dhënë burrave, Kurani i madhërishëm shpalli vargun e mëposhtëm: *"Mos i lakmoni ato gjëra, me anë të të cilave Allahu i ka bërë disa nga ju të dallohen mbi të tjerët. Si meshkujt ashtu edhe femrat do të kenë pjesë prej asaj që kanë punuar. Kërkoni prej Allahut nga mirësitë e Tij."* (En-Nisa: 32) Pra, secili ka veçoritë, funksionet dhe dinjitetin e tij dhe secili përpiqet të kryejë rolin e tij, duke synuar mirësinë dhe pëlqimin e Zotit. Sheriati nuk ka ardhur as në favor të burrave e as në favor të grave, por në favor të njeriut, të familjes dhe të shoqërisë islame.



Marrëdhënia midis burrit dhe gruas

Rregullimi i marrëdhënies midis burrit dhe gruas ka qenë objekt i kodeve ligjore, zakonore e morale përgjatë historisë dhe në këtë pikë ka pasur arsye të ndryshme dhe zgjedhje nga më të ndryshmet, që është vështirë të llogariten e të gjurmohen. Por librat e historisë e të antropologjisë tregojnë për popuj që nuk e shohin si problem lakuriqësinë e plotë dhe konfuzionin seksual midis dy gjinive; për popuj që e lidhin gruan me zinxhirë nga frika; për popuj që i mbulojnë burrat dhe jo gratë ose që mbulojnë pjesë të caktuara të trupit e shumë raste të tjera që nuk numërohen.

Shumica e popujve, sidomos ata që kanë arritur një shkallë qytetërimi, kanë menduar se kjo çështje ka nevojë për norma që ta rregullojnë, me qëllim që jeta të mos kthehet në xhungël, ku të zhduken të gjitha dallimet mes njeriut dhe kafshës.





“

Shumica e popujve, sidomos ata që kanë arritur një shkallë qytetërimi, kanë menduar se kjo çështje ka nevojë për norma që ta rregullojnë, me qëllim që jeta të mos kthehet në xhungël, ku të zhduken të gjitha dallimet mes njeriut dhe kafshës.



Natyra e marrëdhënies midis burrit dhe gruas në Islam

Marrëdhënia midis burrit dhe gruas në Islam nuk përcaktohet nga arsyeja njerëzore që kufizohet nga faktorët historikë dhe gjeografikë, por është një sistem i plotë e i vlefshëm për çdo kohë dhe vend, sistem që Zoti e ka shpallur në Kuran dhe që Profeti Muhamed (a.s.) ua ka mësuar njerëzve.

Këto raporte ndryshojnë në natyrën dhe në limitet e tyre në varësi të pozitës që ka gruaja tek burri, siç e ka përcaktuar Islami.

Men, in relation to a woman, fall into different categories.

1 Burri si bashkëshort i gruas

Kurani e ka përshkruar marrëdhënien midis dy bashkëshortëve në mënyrën më të bukur dhe më kuptimplotë, kur gruan e ka quajtur petk për burrin dhe burrin e ka quajtur petk për gruan; një pasqyrim i mrekullueshëm ky i lidhjes shpirtërore, ndjesore dhe trupore midis dy bashkëshortëve: *"Ato janë petk për ju dhe ju jeni petk për ato."* (El-Bekare: 187)

2 Kategoritë e burrave në lidhje me gratë, sipas Islamit

Të afërmit e gruas (meharim - në arabisht sh.p.) janë të gjithë ata me të cilët gruas nuk i lejohet martesë asnjëherë, për shkak të lidhjeve të ngushta të gjakut. Numri i tyre është 13, si: babai, gjyshi, djali, vëllai, xhaxhai, daja, djali i vëllait apo i motrës, djali i djalit apo i vajzës etj. Gruas i lejohet të dalë pa mbulesën e saj të plotë para këtyre të afërmve; të shfaqet me veshjen e saj normale.

3 Burri të jetë i huaj për gruan

Këtu nënkuptohen ata burra që nuk janë familjarë të afërm, me të cilët nuk lejohet martesë.

Islami ka vendosur normat dhe ligjet që rregullojnë raportet e burrit me gruan e huaj, me qëllim ruajtjen e nderit dhe për t'i mbyllur portën djallit që të mos depërtojë tek njeriu nëpërmjet epshit dhe mendimeve të këqija. Ai (Zoti) që e ka krijuar njeriun e di shumë mirë se çfarë i bën dobi atij: *"E si të mos dijë Ai që ka krijuar gjithçka, kur Ai njeh çdo gjë me imtësi dhe është i Gjithëinformuari?!"* (El-Mulk: 14)





Përse, sipas Islamit, femra duhet të mbulohet kur del para burrave të huaj?

- Që femra të ketë mundësi për të kryer misionin e saj në jetë e në shoqëri në fushat e ndryshme të dijes dhe praktikës, në mënyrën më të mirë, duke ruajtur dinjitetin dhe dëlirësinë e saj.
- Për të pakësuar gjasat e joshjes dhe tundimit; që të garantohet pastërtia e shoqërisë, nga njëra anë dhe të ruhet dinjiteti i femrës, nga ana tjetër.
- Për t'i ndihmuar burrat që të ruajnë kontrollin dhe dëlirësinë e tyre në marrëdhëniet me gratë dhe në këtë mënyrë ta trajtojnë gruan si njeri me të gjitha atributet e veta kulturore dhe shkencore dhe jo si objekt kënaqësie.

Rregullat e marrëdhënies midis burrit dhe gruas së huaj:

1. Ulja e shikimit

Zoti i urdhëroi të dyja gjinitë që të ulin shikimin, në kuptimin që të mos shohin atë çfarë nxit epshet, sepse kjo është mënyra për ta ruajtur nderin. Ndërkaq, lëshimi i frerëve të shikimit është mënyra për ta çuar veten drejt mëkateve dhe veprave të turpshme. Zoti në Kuran thotë: *"Thuaju besimtarëve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara) dhe ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme)! Kjo është më mirë për ta! Me të vërtetë, Allahu është i Dijshëm për atë që bëjnë ata. Thuaju besimtareve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara), ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme)."* (En-Nur: 30-31)

2. Sjellja me respekt dhe moral

Sjellja midis burrit dhe gruas në çështjet e punës, të dijes apo në çështje të tjera, duhet të karakterizohet nga respekti i plotë dhe largimi prej çdo gjëje që nxit epshet.

3. Mbulesa

Zoti ka urdhëruar që të mbulohen femrat, e jo për meshkujt, për shkak se femrës i ka falur bukuri dhe aftësi joshëse. Për këtë shkak,



fëmrat janë më tërheqëse për meshkujt, sesa këta të fundit për femrat. Faktikisht që nga lashtësia e deri më sot, më së shumti janë shfrytëzuar femrat për të tërhequr meshkujt sesa e kundërta. Ky është edhe realiteti që shohim qartë me sytë tanë sot në mjetet e ndryshme të informacionit.

Sa i përket mbulesës, femra që shfaqet para meshkujve të huaj urdhërohet të mbulojë gjithë trupin, përveç fytyrës dhe duarve, sikurse thotë Zoti në Kuran: "*Dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme.*" (En-Nur: 31)



“

Zoti e ka urdhëruar femrën që të mbulojë të gjithë trupin para burrave të huaj, përveç fytyrës dhe duarve: *"Dhe të mos i shfaqin bukuritë e tyre, përveç pjesëve të dukshme."* (Kuran, 24:31)

Shumë prej atyre që kritikojnë mbulesën islame harrojnë se figura e femrës më të madhe në historinë e njerëzimit, Mariës së Virgjër, shfaqet e mbuluar në të gjithë ikonat e saj. Dhe mbulesa e saj ngjan shumë me atë islame.



Legjislacioni islam për ushqimet dhe pijet



Zakonisht

Zakonisht një nga pyetjet e para që bëjnë ata që duan të zbulojnë Islamin, është: Përse e ndalon Islami alkoolin dhe mishin e derrit?



Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, duhet bërë patjetër një sqarim i rëndësishëm:

Kurani ua ka lejuar muslimanëve çdo gjë që gjendet në Tokë, më qëllim përfitimin e të mirave të saj. Teksti kuranor është i qartë se Zot: *"Është Ai që ka krijuar për ju gjithçka në Tokë..."* (El-Bekare: 29)

Nga gjërat që ka krijuar Zoti për ne janë: ushqimet dhe pijet. Të gjitha këto janë të lejuara, përveç atyre që Kurani i ka ndaluar për shkak se e dëmtojnë shëndetin ose e turbullojnë mendjen. Ndoshta është me interes të mësohet rreth ndalimit të derrit dhe të alkoolit.

Derri

Ndalimi për ngrënien e mishit të derrit ka ardhur i qartë në Kuran, edhe pse në atë kohë derri nuk ishte i njohur tek arabët. Disa shprehin habi për këtë ndalesë dhe flasin me nota kritike, ndinëse ajo nuk është e veçantë për muslimanët. Përkundrazi, dihet që, mishi i derrit është i ndaluar edhe tek hebrenjtë. Tekstet që e ndalojnë mishin e derrit në Dhiatën e Vjetër janë të qarta. Ajo që shkakton më tepër habi është fakti se mjaft dijetarë të feve kanë pohuar që mishi i derrit është i ndaluar edhe tek të krishterët. Edhe për këtë ndalesë ka pasur tekste të qarta në Dhiatën e Re, mirëpo më pas ajo është ndryshuar dhe manipuluar. (Shiko Ungjilli i Markut 5/11-13, Mateu 67, Apostulli Shën Pjetër: Mesazhi i Dytë 2/22, Luka 11/15)

Përse është e pamundur që Zoti të na sprovtojë me ndalimin e disa ushqimeve, pasi na ka lejuar shumicën e tyre, me qëllimin për të na provuar besimin dhe bindjen tonë, siç e sprovoi Adamin (Ademin a.s.), të cilit, pasi ia lejoi ngrënien e të gjithë frutavë e Parajsës, ia ndaloi vetëm një pemë të caktuar?!



Përse na duket e pamundur që Allahu i madhëruar të na vërë në prove duke na i bërë të ndaluara disa ushqime ndërkohë që na i bëri të lejuara shumicën e tyre për të provuar e nxjerë në pah besimin dhe bindjen tone ndaj Tij?! Në të njëjtën mënyrë ai e vuri në prove Ademin (paqja qoftë mbi të) kur e lejoi të hante nga mirësitë e xhennetit, dhe duke ndaluar ta haje atë nga një pemë e veçantë në të.




Alkooli dhe pijet dehëse


Lufta kundër epidemive dhe sëmundjeve që shkatërrojnë jetën njerëzore dhe vendosja e ligjeve të rrepta për mbrojtjen e shëndetit dhe të jetës së njerëzve konsiderohen një nga punët më të rëndësishme të qeverive dhe shteteve. Çdo defekt në këtë luftë ka pasoja të këqija për individin dhe shoqërinë...



Ndoshta prej të dhënave më tronditëse ato që kanë publikuar studimet e dokumentuara, si p.sh.: raporti i OBSH (Organizata Botërore e Shëndetësisë), studimi i Universitetit të Oksfordit i botuar në revistën "Nature" (15 mars 2012, nr. 275, fq. 483) dhe raporti i OBSH i datës 11/2/2011. Sipas tyre, numri i viktimave të alkoolit ia kalon çdo vit numrit të viktimave të SIDA-s, malaries dhe TBC të marra së bashku dhe për vitin 2011 ishte sa trefishi i viktimave të shkaktuara nga luftërat, gjenocidet dhe aktet terroriste. Ja disa shifra që kanë sjellë këto studime me raportet e OBSH:





Çdo vit vdesin nga alkooli dhe nga varësia ndaj tij më shumë se **2.5 milionë njerëz. Nga këta 320** mijë janë të rinj të moshës 15 – 29 vjeç, në të katër anët e botës, vdesin për shkaqe të lidhura me alkoolin. Këto përbëjnë 9% të vdekjeve që ndodhin çdo vit në këtë grupmoshë.







Një studim amerikan tregon se **700 mijë studentë** ekspozohen ndaj sulmit të studentëve të tjerë konsumues të alkoolit.






Sipas një raporti të
lëshuar në vitin **2001, 80%**
e krimeve të dhunshme
që kryhen nga të rinjtë
në Estoni, kanë lidhje me
teprimin në konsumimin
e alkoolit.






Alkooli konsiderohet
faktor në çerekun e
krimeve të vrasjes në
nivël botëror.





Të dhënat dhe raportet e OBSH-së u


bëjnë thirrje të gjitha shteteve që të marrin masa me ligje të rrepta për të pakësuar ose për të ndaluar këto tragjedi të përditshme të shkaktuara nga alkooli.





Brenda një viti, vetëm në Britani:

- Janë kryer afërsisht një milion krime të dhunshme të lidhura me alkoolin. Madje, duke marrë në konsideratë numrin e viktimave, është konstatuar se gjysma e krimeve të dhunës në përgjithësi kishte lidhje me alkoolin.
- Shtatë milionë pacientë të pranuar në shërbimet e urgjencës dhe aksidenteve nëpër spitale janë prej atyre që kanë varësi prej alkoolit. Këto shërbime u kushtojnë taksapaguesve rreth 650 milionë sterlina britanike në vit.
- Në total, kostoja e përgjithshme e krimeve dhe e grindjeve të lidhura me alkoolin dhe që bie në shpatullat e taksapaguesve luhatet nga 8 deri në 13 miliardë sterlina në vit.



Si i trajton Kurani alkoolin dhe pijet dehëse?

Islami nuk ka pritur raportet e OBSH-së për të zbuluar dëmin e alkoolit ndaj individit dhe shoqërisë, sepse Ai që e ka krijuar njeriun e di shumë mirë se çfarë është e dobishme për jetën dhe shoqërinë e tij.

Islami u erdhi arabëve kur këta nuk i ndaheshin pijes dhe dehjes. Alkooli, me të gjitha llojet e tij, ishte kënaqësia e tyre më e madhe dhe më e çmuar. Krenoheshin me të dhe shpenzonin për të çdo gjë që zotëronin.

Kurani e trajton këtë çështje në mënyrë shumë logjike. Ai pohon se alkooli ka disa dobi dhe përfitime, që shfaqen kur konsumuesi i tij ndjen një lloj shije dhe qetësie momentale, duke ia larguar shqetësimin dhe brengën përkohësisht... Mirëpo pasojat e tij janë të tmerrshme. Është e pamundur të përmenden të gjitha dëmet psikologjike e shëndetësore, si dhe pasojat negative që shkakton në sjelljen e njeriut në rrafsh individual dhe shoqëror. *"Të pyesin ty për verën dhe kumarin. Thuaju: "Ato sjellin dëme të mëdha (gjynahe), por edhe dobi për njerëzit. Megjithatë, dëmi i tyre është më i madh se dobia". Të pyesin se çfarë duhet të japin si lëmoshë. Thuaju: "Teprecën!" Ja, kështu jua shpjegon Allahu shpalljet e Tij, që të mund të mendoni."* (El-Bekare: 219)

Më pas Kurani i mëshon ndalimit e alkoolit, duke e quajtur pirjen e tij si vepër të djallit, e cila shkakton armiqësi e urrejtje, pengon nga angazhimet madhore dhe të rëndësishme. Kurani u drejtoi një pyetje njerëzve: "A nuk po hiqni dorë?!" Njerëzit thanë: "Po ndalemi, po ndalemi", dhe i derdhën rrugëve të Medinës të gjitha enët me verë, në shenjë bindjeje dhe respekti ndaj urdhrit të Allahut në Kuran.

Mëkati dhe pendimi

Filozofia

Filozofia e së drejtës dhe së gabuarës është një nga problemet ideore në shumë fe dhe besime. Secila prej tyre i bën një trajtim të veçantë gabimit, mëkatit, kthesës dhe pendesës.



Islami e sheh me realizëm natyrën njerëzore, në të cilën Zoti e ka krijuar njeriun. Ai ka në vetvete dëshira të mira dhe të këqija. Islami nuk e trajton njeriun si një engjëll, krijesë me natyrë të mirë, përkundrazi pohon se çdo njeri është gabimtar. Nga ana tjetër, e ngarkon atë me përgjegjësi për të gjitha vendimet dhe zgjedhjet e tij, prej këtu vjen dhe koncepti i Islamit mbi mëkatin dhe pendimin, të cilin mund ta përmbledhim në vijim:

- Gjëja e parë me të cilën ndeshemi në Kur'an është se mëkati është individual dhe pendimi është individual, që mishërohet në një perceptim të qartë e të lehtë, pa kurrfarë kompleksiteti e paqartësie. Njeriu nuk lind me mëkate. Përkundrazi, çdo njeri lindet i pastër nga mëkati dhe nuk mban përgjegjshi për asnjë mëkat të mëparshëm. Gjithashtu asnjë person nuk ka të drejtë të falë dhe të shlyejë mëkatet. Mëkati i Adamit (Ademi a.s.) ishte individual; ai u pastrua prej tij me lehtësi nëpërmjet pendimit të drejtpërdrejtë. Mëkati i çdokujt prej bijëve të tij gjithashtu është individual. Rrugë e pendimit është e hapur. Në këtë mënyrë, sipas këtij perceptimi të drejtë dhe të qartë, çdo njeri frymëzohet që të punojë e të përpiqet, të mos bjerë në dëshpërim dhe pesimizëm. Çdo njeri mbart vetëm mëkatet e tij; askush nuk ndëshkohet për mekatet e tjetrit. Ky është besimi që kanë sjellë të Dërguarit prej Zotit dhe për këtë na tregon Kurani: *"Vallë, a nuk ka dëgjuar ai për atë që shkruhet në Shkrimet e Musait dhe të Ibrahimit - i cili i plotësoi detyrimet: se askush nuk do t'i mbartë gjynahet e tjetrit dhe se njeriu nuk do të ketë vetëm se atë për të cilën ka punuar; se përpjekjet e tij do të shihen dhe se do të marrë shpërblim të plotë."* (En-Nexhm: 36-41)



Në islam, pendimi është një vendim që nuk ka nevojë për asgjë tjetër përveç lënies së gjuhahut, keqardhjes për atë që kaloi prej veprave të shkuara dhe vendosmërisë për të mos iu kthyer më atyre gjynaheve. Por me kusht që tu kthesh të drejtat dhe hakun atyre që ua ke cënuar ato.



- Pendimi është një nga adhurimet më madhështore që e afron njeriun tek Zoti. Ai nuk është monopol i askujt prej njerëzve dhe nuk ka nevojë për një vend të veçantë, as për ndonjë rrëfimin para dikujt prej njerëzve, as për të marrë leje prej ndokujt. Përkundrazi, është një adhurim ndërmjet Zotit dhe krijesave. Zoti e pranon pendimin, i fal gjynahet dhe është Mëshirues. Këto cilësi përmenden në Kuran. Kurani na përshkruan cilësitë e të devotshmëve të cilët do të hyjnë në Parajsë, duke pohuar se ata kanë bërë disa



mekate, mirëpo pas çdo mëkati shpejtonin në pendim dhe i kërkonin falje Zotit: *"Për ata që, kur bëjnë vepra të turpshme ose i bëjnë dëm vetes, e kujtojnë Allahun, i kërkojnë falje për gjynahet e tyre – e kush i fal gjynahet përveç Allahut? - dhe nuk ngulmojnë me vetëdije në gabimet që kanë bërë."* (Al-Imran: 135)

Në Islam pendimi nuk ka nevojë për më shumë se sa njeriu të heqë dorë nga mëkati, të ndjejë keqardhje për veprimet e tij të mëparshme, të jetë i vedosur që të mos u kthehet atyre në të ardhmen; njëkohësisht t'ua kthejë të drejtat atyre që u ka hyrë në hak. Nëse ndodh që i kthehet gjynahut apo mëkaton herë tjetër, pendimi i tij i parë nuk zhvlerësohet dhe mëkatet nuk i kthehen, mirëpo pas çdo mëkati ai duhet të pendohet.

Kështu jeton njeriu në Islam; jeton në një gjendje ekuilibri ndërmjet dëshirës për përsosmëri dhe përparimit të vazhdueshëm duke u larguar nga mëkatet; e njeh natyrën e vet njerëzore, për shkak të së cilës shpesh dobësohet dhe ndoshta devijon nga rruga e drejtë. Prandaj, prej tij kërkohet që në çdo gjendje: kur është i zellshëm dhe i përkushtuar ndaj Zotit, apo kur është i shkujdesur dhe ka devijuar, kurrë të mos e humbasë busullën e orientimit. Përkundrazi, ai duhet të kthehet i penduar tek Zoti dhe t'i kërkojë falje Atij.

Këtu qëndron dallimi midis besimtarëve të devotshëm dhe të tjerëve. Kurani na tregon se ky dallim qëndron në faktin se të devotshmit, nëse bien në mëkat e kujtojnë Zotin dhe kthehen tek Ai të penduar, ndërkohë që të tjerët vazhdojnë në mëkate, pa u shqetësuar dhe pa ua vënë veshin këshillave (El-A'raf: 201 – 202).




Në islam nuk egziston diçka e tillë si «Mëkat i trashëguar» që para lindjes. Madje sipas islamit çdo njeri lind i pastër nga çdo gjynah dhe nuk mban peshën e asnjë gjynahu të shkuar nga paraardhësit e tij.





Dualizmi fe dhe arsyeja



Disa

Disa njerëz besojnë se feja bie ndesh me arsyen dhe shkencën. Sipas tyre, feja bazohet në iluzione, legjenda e mite, ndërsa shkenca dhe filozofia janë dy rrugë që të çojnë drejt njohjes së organizuar, e cila shndërrohet në dije të saktë dhe të sigurt kur plotësohen kushtet e kërkimit shkencor, të menduarit logjik dhe eksperimentit... Nëse shqyrtohet me kujdes, ky besim ka aspekte të drejta dhe të gabuara.



Ka të drejtë sepse ekzistojnë disa fe që e anashkalojnë logjikën dhe shpesh bien ndesh me të, sepse burimet dhe librat e tyre i kanë të mbushura me legjenda, mite e besëtytni që kundërshtojnë faktet reale dhe shkencore.

Ndërsa gabimi qëndron në përgjithësimin e këtij gjykimi për çdo fe, pa marrë në konsideratë ndryshimet cilësore që gjenden midis tyre për sa u përket burimeve, mësimave, metodave dhe argumenteve të tyre.

Kush lexon Kuranin e Shenjtë, burimin kryesor të Islamit, bindet plotësisht për pozitën e lartë që ai i ka caktuar mendjes, diçka për të cilën nuk e konkurren dot asnjë fe. Dhe lexuesi i Kuranit nuk ka nevojë të jetë shumë i vëmendshëm në lexim që të vërejë nxitjet për të vënë në punë arsyen dhe thirrjet për të vëzhguar e medituar. Vetëm pyetja retorike “A nuk po mendoni?” përsëritet më shumë se 13 herë në Kuran.



Ai që i hedh një vështrim të shkurtër Kuranit nuk ka nevojë të mendohet shumë për të kuptuar se ai nxit dhe inkurajon shumë për të medituar dhe menduar thellë.

Orientimi kuranor për të vënë në punë arsyen, shfaqet në shumë forma:



Kurani i drejtohet me fakte dhe argumente të shumta logjike njeriut mendjehapur e të çliruar nga çdo formë despotizmi, arrogance, frike e injorance, për të argumentuar domosdoshmërinë e besimit në Zot, si p.sh. me thënien: *"A mos vallë, ata janë krijuar nga hiçi apo janë krijues të vetvetes?! A mos vallë ata i kanë krijuar qiejt dhe Tokën?! Nuk është kështu, por ata nuk janë aspak të bindur."* (Et-Tur: 35-36)



Kurani i diskuton argumentet e kundërshtarëve dhe i refuzon ato pretendime që nuk mbështeten në fakte: *"Nëse është e vërtetë ajo që thoni, atëherë sillni provën tuaj!"* (El-Bekare: 111)



Kurani i qorton ata që nuk venë në përdorim mendjen e tyre dhe i përshkruan me dikë që nuk ka shqisa, sepse ata nuk përfitojnë nga ajo që shohin dhe dëgjojnë, për të marrë vendime dhe zgjedhje të drejta, sikurse ka thënë: *"Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër botë, që zemrat e tyre të mendojnë dhe veshët të dëgjojnë? Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë (në këto gjëra), por u janë verbuar zemrat e veta në kraharor."* (El-Haxh: 46)



Kurani paralajmëron njeriun që të bëjë kujdes nga çdo gjë e pengon procesin e të menduarit logjik. Kurani nuk mjaftohet vetëm duke nxitur për përdorimin e shqisave dhe të mendjes si dhe respektin që duhet treguar ndaj saj, por gjithashtu na paralajmëron që të mos biem në grackë, duke pasur parasysh natyrën e njeriut, i cili ka edhe dëshira të mira edhe të këqija. Për pasojë, ngadonjëherë mund të bjerë në gabim dhe të shmanget nga e vërteta për shkak të joshjes, kërcënimit ose mashtrimit.

Pengesat e arsytimit të shëndoshë, siç i sqaron Kurani

■ **Imitimi i verbër:** Kjo pengesë ka të bëjë me trashëgiminë e besimit dhe të sjelljes, si dhe me qasjet negative të të menduarit, të cilat lënë gjurmë në mendje dhe ndikojnë shumë në stilin e përsiatjes, çka e vështirëson pranimin e së vërtetës dhe braktisjen e së kotës. Ndoshta imituesi e paralizon tërësisht procesin e të menduarit, duke u argumentuar se “kështu jam mësuar” apo “kështu jam lindur”, sikurse na tregon Kurani për ata që cilëve u sqarohet e vërteta, por nuk e pasojnë atë për shkak të imitimit verbërisht të etërve të tyre. Kur atyre u thuhet: “Ndiqeni të vërtetën që ka shpallur Zoti.” Ata thonë: “Jo! Ne do të ndjekim zakonet e traditat që kemi trashëguar nga prindërit tanë.” Pastaj Kurani sqaron: “Vallë, edhe sikur ata të mos mbështeten në arsye, as në dituri dhe as në udhëzim, do t’i ndiqnin dhe pasonin vetëm për shkak se janë etërit e tyre!” *“Kur atyre u thuhet: “Ndiqni atë që ka shpallur Allahu!” Ata përgjigjen: “Jo! Ne do të ndjekim atë udhë në të cilën i kemi gjetur të parët tanë” - Vallë, edhe atëherë kur të parët e tyre nuk kuptonin gjë e nuk ishin të udhëzuar?!”* (El-Bekare: 170)



■ **Kokëfortësia dhe mendjemadhësia:** Ndonjëherë mendja mund ta dallojë të vërtetën dhe të mos e pranojë atë për hir të interesit, pozitës, smirës apo përçmimit ndaj burimit të së vërtetës, siç thotë Kurani: *"Ata i mohuan ato (mrekulli) padrejtësisht dhe me mendjemadhësi, edhe pse në vetvete i besonin për të vërteta."* (En-Neml: 14)

■ **Dhënia pas kënaqësive:** Mendja mund ta dallojë të vërtetën, por nuk gjen guximin për ta ndjekur atë sepse është e zhytur në kënaqësi. Kurani na jep shembullin e një burri, të cilit Zoti i dha dituri dhe atij i takonte për të vepruar sipas asaj diturie në jetën e vet. Por ai e hodhi tej këtë dije, ndoqi dëshirat e veta dhe interesin e çastit vetëm sepse ishte dhënë pas kënaqësive aq shumë, sa që kishte humbur aftësinë për të marrë vendimin e drejtë (El-A'raf: 175-176).

Pra, Kurani e fton njeriun që kurdo e në çdo situatë të vërë në punë mendjen, të përdorë arsyen, të pyesë, të vëzhgojë e të meditojë rreth vetes, natyrës dhe gjithësisë, pa paragjykime dhe kushte paraprake.

Pyetjen dhe mendimin e ka frikë vetëm ai që fsheh në vetvete diçka që bie ndesh me këto të dyja. Pa dyshim që feja e vërtetë duhet të jetë prej Zotit, i Cili e krijoi njeriun dhe i dha atij aftësi të mendojë.

Është e pamundur të ketë antagonizëm ndërmjet krijesave të Zotit dhe fesë së Tij të shpallur për njerëzimin. Atëhere, përse gjithë kjo frikë nga pyetja dhe vënia në punë e mendjes? “Vetëm Atij i përket Krijimi dhe Urdhërimi. Qoftë bekuar Allahu, Zoti i botëve!” (El-A’raf: 54)



“

Muslimani beson se krijimi dhe Ligji i jetës i vendosur nga Zoti nuk mundet kurrë të bierë në kundërshtim me fenë e ligjëruar po prej Tij për njerëzit. Atëherë përse duhet të jemi të frikësuar të pyesim dhe të përdorim lloqgjikën dhe arsyen në çështjet fetare?

Islami është fe e paqes





Disa

Disa njerëz habiten - nga ajo çfarë përsëritet në mjetet e informacionit - kur mësojnë se paqja ka një vend të veçantë në Islam. Muslimani e përsërit fjalën "paqe" dhe e përjeton domethënien e saj shpesh në jetën e përditshme.

Paqja është një prej emrave të Zotit; Parajsa, në botën tjetër, quhet “Shtëpia e Paqes”; përshëndetja e muslimanëve fillon me fjalën “selam” – paqe; namazi i muslimanëve përfundon duke e përsëritur dy herë fjalën “selam” – paqe; madje, feja e muslimanëve quhet Islam që ka kuptimin: paqe dhe qetësi.



Islami bën thirrje për paqe dhe për respektimin e të drejtave të kafshëve më të dobëta dhe më të pambrojtura, sikurse na tregon për këtë Profeti Muhamed a.s.: *“Një grua hyri në Zjarr për shkak të një maceje duke e izoluar atë derisa ngordhi. As nuk e ushqeu, as nuk i dha të pinte dhe as nuk e la të lirë të kërkonte ushqimin e vet në tokë.”*



(Muslim 2242) Një grua imorale hyri në Parajsë për shkak të një qeni, të cilit ia largoi etjen (Buhariu 3280).

Islami sjell raste dhe ligje unike në respektimin e të drejtave të njeriut dhe të bashkëjetesës me të tjerët, pavarësisht ndryshimit të fesë, aq sa Profeti Muhamed ka kërcënuar se kush i bën padrejtësi një jomuslimani do të përballet me të (Profetin) në Ditën e Gjykimit (Ebu Daud, 1044).



Profeti Muhamed, ka njoftuar se çdo kush që i bën padrejtësi një jomuslimani, ose i jep mundim ose e mbingarkon me punë mbi mundësinë e forcën e tij, do të jetë kundërshtari i vetë profetit në ditën e Kjametit.

Islami kur bën thirrje për paqe, sigurisht që nënkupton paqen e drejtë, e cila i jep çdokujt atë që i takon, që i penalizon padrejtësitë dhe shkeljet. Paqja që kërkon Islami nuk ka lidhje jo paqen spekulative, e cila ia lë hajdutit mallin e vjedhur dhe e kënaq të dëmtuarin me një kompensim të vogël.

Fjalori terminologjik është i palimituar. Media janë mjeti më joshës që përdorin shumë njerëz për t'i bërë marketing ideve dhe pikpamjeve të tyre. Çdo skenë ka më shumë se një kënd për t'u parë dhe për çdo histori ka më shumë se një transmetim për t'u përhapur. Pak prej njerëzve mbartin mbi supet e tyre



brengën e hulumtimit të së vërtetës dhe të sfidimit të propagandës së mediave, duke gërmuar nëpër libra për të gjetur informacione nga burimet e tyre dhe për të gjykuar situatën me objektivitet dhe paanshmëri.

Ja disa fakte para teje, që të meditosh...

“

Të pakët janë ata njerëz që mbajnë peshën e rëndë të kërkimit dhe hulumtimit të së vërtetës, duke iu kundërvënë luftës së ashpër mediatike dhe duke kërkuar informacionet nga burime të besueshme për të gjykuar me objektivitet dhe urtësi.



LAUNCHING

CURIOSITY

CLICK HERE

Islami është feja me përhapjen më të shpejtë sot:

Islami përhapet sot me shpejtësi mahnitëse në të katër anët e rruzullit, që nga Amerika, Europa, Afrika dhe Azia, (qendra PEË për hulumtime fetare peeresearch.org),

pavarësisht se mundësitë janë të pakta, muslimanët janë të dobët, mediat botërore e prishin imazhin e tij nëpërmjet informacionit të gabuar dhe evidentojnë vetëm shembujt e këqij që nuk kanë lidhje të vërtetë me Islamin. A mund të thuhet tani se shkak i përhapjes së Islamit është detyrimi i njerëzve me dhunë apo bindja dhe zgjedhja e lirë?

E vërteta që vëren çdokush që lexon është se angazhimi i muslimanëve për të mbrojtur dhe respektuar të drejtat, zgjedhjen dhe kulturën e të tjerëve është shkak më i madh që ka ndikuar në shpirtrat e tyre për të pranuar Islamin. Ky angazhim nuk ka qenë një favor i muslimanëve, por zbatim i detyrueshëm i parimit që Zoti e thekson qartësisht në Kuran: *"Nuk ka detyrim në fe, sepse është bërë e qartë rruga e drejtë nga rruga e shtrembër."* (El-Bekare: 256)

A detyrohen njerëzit për të hyrë në Islam?



Është fakt se njeriu e ka përdorur forcën për të imponuar mendimin, për ushtruar ndikimin dhe për të realizuar interesat e tij. Historia është e mbushur me raste të tilla të ushtruara nga njerëz prej të gjitha feve, sekteve e ideologjive.

Për shembull, historia njih gjenocidin e tmerrshëm të ushtruar ndaj indigjenëve të Amerikës pas mbërritjes së eksploruesëve dhe emigrantëve në Botën e Re. Në cilësinë e dëshmitarit okular, prifti spanjoll Bartolome de las Casas i përshkruan kështu masakrat: "Ata nuk i shikonin si njerëz banorët autoktonë, por i konsideronin kafshë ose më poshtë se kafshët."

(A Brief Account of the Destruction of the Indies by Bartolome de las Casas, Jan 1, 2009)

Po muslimanët çfarë kanë bërë kur kanë qeverisur vende të reja?

Muslimanët kanë sunduar Andaluzinë (Spanjën) për 8 shekuj:



Muslimanët e kanë sunduar Andaluzinë (Spanjën) për 781 vite (711 – 1492). Në atë kohë Andaluzia ishte njëra prej qendrave më të mëdha botërore të qytetërimit. Asnjë i krishter nuk u detyrua më dhunë të pranonte Islamin; përkundrazi, u mbrojtën të drejtat e tyre dhe u zhvilluan qendrat dhe tregtia e tyre. Muslimanët larguan edhe shtypjen që ushtrohej ndaj hebrenjve para se vendi të udhëhiqej prej tyre. Historia është e mbushur me këto fakte.

Ndërsa kur Izabela dhe Fernandi triumfuan mbi muslimanët në Spanjë, e ndaluan shfaqjen e Islamit, vranë dhe dëbuan shumë muslimanë dhe themeluan gjyqet e inkuizicionit për të dënuar të mbeturit që ruanin akoma Islamin, qoftë edhe në fshehtësi.

Muslimanët u nxorrën me forcë nga shtëpitë dhe u dëbuan nga Andaluzia. Mirëpo, të bie në sy është fakti se, bashkë me muslimanët, nga Andaluzia u dëbuan edhe hebrenjtë. Këta i shoqëruan muslimanët në vendet islame ku gjetën strehim të sigurt dhe një jetë dinjitoze.



Muslimanët e kanë sunduar Egjiptin për më shumë se **1400** vite dhe ia kanë ruajtur pozitën popullsisë kopte:




Muslimanët e sunduan Egjiptin qysh në fillim të përhapjes së Islamit, kur atë e çliroi Amr bnu El-Aas, njëri prej shokëve të të Dërguarit të Zotit. Muslimanët jo vetëm ua ruajtën fenë dhe vendet e shenjta, por gjithashtu i shpëtuan nga persekutimi, privimi dhe tortura e ushtruar nga romakët për shkak të diversitetit doktrinal, edhe pse i përkisnin të njëjtës fe. Popullsisë kopte iu kthye liria e fesë dhe e adhurimeve prej asaj kohe. Sot numri i popullsisë kopte i kalon 5 milion.

Muslimanët kanë sunduar Indinë për rreth një mijë vite dhe 80% e banorëve të saj janë jomuslimanë:



Muslimanët e kanë sunduar nënkontinentin indian për rreth një mijë vjet, gjatë të cilave ua kanë mbrojtur të drejtat fetare pasuesve të feve vendase, duke i dhënë fund persekutimit të feve të vogla atje. Të gjithë historianët theksojnë se Islami në Indi nuk është përhapur me forcë dhe askush nuk është detyruar ta pranojë atë.

Në vendin më të madh musliman Islami ka hyrë pa luftë dhe ushtri:



Indonezia është vendi më i madh musliman për nga popullsia. Nga 250 milionë banorët e saj, 87% e tyre janë muslimanë. Islami u fut në Indonezi nëpërmjet tregtarëve arabë muslimanë në shekullin XIII dhe u përhap nga morali i tyre i lartë. Zona nuk ka njohur asnjë ushtri të huaj dhe nuk ka derdhur asnjë pikë gjaku, përveçse pas ardhjes së legjioneve të kolonizatorëve portugezë e më pas holandezë dhe anglezë.



Midis Islamit dhe gjendjes së disa muslimanëve



Ç’

është ky kontrast kaq i madh? Këtë pyetje mund ta shtrojnë disa njerëz që e kanë njohur thelbin e normave islame, të cilat predikojnë virtytet dhe moralin e lartë, përpjekjen për zhvillimin e qytetërimit, humanizmin, solidaritetin dhe përhapjen e paqes mes njerëzve, e pastaj hedhin vështrimin përreth dhe vërejnë modele që i atribuohen Islamit, por që janë shumë larg tij. A mund të jenë ata ndjekësit e fesë së vërtetë?



Realisht kjo gjendje paradoksale të huton dhe ka nevojë të analizohet qetësisht duke u fokusuar në disa pika:

- Jo çdokush që pretendon përkatësi islame ose që ka lindur në Islam është musliman që i zbaton me përpikëri të gjitha rregullat e fesë. Në çdo vend rreth nesh ka shumë mangësi dhe devijim nga thelbi i Islamit dhe nga mësimet e tij. Ka muslimanë që Islamit i njohin vetëm emrin.
- Nuk mundet kurrsesi që gabimet e njerëzve t'i vishen fesë dhe rrymave të tyre fetare. Kështu, nuk mund të thuhet se tirania e Hitlerit ishte për shkak të fesë së tij ose se feja e krishterë bën thirrje për dhunë, meqë Hitleri ishte i krishter; ose që ateizmi sjell si pasojë masakrimin e njerëzve sepse ateisti Josif Viserjanoviç Stalin vrau miliona njerëz! Të gjitha këto pretendime janë larg objektivitetit, saktësisë dhe drejtësisë.




Gabimet e njerëzve nuk mund t'i atribuohen feve ose besimeve të tyre.

- Ka mjaft modele të pranuara nga të gjithë, të cilat dëshmojnë për madhështinë dhe mrekullinë e kësaj feje, si një fe e vërtetë që mishëron paqen diturinë dhe progresin. Me shembuj të tillë është mbushur plot historia e Islamit kudo në botë, nga India në Lindje deri në Spanjë në Perëndim. Gjurmët e civilizimit islam janë ende të dukshme për ne. Ai ishte pishtar në rrugën drejt progresit dhe zhvillimit. Pjesa më e shëndetshme e civilizimit bashkëkohor i ka rrënjët në civilizimin islam. Islami është model për gjithë ato vende që përpiqen të arrijnë shtetet më të zhvilluara në ditët e sotme. Islami ka dhënë modele unikale e të shkëlqyera në të gjitha fushat e shkencës dhe në vende nga më të ndryshme të botës.
- Askush nuk i hedh poshtë arritjet e mjekësisë moderne dhe nuk e lë veten pa mjekuar, vetëm sepse njih disa mjekë të papërgjegjshëm përreth tij; askush nuk e lufton arsimin dhe nuk ua ndalon atë fëmijëve, vetëm sepse njih disa shkolla apo disa mësues që i prishin imazhin këtij profesioni fisnik. Pra, vlen të shihet thelbi i çështjes dhe jo disa shembuj të këqij që i atribuohen asaj.

- Është e çuditshme se, me gjithë sulmet e dhunshme që synojnë prishjen e imazhit të Islamit nga disa që e identifikojnë veten si muslimanë apo janë armiq të tij, shumë njerëz ende janë në gjendje për të parë Islamin autentik e të vërtetë, të pastër e të kulluar, ndryshe nga çfarë u serviret, një lloj Islami i shtrembëruar dhe i manipuluar. Njerëzit, nga të gjitha vendet e botës, vazhdojnë të hyjnë në Islam çdo ditë.



Askush nuk lufton arsimin dhe të parandalojë fëmijët e tij vetëm për shkak se ai e di se si janë katandisur shkollat, ose për faktin se profesorët e kanë keqpërdorur këtë profesion të nderuar.





Këndvështrim i ri

Sa herë ke hezituar për të marrë një vendim dhe për të shfrytëzuar një rast dhe vazhdon ta fajësosh veten akoma sot e kësaj dite?!

Nderimi më i madh që i është bërë njeriut është liria dhe aftësia për të marrë vendime në të mirë të vetes, pa u druajtur e pa belbëzuar.

Përderisa qëndresa në përballje me sfidat e vështirësitë konsiderohet trimëri për të cilën njeriu lavdërohet e vlerësohet, atëherë marrja e vendimeve të dobishme dhe guximi për të pranuar gabimin kur e vërteta shfaqet dukshëm, është një akt edhe më madhështor, sepse është trimëri para vetes, është ngadhënjim mbi vanitetin dhe egon. Më pas personi do t'i ndiejë efektet e mira të këtij akti në veten dhe personalitetin e tij.

Sikurse ia dhe vetes mundësinë e njohjes së karakteristikave të Islamit nga burimet e tij, mos ia kurse asaj mendimin dhe meditimin rreth gjithçkaje që lexove.

Në qoftë se e ke dalluar elegancën dhe bukurinë e kësaj feje dhe ke ende nevojë për të tepër kërkim dhe pyetje rreth së vërtetës së Islamit dhe veçorive të tij, atëherë para teje ke një hapësirë të madhe për të lexuar, për të pyetur e dialoguar; mirëpo duke filluar që tani duhet ta shohësh atë me sy tjetër, nga një kënd i ndryshëm vështrimi.



Jemi të nderuar që keni përfunduar leximin e librit dhe shpresojmë që të kemi ngritur pyetje serioze ose të kemi arritur të stimulojmë disa nga idetë tuaja qofshin ato miratuese ose kundërshtuese. Jemi të lumtur të dëgjojmë mendimet, pyetjet ose kundërshtimet tuaja dhe premtojmë se do t'i shqyrtojmë atë me vëmendje të plotë dhe përkushtim maksimal.

Për më shumë informacion rreth Islamit:



LAUNCHING
CURiOSiTY
JUST SCAN IT.!!



THISISLAM.net

Ndani përvojën
tuaj me ne

i n f o @ m o d e r n - g u i d e . c o m